

GJYKATA E QARKUT NË PEJË

P.n. 67/09

29 prill 2009

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT NË PEJË, me trupin gjykues në përbërje Gjykatësi Ndërkombëtar Gianfranco Gallo si Kryetar i trupit gjykues, Gjykatësi Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot dhe Gjykatësi Kosovar Osman Cucovic si anëtarë të trupit gjykues, të asistuar nga procesmbajtësja Patricia Faltusova, në lëndën penale kundër të akuzuarit

GJELOSH KRASNIQI, i lindur më 13 shtator 1973 në fshatin Nepole, Komuna e Pejës, mashkull, emri i babës Pren KRASNIQI, emri i nënës dhe mbiemri i vajzërisë Leze SHALA, shqiptar i Kosovës, me vendbanim në Nepole, Komuna e Pejë, numri i letërnjoftimit Dokumenti i Udhëtimit i SHBA-ve # A078220798, në paraburgim nga data 27 maj 2008 deri më 24 shtator 2008 dhe nga data 7 nëntor 2008 deri tani, aktualisht i paraburgosur në Qendrën e Paraburgimit në Dubravë;

I akuzuar, në pajtim me Aktakuzën PP. Nr. 88/2008, të datës 4 dhjetor 2008, dhe të ngritur në Gjykatë në të njëjtën ditë, për veprat penale në vijim:

Krime të luftës kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ, nenit 3 dhe 147 të Konventës së 4-të të Gjenevës, nenit 4 të Protokollit të II-të Shtesë të Konventave të Gjenevës

për shkak të:

A. *arrestimit të kundërligjshëm, paraburgimit, marrjes peng, privimit nga e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, trajtimin çnjërezor dhe vrasjes së Pashk Lulit, person civil;*

B. *konfiskimit të kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitjes së pushkës AK-47 dhe revoles 7.65 nga Pashk Luli;*

C. *konfiskimit të kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitjes së pushkës M-48 nga Tune Kashnjeti, person civil;*

D. *konfiskimit të kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitjes së pushkës M-48 dhe revoles CZ 99 9 mm, nga Gjergj Quni, person civil;*

E. *konfiskimit të kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitjes së revoles Bronvik 7.65 mm nga Mihill Pergega, person civil;*

në fshatin Doblibare, Komuna e Gjakovës, më 24 mars 1999, krim i dënueshëm me pesë deri 20 vjet burg

Pas mbajtjes së seancave dëgjimore gjatë shqyrtimit kryesor me dyer të hapura më 11, 12, 17, 18, 19, 31 mars 2009, 23, 24, 27 and 29 prill 2009 në praninë e:

- të akuzuarit Gjeloš Krasniqi dhe avokatit të tij mbrojtës z. Haxhi Millaku;
- Prokurorit Publik Special z. Robert Dean;

pas pleqërimit të trupit gjykues dhe votimit më 29 prill 2009, bazuar në nenin 391 paragrafi (1) të KPPK,

më 29 prill 2009, në pajtim me nenin 392 paragrafi (1) të KPPK, shpall publikisht dhe në praninë e të akuzuarit, Prokurorit Publik Special, këtë

AKTGJYKIM

*Akuza kundër Gjeloš Krasniqi për kryerjen e veprës penale të **Krimeve të Luftës kundër popullatës civile, në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ, nenit 3 dhe 147 të Konventës së 4-të të Gjenevës, nenit 4 të Protokolit të II-të Shtesë të Konventave të Gjenevës lidhur me arrestimin e kundërligjshëm të Pashk Lulit të kryer në fshatin Doblibare, Komuna e Gjakovës, më 24 mars 1999 është ri-cilësuar si Privim i Kundërligjshëm nga Liria në kundërshtim me nenin 162 të KPK dhe si rrjedhojë është REFUZUAR** meqë afati i parashkrimit ka skaduar.*

*Për më tepër **Gjeloš KRASNIQI,***

është

LIRUAR

*nga akuza e kryerjes së **Krimeve të Luftës kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ, nenit 3 dhe 147 të Konventës së 4-të të Gjenevës, nenit 4 të Protokolit të II-të Shtesë të Konventave të Gjenevës lidhur me paraburgimin, privimin e së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, trajtimin çnjerëzor dhe vrasjen e Pashk Lulit në fshatin Doblibare, Komuna e Gjakovës, më 24 mars 1999, sepse nuk është dëshmuar se i akuzuari ka kryer veprën me të cilën është ngarkuar.***

është

SHPALLUR FAJTOR

*për **Krime të Luftës kundër popullatës civile, në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ, nenin 3 dhe 147 të Konventës së 4-të të Gjenevës, nenin 4 të Protokolit të II-të Shtesë të Konventave të Gjenevës, lidhur me marrjen peng të Pashk Lulit dhe lidhur***

me konfiskimin e kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitjen e pushkës AK-47 dhe revoles 7.65 nga Pashk Luli, pushkës M-48 nga Tune Kashnjeti, pushkën M-48 dhe revolen CZ 99, 9 mm, nga Gjergj Quni, revoles Bronvik 7.65 mm nga Mihill Pergëga në fshatin Doblbare, Komuna e Gjakovës, më 24 mars 1999.

PRANDAJ, i akuzuari,

DËNOHET

me shtatë/7/ vjet burgim për veprën penale të Krimit të Luftës kundër popullatës civile në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ;

Koha e kaluar në paraburgim nga i pandehuri do të llogaritet në dënim, në pajtim me nenin 391 paragrafi (1) nënparagrafi 5 i KPPPK.

I akuzuari detyrohet t'i kompenzojë shpenzimet e procedurës penale në pajtim me nenin 102 paragrafi (1) i KPPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Një aktvendim i veçantë do të lëshohet nga gjykata lidhur me shumën e shpenzimeve kur këto të dhëna sigurohen në pajtim me nenin 100 paragrafi (2) i KPPPK.

ARSYETIMI

A. HISTORIKU PROCEDURAL – AKTAKUZA

Më 04 dhjetor 2008, Prokurori Publik Special ka ngritur aktakuzën PP.no.88/2008 përpara Gjykatës së Qarkut në Pejë, kundër të pandehurit Gjëlosh Krasniqi, duke e akuzuar atë për veprën penale Krime të Luftës kundër Popullatës Civile, në kundërshtim me nenin 142 të Kodit Penal të RSFJ, nenit 3 dhe 147 të Konventës së 4-të të Gjenevës, nenit 4 të Protokollit të II-të Shtesë të Konventave të Gjenevës.

Sipas aktakuzës, më 24 mars 1999, Gjëlosh Krasniqi, në shkelje të rregullave të ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohë të luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit, që do të thotë Konventa mbi mbrojtjen e personave civil në luftë (tani e tutje Konventa e IV-të e Gjenevës), neni 3 dhe 147 dhe Protokoli i II-të i Konventave të Gjenevës, neni 4, në fshatin Doblbare, Komuna e Gjakovës, Kosovës, ka kryer:

A. arrestimin e kundërligjshëm, paraburgimin, marrjen peng, privimin nga e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, trajtimin çnjëror dhe vrasjen e Pashk Lulit, person civil;

B. konfiskimin e kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitjes së pushkës AK-47 dhe revoles 7.65 nga Pashk Luli;

C. konfiskimin e kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitjes së pushkës M-48 nga Tune Kashnjeti, person civil;

D. konfiskimin e kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitjes së pushkës M-48 dhe revoles CZ 99 9 mm, nga Gjergj Quni, person civil;

E. konfiskimin e kundërligjshëm të pronës dhe plaçkitjes së revoles Bronvik 7.65 mm nga Mihill Pergega, person civil;

Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale të Krimeve të Luftës kundër popullatës civile, në shkelje të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP RSFJ) nenit 142, e dënueshme me jo më pak se pesë (5) vjet dhe jo më shumë se dyzet (40) vjet burg.

Seanca dëgjimore për Konfirmim të Aktakuzës është mbajtur më 19 janar 2009, në prani të të pandehurit, avokatit të tij mbrojtës, prokurorit special dhe palës së dëmtuar; aktakuza është konfirmuar përmes aktvendimit KAQ.nr.363/08 e datës 20 janar 2009. Nuk është paraqitur asnjë ankesë ndaj aktvendimit të lartcekur.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

1. Procedura, Kompetenca dhe Përbërja e trupit gjykues e Gjykatës së Qarkut në Pejë.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi 1 të KPPK, gjykatat e Qarkut kanë jurisdikcionin të gjykojnë në shkallën e parë veprat penale të dënueshme me së paku pesë vjet burg apo me burgim afatgjatë.

Në rastin konkret i akuzuari është akuzuar për Krime të Luftës kundër Popullatës Civile, në kundërshtim me Ligjin Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP RSFJ) nenin 142, të dënueshme me së paku pesë (5) vjet dhe jo më shumë se njëzet (20) vjet burgim.

Veprat penale, sipas aktakuzës, ishin kryer në fshatin Doblibare, Komuna e Gjakovës, e cila është brenda territorit të Qarkut të Pejës. Prandaj, në pajtim me nenin 27, par. 1 të KPPK, Gjykata e Qarkut në Pejë ka jurisdikcionin territorial të gjykojë këtë çështje.

Pra, mund të kokludohet se Gjykata e Qarkut në Pejë mban kompetencën lëndore të gjykojë këtë çështje.

Në pajtim me nenin 3 të Ligjit mbi Jurisdikcionin, Caktimi dhe Alokimi i Çështjeve për Gjykatësit dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë, Gjykatësit e EULEX-it të caktuar në procedurën penale do të kenë jurisdikcionin dhe kompetencën mbi çdo çështje që hetohet ose ndiqet nga ana e Prokurorëve Special të Republikës së Kosovës.

Kjo çështje ishte hetuar dhe aktakuza ishte ngritur nga Prokurori Special i Kosovës dhe, prandaj, në pajtim me nenin 4.7 të Ligjit mbi Jurisdikcionin (LJ), Trupi Gjykues i Gjykatës së Qarkut në Pejë ishte i përzier, në kuptimin se ishte i përberë nga dy Gjykatës të EULEX-it dhe nje Gjykatës lokal.

Asnjëra nga palët nuk kishte vërejtje mbi përbërjen e Trupit gjykues.

2. Shqyrtimi kryesor

Shqyrtimi kryesor është mbajtur me dyer të hapura më 11, 12, 17, 18, 19, 31 mars, 23, 24, 27 dhe 29 prill 2009, në praninë e të akuzuarit Gjëlosh Krasniqi, avokatit të tij mbrojtës Haxhi Millaku dhe Prokurorit Publik Special. Palët e dëmtuara ishin të pranishme në seancat dëgjimore të datës 11 dhe 12 mars, dhe 27 prill 2009. Në pajtim me nenin 15 të KPPK, përkthyesit ndërkombëtar kanë përkthyer gjatë procedurës gjyqësore dhe të gjitha dokumentet lidhur me gjykimin në gjuhën shqipe dhe angleze, sipas nevojës.

C. PËRMBLEDHJE E DËSHMIVE TË PARAQITURA

1. Gjatë procedurës së shqyrtimit kryesor, në pyetje janë marrë dëshmitarët në vijim:

- a) Gjergj LULI si dëshmitar dhe palë e dëmtuar më 11 mars 2009
- b) Zoje LULI si dëshmitare dhe palë e dëmtuar më 12 mars 2009
- c) Bekim LULI si dëshmitar më 12 mars 2009
- d) Engjell LULI si dëshmitar më 17 mars 2009
- e) Pren KASHNJETI si dëshmitar më 17 mars 2009
- f) Prenk LULI si dëshmitar më 17 mars 2009
- g) Mihill PERGEGA si dëshmitar më 18 mars 2009
- h) Gjergj QUNI si dëshmitar më 18 mars 2009
- i) Hazbi AXHAMI si dëshmitar më 19 mars 2009
- j) Miradije FEJZULLAHU si dëshmitare më 19 mars 2009
- k) Ismet JEMINI si dëshmitar më 19 mars 2009
- l) Gegë LLESHI si dëshmitar më 31 mars 2009
- m) Kolë KRASNIQI si dëshmitar më 31 mars 2009
- n) Pal KRASNIQI si dëshmitar më 23 prill 2009
- o) Pashk PERGEGA si dëshmitar më 23 prill 2009
- p) Robert PERGEGA si dëshmitar më 23 prill 2009
- q) Ermir SHEHU si dëshmitar më 24 prill 2009
- r) Pashk KRASNIQI si dëshmitar më 24 prill 2009

1. a) **Gjergj Luli**, në dëshminë e tij dhënë para Trupit gjykues, ka deklaruar se, më 24 mars 1999, ishte në oborrin e axhës së tij Mark Lulit (i ndjerë), së bashku me babain e tij Pashk Luli, djalin e axhës së tij Prenk Luli, Engjell Luli dhe Bekim Luli. Derisa ishin atje, pesë persona në uniformë (së paku tre nga ata mbanin armë të gjata) erdhën në oborr dhe kërkuan babain e tij. Sipas palës së dëmtuar ai nuk njohu asnjërin

nga ata, por njëri nga ata u prezantua si Gjeloš Krasniqi. Ai tha se ata deshën të bisedojnë me Pashkun, sepse ai ishte polic vendor. Pashku u afrua dhe pastaj ata kërkuan armët e tij; pasi ai ua dha armët, atij i thanë te shkojë me tad he ata u larguan nga oborri. Dy apo dy orë e gjysmë më vonë, personat e armatosur u kthyen me babain e tij, thanë se ai duhet të shkojë me ta në shtabin e UÇK-së dhe u larguan nga oborri.

Sipas palës së dëmtuar, pas asaj nate, Pashk Luli nuk është parë më ndonjëherë dhe ai është përpjekur të kuptojë se çfarë ka ndodhur me babain e tij; ka shkuar në Kryqin e Kuq në Gjakovë, por nuk ka marrë asnjë informacion lidhur me fatin e babait të tij, ka shkuar dy herë në shtabin e UÇK-së menjëherë pas luftës, por i është thënë se ata nuk dine asgjë. Ai ka kontaktuar autoritetet policore në Gjakovë dhe poashtu Policinë e UNMIK-ut në mënyrë që të marrë informacione lidhur me fatin përfundimtar të babait të tij por të gjitha përpjekjet e tij u dëshmuuan si të padobishme; pastaj hetuesit e ICTY (Tribunali i Hagës) shkuan në shtëpinë e tij dhe ai filloi të bashkëpunojë me ta. Ai u ka dhënë deklaratë atyre dhe ata poashtu kanë marrë mostra gjaku nga ai.

Gjatë dëshmisë së tij Gjergj Luli ka deklaruar më shumë se një herë se i pandehuri në gjykimin aktual (*id est* Gjeloš Krasniqi) nuk është personi i njëjtë me personin i cili, në natën kritike, ka hyrë në oborrin e axhës së tij dhe është prezantuar si Gjeloš Krasniqi. Për më tepër, ai ka deklaruar se para seancës konfirmuese, e cila është mbajtur më 19 janar 2009, ai kurrë nuk e kishte parë të pandehurin dhe se kurrë nuk e kishte takuar atë as menjëherë pas luftës e as në vitin 2008.

Këto janë udhëzimet kryesore të dëshmisë së palës së dëmtuar. Gjatë hetimeve pala e dëmtuar ka dhënë disa deklaratë. Është e domosdoshme të bëhet një përmbledhje e të gjitha deklaratave të dhëna para shqyrtimit kryesor, meqë ka mospërputhje të qarta në mes tyre dhe dëshmisë së dhënë në shqyrtimin kryesor.

Deklarata e dhënë hetuesve të ICTY (Tribunalit të Hagës) më 18.01.2003.

Në deklaratën e cekur më lart, Gjergj Luli ka pohuar se, më 24 mars 1999, rreth orës 20:30, pesë ushtarë të UÇK-së në uniforma kamuflazhë të gjelbëra kanë hyrë në shtëpinë e babait të tij. Ai njohu njërin nga ata dhe ai u prezantua si Gjeloš Krasniqi. Ai e ka ditur se ky person ishte nga fshati Nepole, Komuna e Pejës, dhe ishte diku rreth 30 vjeç. Ushtarët e UÇK-së ishin të armatosur dhe kishin shenja të UÇK-së në mëngët e tyre. Gjeloši u tha se babai i tij duhet të shkonte me ta, meqë ky ishte urdhri nga shtabi në Jabllanicë. Ai poashtu shtoi fjalët në vijim: “nëse Gega jep lejen, ata do ta lirojnë”. Ushtarët poashtu kërkuan armët në posedim të Pashkut. Gjergji deklaroi se, pasi ushtarët e armatosur kishin marrë babain e tij, ata kanë lënë një ushtar prapa të mbikqyrin njerëzit në oborr dhe shkuan, me babain e tij, te shtëpia e Ded Qunit, Mhill Pergegës, Tune Kashnjetit dhe morrën armët nga ata. Pastaj u kthyen, u bashkuan me ushtarin të cilin e kishin lënë prapa më parë, dhe u larguan nga oborri duke e marrë edhe Pashk Lulin me vete.

Duke u larguar, Gjeloš Krasniqi ka bërëtitur se do ta vrisnin si qenin, duke aluduar në babain e tij.

Në deklaratën e cekur më lart, pala e dëmtuar ka shtuar se Gjeloš Krasniqi, në kohën kur është dhënë deklaratë, jetonte në SHBA, Bronx – New York dhe se motra e tij Marta i ka

thënë se një herë, në gusht 2002, Gjelosh Krasniqi kishte shkuar në zyrën e saj (Marta në atë kohë udhëheqte një kompani udhëtuesh në New York të quajtur Dolphin travel) dhe i kishte thënë asaj: “Dëgjo, unë kam vrarë babanë tënd dhe për këtë gjë nuk merakosem fare, e as për ty”.

Deklarata e dhënë hetuesve të ICTY (Tribunalit të Hagës) më 02.03.2004.

Në deklaratën e cekur më lart Gjergj Luli ka dhënë disa informacione shtesë të cilat ai është frikësuar t’i japë më parë në lidhur me rrëmbimin e babait të tij. Ai kishte pasur frikë t’i zbulojë emrat e dy personave të cilat kanë mundur të jenë të përfshirë në rrëmbimin e babait të tij. Ai kishte mësuar këta emra nga Gjelosh Krasniqi, të cilin e kishte njohur si rrëmbyesin e babait të tij, kur e kishte takuar atë në fshatin e tij Doblëbare, dhe kur e kishte pyetur për vendndodhjen e babait të tij. Pra, Gjeloshi i kishte thënë se ai vetëm e kishte përcjellur deri në fshatin Maznik, por nëse ai dëshiron të zbulojë diçka lidhur me babain e tij, ai duhet të shkojë në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë dhe të flasë me Lahi Brahimaj dhe Maliq Ndrecaj.

Ai poashtu ka shtuar se, natën kur ishte marrë babai i tij, ishte terr dhe ka mundur të njohë vetëm Gjelosh Krasniqin.

Deklarata e dhënë Policisë së UNMIK-ut më 16.01.2008.

Në deklaratën e lartcekur Gjergj Luli ka pohuar se, në vitin 1998, në fshatin Doblëbare, UÇK kishte filluar mobilizimin. Në këtë periudhë, një person i quajtur Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole, Komuna e Pejës, së bashku me tre persona të tjerë, erdhën në Doblëbare dhe vodhën një veturë - Mercedes 190 – nga Pal Ndrecaj dhe e morrën në oborrin e tij në Nepole, por ia lanë Palit një Golf I të gjelbër. Pas njoftimit të shtabit të UÇK-së, ushtarët e UÇK-së shkuan te shtëpia e Gjeloshit në Nepole dhe ia kthyen veturën Palit.

Gjergji poashtu ka deklaruar se, më 24 mars 1999, rreth orës 20:00, familja e tij kishte shkuar te shtëpia e axhës së tij Nikolle Luli; rreth orës 20:15, Gjelosh Krasniqi, i veshur me xhakëtë kamuflazhë pa simbole të UÇK-së, ka hyrë në oborr, u kishte thënë të mos frikësohen, meqë ata ishin ushtarë të UÇK-së, dhe pastaj kërkoi mercedesin e Tule-së. Pasi ata shpjeguan se nuk kishin Mercedes, por vetëm VW Golf i cili nuk punonte, Gjeloshi shikoi veturën, derisa tre personat e tjerë, pa uniforma dhe maska, por të armatosur me AK-47 (Kalashnikov), qëndronin para tyre. Pastaj, pasi kontrolluan nëse vetura punonte, ai u kthye dhe pyeti ata: “cili nga ju jeni polic vendor ose do t’ju marrim të gjithëve në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë”. Atëherë babai i tij, Pashk Luli, u ngrit dhe u tha se ai ishte polici në fjalë. Gjeloshi poashtu kërkoi armët e babait të tij, një AK-47 dhe një pistoletë 7.65mm. Kur morri armët, urdhroi ushtarët e tjerë të kontrollojnë personat e tjerë. Pastaj, ata morrën babain e tij, lanë një person prapa dhe shkuan në fshat për të kërkuar armë dhe morrën armët e Gjergj Qunit, Gjoke Qunit, Mhill Pergegës dhe Tune Kashnjetit.

Rreth orës 23:30, Gjeloshi u kthye me dy shokët e tij dhe babain e tij dhe, pasi pinë pak ujë, Gjeloshi i tha babait të tij se ai duhet të shkojë me ta në shtab. Axha i Gjergjit, Mark Luli, pyeti poashtu se ku po e çonin dhe se ai kishte një mori fëmijësh, por përgjigja e

Gjeloshit ishte se secili nga ata do t'i jepnin atij 100 DM dhe se ai nuk ishte dashur të hyjë aty (*dmth të bëhet polic vendor*). Gjeloshi poashtu ka shtuar se nëse Gega dhe Mema e lirojnë atë, ata do të bënin të njëjtën gjë dhe pastaj i urdhëruan të qëndrojnë në shtëpi për një orë.

Katër ditë pas luftës, Gjergj Luli takoi Gjelosh Krasniqin në shtëpinë e Pashk Pergegës në fshatin Doblibare. Ai kërkoi nga djali i Pashkut, Robertin, të thërrasë Gjeloshin të cilin e pyeti se ku e kishte lënë babain e tij; Gjeloshi shpjegoi se ai e kishte lënë babain e tij në fshatin Maznik, se nuk dinte asgjë për të dhe se ai nuk duhej të shqetësohej duke e kërkuar sepse ai mund të humbiste në të njëjtën mënyrë sikur babai i tij. Dhe kur ai pyeti pse, përgjigja e Gjeloshit ishte se ai duhet të largohet sepse do ta kthente këtë fshat në "jeshil e zi".

Gjergj Luli në fund shtoi se, pas luftës, Gjeloshi kishte shkuar në SHBA ku kishte takuar motrën e Gjergjit, Marta Nrecaj-n, në vendin ku ajo punonte në një agjenci udhëtimesh dhe i kishte thënë asaj se babai i tyre ishte varrosur jo shumë larg shtëpisë së tyre.

Deklarata e dhënë Policisë së UNMIK-ut më 01.03.2008.

Në deklaratën e lartcekur, Gjergj Luli ka pohuar se, më 20.2.2008, kishte thirrur policing Hazbi në menyrë që ta njoftonte lidhur me disa kërcënime që kishte marrë. Veçanërisht, sipas Gjergj Lulit, një shok i tij, gjatë bisedës me Gjeloshin, i kishte thënë këtij të fundit se djemtë e Pashkut ishin duke u rritur dhe nëse ai do të gjendej në këpucët e Gjeloshit nuk do të ndihej aq i lirë të shëtitej rreth e përcark. Gjeloshi u përgjigj se ai do ta vriste dhe do ta zhdukte njësoj si babain e tij. Gjergji e dinte ngjarjen drejtëpërsëdrejti nga shoku i tij (emrin e të cilit Gjergji nuk donte ta zbulonte) dhe theksoi se familja e tij dhe ai ishin të frikësuar nga Gjelosh Krasniqi meqë ai ishte shumë i rrezikshëm. Gjergji poashtu deklaroi se si kishte dëgjuar se Gjeloshi kishte vrarë gruan e tij në SHBA dhe ishte kthyer në Kosovë me Mercedes ML320, me regjistrim të New York-ut. Poashtu, ai kishte shkuar në Kroaci për të ndërruar emrin por pa sukses.

Në deklaratën e lartcekur, Gjergji poashtu theksoi rrezikun të cilit i është ekspozuar dhe tha se nuk kishte ndonjë zgjidhje tjetër, por të shesë veturën e tij apo pronën tjetër në menyrë që të blejë një armë dhe të mbrojë veten dhe familjen e tij.

Deklarata e dhënë Policisë së UNMIK-ut më 26.08.2008.

Në deklaratën e lartcekur Gjergj Luli ka pohuar se, më 24 mars 1999, kur është marrë babai i tij, Gjelosh Krasniqi me katër persona të tjerë kishte urdhëruar personat që gjendeshin në oborr të qëndrojnë aty dy orë. Ai dhe axha i tij Mark Luli ishin afër portës kur Gjeloshi, i cili mbante Pashk Lulin nga njëra dorë, kaloi portën; pas një kohe Gjergji hapi portën, por Gjeloshi e pa dhe iu drejtua Gjergjit me këto fjalë: "mbylle derën dhe do ta vras si qenin".

Veç kësaj, Gjergji ka shtuar se, një muaj më parë, duke pritur shefin e tij, në një restorant të ushqimit të shpejtë në një pompë benzini, ai kishte dëgjuar një diskutim të dy personave brenda, duke thënë fjalët si në vijim: "Gjelosh Krasniqi është në situatë të keqe me një person nga fshati Doblibare dhe duhet të shkojmë në shtëpinë e tij". Pak kohë më vonë, më 06.08.2008, një person me emrin Pal Krasniqi, axha/daja i nënës së tij, një njeri

60 vjeçar, shkoi në shtëpinë e Gjergjit duke kërkuar “t’i ndihmojë Gjelosh Kasniqit dhe t’i tërheqë akuzat kundër tij, sepse ai nuk ka lidhje me vrasjen e Pashkut”. Përgjigjja e Gjergjit ishte se çështja ishte në duart e policisë dhe se ai donte vetëm të mbeturat mortore të babait të tij.

Deklarata e dhënë Policisë së UNMIK-ut më 07.10.2008.

Në deklaratën e lartcekur, Gjergj Luli ka pohuar se ai donte të tërheqë akuzat kundër Gjelosh Krasniqit sepse, pasi është konsultuar me familjen e tij, ata kishin vendosur të bëjnë kështu pasi babai i tij “kishte uniformën e gabuar të Policisë së Serbisë”, ishte i zhdukur për një kohë të gjatë dhe se donin të jetojnë një jetë të qetë. Ai ka deklaruar se nuk ka marrë kërcënime dhe se, edhe pse më parë kishte parë Gjelosh Krasniqin duke ecur në Gjakovë dhe se e kishte akuzuar, tani donte të tërhiqte të gjitha akuzat. Ai ka deklaruar se nuk e kishte parë Gjelosh Krasniqi pas lirim të tij nga paraburgimi, sepse ai ishte duke punuar në Shqipëri, por të afërmit e tij kishin kërkuar të kthehet në shtëpi dhe i kishin thënë se ata kishin vendosur të tërheqin akuzat kundër Gjeloshit. Ata nuk kishin marrë kërcënime, por ata të gjithë ishin pajtuar se donin të tërheqin akuzat kundër Gjeloshit.

Ballafaqimet e Gjergj Lulit me deklaratat e tij gjatë shqyrtimit kryesor

Duke marrë parasysh mospërputhjet e mëdha në mes të deklaratave të mëparshme dhe dëshmisë së dhënë para Trupit gjykues, dëshmitari Gjergj Luli shpesh është ballafaquar nga ana e Prokurorit dhe Trupit gjykues. Pjesët kryesore të ballafaqimeve janë paraqitur më poshtë.

* * *

Ballafaqimi lidhur me faktet (të mohuara nga Gjergj Luli gjatë shqyrtimit kryesor) se ai e kishte njohur të pandehurin para marrjes së Pashk Lulit dhe se ai e kishte takuar pas luftës.

Prokurori Publik: Me lejen e Trupit Gjykues, do të doja të kthehesha prapa në deklaratën e tij të mëparshme, folderi 2, nënfolderi 30, më datë 17 janar 2003; dhe gjithashtu më datë 18 janar 2003, faqja 172.

Por dua të filloj me këtë. Dua t’u pyes, a e njihni Gjelosh Krasniqin?

Gjergj Luli: Jo. Nuk e njoh.

Prokurori Publik: Do të shkoj në faqen 172, paragrafi i fundit dhe sipas deklaratës që ju i keni dhënë hetuesit ju keni thënë; më datë 24 mars 1999, në orën 20.30, 5 ushtarë të UÇK-se, në uniformë kamuflazhi të gjelbër, u futën në shtëpinë e babait tim në Doblbare. Unë njihja njërin prej tyre dhe ai prezantoi veten si Gjelosh Krasniqi.’

Kryetari i Trupit Gjykues: Ka mospërputhshmëri të madhe midis asaj që u lexua nga Prokurori Publik dhe deklaratës që ju sapo dhatë para Trupit Gjykues pesë minuta më parë. Mund të na sqaroni? Pse i keni deklaruar tribunalit ndërkombëtar se ju e njihni Gjelosh Krasniqin dhe se pesë personat që u futën në shtëpinë e babait tuaj ishin të veshur me uniforma të UÇK-së?

Gjergj Luli: Ata nuk u futën në shtëpinë e babait tim dhe unë nuk e njihja Gjeloš Krasniqin. Ai vetëm se e prezantoi veten si Gjeloš Krasniqi. Kjo duhet të sqarohet. Dhe unë nuk kam thënë kurrë se ata kishin uniforma të gjelbërta.

Kryetari i Trupit Gjykses: Këtë e kemi të shkruar këtu dhe ju e keni nënshkruar. Domethënë ju po thoni se (ndërpritet)

Gjergj Luli: Po por përkthyesi (ndërpritet)

Haxhi Millaku: Ai do të thotë se përkthyesi nuk i ka lexuar atë që ka nënshkruar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju keni dhënë deklaratën në shqip?

Gjergj Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si e nënshkruat versionin anglisht?

Gjergj Luli: Pasi dhashë deklaratën ishte një hetues ndërkombëtar Kelly, dhe unë e nënshkrova, aty ishte gjithashtu edhe Hazbije.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po por në deklaratën e tij shkruhet gjithashtu, në deklaratën të cilës i referohet Prokurori Publik, se më është lexuar në gjyhen shqipe dhe kjo është e vërtetë në bazë të njohurive dhe kujtesës time më të mirë dhe nënshkrimi juaj.

Për prokurorin Publik dhe Avokatin Mbrojtës, këtë e gjeni në faqen 72. Sepse ju deklaruat se ju e keni lexuar në shqip.

Gjergj Luli: Nuk më është lexuar. Ara më pyetën nëse unë doja të lexoja por unë nuk e lexova.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju e keni nënshkruar këtë por ky nënshkrim thotë se kjo deklaratë, e cila është në anglisht, u është lexuar në anglisht. Ju e keni bërë të ditur këtë pra kini kujdes sepse ju e dini se dëshmitari është i detyruar të thotë të vërtetën dhe se dëshmia e rreme përbën vepër penale. Domethënë ju insistoni se deklarata e 18 janarit 2007, nuk u është lexuar në shqip?

Gjergj Luli: Nuk më është lexuar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në lidhje me faktin se ju nuk e njihni Gjeloš Krasniqin, ju thatë se një person prezantoi veten si Gjeloš Krasniqi, e saktë?

Gjergj Luli: Po, unë nuk e njihja atë më parë por ai person u prezantua si Gjeloš Krasniqi.¹

Prokurori Publik: Dua të vazhdoj aty ku e lashë më parë. Sipas deklaratës ju keni thënë (i referohet Gjeloš Krasniqit), e dija se ai ishte nga fshati Nipole në komunën e Pejës dhe se ai ishte rreth të 30-ave. Të gjithë ushtarët e UÇK-së ishin të armatosur dhe ata kishin stema të UÇK-se në sup. Si është futur kjo në deklaratë, sepse më parë ju thatë diçka tjetër?

¹ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 11.03.2009, faqe 13 – 14

Gjergj Luli: Unë nuk kam thënë asnjëherë diçka në lidhje me shenjat, kjo nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik: Por ju e keni nënshkruar.

Gjergj Luli: Unë e kam nënshkruar por nuk e kam thënë atë.

Prokurori Publik: Nëse shikojmë faqen 174, ju u keni thënë hetuesve si në vijim, **'Për shkak se unë e njihja Gjeloş Krasniqi që më parë dhe e pashë atë personalisht me uniformë të UÇK-se që hyri në shtëpinë e babait tim, unë jam njëqind për qind i sigurt se ai është personi që mori babain me vete, pa dallim nëse ai ishte në UÇK apo jo.'**

Gjergj Luli: kjo nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik: Ju e keni firmosur.

Gjergj Luli: Hetuesit kanë bërë fotografi në oborr dhe kjo nuk është shtëpia ime.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne jemi ata të cilët vlerësojmë se çfarë është e rëndësishme. Ju jeni këtu për t'u përgjigjur pyetjeve. Prokurori Publik po u tërheq vëmendjen në lidhje me faktin se ju i thatë Trupit Gjykses se ju nuk e njihni Gjeloş Krasniqin, ndërkohë që në këtë deklaratë ju keni thënë dy herë se ju e njihni Gjeloş Krasniqin dhe se ju e keni parë atë kur hyri dhe se kishte veshur uniformë të UÇK-së.

Gjergj Luli: Unë kam thënë gjithmonë në oborrin e axhës dhe jo në atë të babait, ky është ndryshim i madh.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju keni sqaruar se ishte oborri i axhës dhe jo ai i babait. Tani sqaroni këtë; mospërputhshmëria midis deklaratës tuaj të mëparshme dhe atë çka po thoni në gjyq.

Gjergj Luli: Unë nuk e njoh atë, ai e prezantoi veten si Gjeloş Krasniqi, kështu që unë nuk shoh mospërputhshmëri.

Kryetari i Trupit Gjykses: kjo nuk varet nga ju; ju thjesht përgjigjuni pyetjeve të cilat po u bëhen si dëshmitar. Ju vazhdoni të tjhoni se ju nuk e njihni Gjeloş Krasniqin, ju nuk e njihni atë tani apo ju nuk e njihni atë në 1999?

Gjergj Luli: Atëherë unë nuk e njihja atë; ai prezantoi veten si Gjeloş Krasniqi. Tanmi unë e njoh atë që nga seanca e konfirmimit të aktakuzës dhe unë doja atë ditë të thosha diçka por gjithçka ishte shumë shpejt. Personi që q tëherë u fut në oborr ishte më i shkurtër dhe më i trashë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Më i trashë se kush?

Gjergj Luli: Se Gjeloş Krasniqi, personi që është këtu. Unë mund të deklaroj se ky nuk është i njëjti person.

Kryetari i Trupit Gjykses: Domethënë personi që në 1999 prezantoi veten si Gjeloş Krasniqi nuk është personi i pranishëm?

Gjergj Luli: Jo, nuk është i njëjti.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po në lidhje me uniformat e UÇK-së, sepse ju thatë se personi që u prezantua si Gjeshosh Krasniqi kishte veshur uniformë të UÇK-së.

Gjergj Luli: Unë nuk kam thënë kurrë uniforma të UÇK-së, unë kam thënë vetëm uniforma.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju nuk mund të vazhdoni kështu. Tani ju mund të thoni se juve u kujtohet se nuk keni parë persona të veshur me uniforma të UÇK-së dhe kjo do të merret në konsideratë nga Trupi Gjykses. Cila është përgjigja juaj, kishin të veshur ata uniforma të UÇK-së?

Gjergj Luli: Jo.²

Prokurori Publik: Dua të vazhdoj me të njëjtën deklaratë, faqja 173; para se të bëj atë dua të pyes; kur njerëzit, të cilët morën babain tuaj me vete, u larguan nga shtëpia a thanë diçka?

Gjergj Luli: Po.

Prokurori Publik: Çfarë?

Gjergj Luli: Nëse Gege Lleshi dhe Meme Lleshi e lirojnë edhe ne do ta lirojmë.

Prokurori Publik: Vetëm këtë thanë?

Gjergj Luli: Ata thanë gjithashtu, nuk guxonin të dilnin nga oborri para dy orsh.

Prokurori Publik: Thanë diçka tjetër?

Gjergj Luli: Asgjë.

Prokurori Publik: A u përpoqët të shihni se ku po e çonin babain tuaj; a dolët ju jashtë kur ai po dilte nga shtëpia?

Gjergj Luli: Jo.

Prokurori Publik: Dua të lexoj atë që ju i keni thënë hetuesve (faqja 173). Është paragrafi i fundit dhe këtu thuhet se se kur ata po dilnin nga shtëpia, Gjeshosh Krasniqi tha se ata do ta vrisnin qenin domethënë babain tuaj. A u kujtohet se ua keni thënë këtë hetuesve?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: Si ka mundësi që kjo është në deklaratë?

Kryetari i Trupit Gjykses: Tani juve nuk u kujtohet, por është e vërtetë apo jo se ju i keni dëgjuar këto fjalë?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet ti kem thënë këto fjalë.

² Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 11.03.2009, faqe 14 - 16

Kryetari i Trupit Gjykses: Tani që Prokurori Publik ua rifreskoi kujtesën, a u kujtohet?

Gjergj Luli: Jo.

Haxhi Millaku: Ju po flisni për fakte dhe ai po i referohet deklaratës.

Kryetari i Trupit Gjykses: Prokurori Publik u ka tërhequr vëmendjen në lidhje me deklaratën që keni dhënë hetuesve të tribunalit Ndërkombëtar. Në këtë deklaratë është shkruar se kur këta persona po dilnin nga shtëpia, Gjelos Krasniqi bërtiti se ata do ta vrisnin qenin domethënë babain tuaj. Kjo ishte përgjigja juaj në atë kohë. Tani që ju jeni para Trupit Gjykses, po u pyes përsëri, u kujtohet ky fakt apo jo?

Gjergj Luli: Siç thashë ai u prezantua (gjyqtari e ndërpret)

Kryetari i Trupit Gjykses: Unë po mendoj, personi që u prezantua si Gjelos Krasniqi dhe shqiptoi këto fjalë, domethënë?

Gjergj Luli: Ai nuk ka thënë fjalë të tilla.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si ka mundësi që në deklaratë ka një përgjigje tjetër?

Gjergj Luli: Në fillim, gjithashtu për fjalët se Gege dhe Meme do të lirojnë babain tuaj, unë nuk i them ato, por pasi Mark Luli përmendi fjalët se nëse Gege dhe Meme do ta lirojnë babain tim, pastaj unë thashë të njëjtën përgjigje si Mark Luli.

Kryetari i Trupit Gjykses: po në lidhje me këto fjalë; ne do ta vrasim qenin?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet se janë thënë këto fjalë.

Ferdinando Buatier: Por ju e përjashtoni mundësinë se janë thënë këto fjalë?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet se i kam thënë këto fjalë.

Kryetari i Trupit Gjykses: I përjashtoni apo jo?

Gjergj Luli: Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: Është mundur që të jenë thënë?

Gjergj Luli: Nëse nuk jam i sigurt nuk mund të përgjigjem..³

Prokurori Publik: Le të kthehemi dhe një herë në deklaratën e tij, ju shkua në Zyrën e Tribunalit Ndërkombëtar që të kërkonit babain tuaj. Dua t'u ballafaqoj me fagen 167 paragrafin 3, ju i keni thënë hetuesit: "Unë kam ardhur spontanisht në zyrën e Tribunalit Ndërkombëtar në Prishtinë, me dëshirën time për të kërkuar prova për babain tim. Kur unë u intervistova në janar të 2003, kisha frikë të spjegoj gjithçka, nuk guxova të jepja dy emrat që ishin të përfshirë në rrëmbimin e babait tim por tani dua të shtoj këtë infomacion."

³ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 11.03.2009, faqe 16 – 17

Siç lexohet në këtë deklaratë ju keni nuk keni shkruar vetëm për babain tuaj por edhe për të plotësuar deklaratën tuaj.

Gjergj Luli: Unë nuk i kam përmendur kurrë këta emra, nëse doni të më ballafaqoni me këto emra m'i thoni këta emra.

Prokurori Publik: Paragrafi 4, 'emrat që nuk guxoja ti përmendja ishin Lahi Ibrahimaj dhe Maliq Ndrecaj. I pari ishte nga Jabllanica dhe tjetri ishte nga Klina'. Këto ishin emrat që ju nuk dhatë gjatë deklaratës së parë dhe që dhatë gjatë deklaratës së dytë.

Gjergj Luli: Nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik: Por ju keni nënshkruar deklaratën.

Gjergj Luli: Unë nuk e kam përmendur kurrë këtë. Çdo gjë tjetër është shkruar por jo kjo. Ju duhet të lexoni deklaratat deri në fund.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju nuk jeni këtu për të dhënë urdhra askujt. Kur flet një anëtar i Trupit Gjykses ju duhet të heshtni. Ju jeni këtu për t'u përgjigjur pyetjeve nga Prokurori Publik, Avokati Mbrojtës apo një anëtar i Trupit Gjykses. Pra po ju paralajmëroj mos jepni urdhra askujt sepse kjo nuk është detyra juaj. Pra ju thatë se nuk i keni thënë kurrë ato emra?

Gjergj Luli: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra Zyra e Tribunalit Ndërkombëtar i ka trilluar këto gjëra sepse ata i kanë shkruar këto emra?

Gjergj Luli: Nuk e di. Unë nuk i kam përmendur ata.

Kryetari i Trupit Gjykses: Por kini parasysh se ju keni nënshkruar.

Gjergj Luli: Po, unë kam nënshkruar por unë nuk i kam përmendur ato emra.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në paragrafin 4 ju keni thënë diçka më precize 'Unë mësova nga Gjelosh Krasniqi për Lahi Ibrahimaj dhe Maliq Ndrecajt të cion unë e kam identifikuar si një nga rrëmbyesit e babait tim – unë e morra këtë informacion rreth 4 muaj pas mbarimit të luftës – kur rastësisht takova Gjelosh Krasniqin në fshatin tim Doblbare. E pushë në rrugë në fshatin tim dhe iu afrova për ta pyetur se ku ndodhej babai im.'

Haxhi Millaku: Në lidhje me atë që lexuat, Z.Kryetar, unë lexoj tani, unë takova Gjelosh Krasniqin në shtëpinë time në fshatin Doblbare, kjo është në kundërshtim me deklaratën e mëparshme. Ishte në fshat apo në shtëpinë e tij? Gjithashtu në pikën 7, ka një kontradiktë tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Le të shikojmë njëherë pjesën më të rëndësishmë pastaj do të vazhdojmë. Këtu, ju keni thënë se i keni dëgjuar këto emra nga Gjelosh Krasniqi 'të cilin identifikoj si një nga rrëmbyesit e babait tim.' Çfarë keni për të thënë tani?

Gjergj Luli: Gjërat që janë shkruar aty, se unë e kam takuar Gjelosh Krasniqin në shtëpinë timë nuk është e vërtetë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dua të di nëse i keni dëgjuar këto emra nga Gjeloš Krasniqi?

Gjergj Luli: Unë takova një person që quhej Gjeloš Krasniqi, në fshat por nuk është i njëjti person që është ulur tani në sallën e gjyqit.

Ferdinando Buatier: Personi që rrëmbeu babain tuaj?

Gjergj Luli: Po dhe se unë kam takuar Gjeloš Krasniqin nuk është e vërtetë, unë nuk e kam thënë këtë kurrë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në fshatin tim të lindjes jo në fshatin tim.

Gjergj Luli: Unë thashë shtëpi por tani po e saktësoj se është fshati im.

Prokurori Publik: Paragrafi 5, thuhet se Gjeloš Krasniqi ka thënë 'çfarë ka ndodhur me babain më duhet të shkoj në Shtabin e UCK-se në Jabllanicë dhe duhet të flas me Lahi Ibrahimaj dhe Maliq Ndreca. Gjeloš Krasniqi më tha se ai e eskortoi babain tim në fshatin Maznik.'

Paragrafi 7, 'kur babai im u rrëmbye ishte errësirë dhe unë arrita të identifikoja vetëm Gjeloš Krasniqin si një nga rrëmbyesit.' A u kujtohet se keni deklaruar këtë njërit nga hetuesve?

Agim Hajdini është përkthyes tani

Gjergj Luli: Duke u bazuar në emrin e kam thënë atë.

Prokurori Publik: Personi që ju përmendët Gjeloš Krasniqi, nuk është Gjeloš Krasniqi që është sot i ulur këtu?

Gjergj Luli: Jo, nuk është.⁴

Ballafaqimi lidhur me kërcënimet a raportuara nga ana e shokut të Gjergjit.

Prokurori Publik: A ju ka kërcënuar dikush pas luftës, me qëllim që të tërhiqeni nga kjo lëndë?

Gjergj Luli: Jo.

Prokurori Publik: Keni dëgjuar gjë më lidhje me një kërcënim që ka të bëjë me emrin tuaj?

Gjergj Luli: Jo.

Prokurori Publik: Nënparagrafi 27, faqja 149, është deklaratë e dhënë më datë 1 mars 2008, hetuesve të UNMIK-ut dhe se ishte oficeri Hazbi, kur ju keni dhënë deklaratën si në vijim: 'Një shok i imi, i cili po pinte diçka me Gjeloš Krasniqin, ai tha Gjeloš Krasniqi a ndihesh i lrë tani që djemtë e Pashkut janë rritur.' Përgjigja e tij ishte se 'Do ta vras si i ati dhe do ta zhduk si të

⁴ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 11.03.2009, faqe 23 – 25

atin dhe se shokët e mi më kanë informuar në telefon për këtë dhe se ata më kërkuan të mos përmend emra, për arsye sigurie për atë dhe familjen e tij. Familja ime dhe unë vetë kemi frikë nga Gjelosh Krasniqi sepse ai është person shumë i rrezikshëm.’ E mbani mend këtë?

Gjergj Luli: Nuk kam thënë kisha frikë.

Prokurori Publik: Pyetja ime ishte, e mbani mend se ua keni thënë hetuesve të UNMIK-ut?

Gjergj Luli: E kam dhënë këtë deklaratë.

Prokurori Publik: Por sot ju thoni se ju jeni kërcënuar nga një person i tretë.

Gjergj Luli: Jo.

Prokurori Publik: Tani u hutova.

Kryetari i Trupit Gjykses: Këtu është shkruar se ‘Unë kam frikë nga Gjelosh Krasniqi sepse ai është shumë i rrezikshëm’. Pse ishit i frikësuar ju?

Gjergj Luli: Unë nuk e kam thënë kurrë këtë.

Kryetari i Trupit Gjykses: 10 minuta më parë ju e thatë këtë. Këtu nuk po flisni me shokë, këtu jeni në gjykatë.

Anila Shehu është përkthyes tani

Gjergj Luli: Unë e di se çfarë kam thënë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju nuk keni shumë fat sepse të gjitha herët që ju jepni deklaratë ju pastaj e ndryshoni.

Gjergj Luli: Por unë nuk kam thënë kurrë se kisha frikë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, por ju e keni nënshkruar dhe është në shqip.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po në lidhje me fjalët e cituara nga Prokurori Publik: ‘Do ta vras atë siç vras babain e tij’. Kjo tingëllon si kërcënim.

Haxhi Millaku: Këto fjalë nuk janë thënë nga dëshmitari por ju lutem citoni të gjithë frazën dhe jo vetëm një pjesë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në rregull por nuk mendoj se kuptimi ndryshon. Do ta lexoj. ‘Do ta vras atë siç vras babain e tij dhe do ta zhduk siç zhduka babain e tij.’

Gjergj Luli: Ky nuk është kërcënim, përveç kur dikush vjen në derën time.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne nuk jemi këtu për të dhënë përkufizimin e kërcënimit; ne jemi këtu për të ditur nëse ky shoku juaj ka referuar ju fjalët e thëna nga Gjelosh Krasniqi.

Gjergj Luli: Mua më thanë kështu.⁵

Ballafaqimi me faktin se, më 7 tetor, dëshmitari ka tërhequr të gjitha akuzat kundër të pandehurit:

Kryetari i Trupit Gjykses: Nuk mund të mohoni faktin se më datë 7 tetor 2008 ju keni dhënë deklaratatë në polici.

Prokurori Publik: kjo ishte deklarata e fundit që keni dhënë në lidhje me këtë rast. Ju kujtohet se pse keni dhënë atë deklaratë, shkuar ju atje?

Gjergj Luli: Nuk më kujtohet.

Prokurori Publik: Po ua freskoj kujtesën. Në faqen 134 pyetjes se pse jeni këtu sot ju i jeni përgjigjur se doni të tërhiqni akuzat kundër Gjeloosh Krasniqit. E mbani mend këtë?

Gjergj Luli: Po.

Prokurori Publik: Ju kujtohet se pse vajtët në polici, për çfarë arsye tërhoqët akuzat?

Gjergj Luli: Tani më kujtohet. Arsyja që bëra këtë bazohej në emrin e tij sepse atëherë unë nuk e njihja atë dhe ata thanë se ai ishte liruar nga burgu sepse atëherë nuk e njihja atë. Kur dëgjova se ai ishte liruar shkova të pyesja Kelly dhe Hazbinë për arsyen e lirimt të tij dhe ata më thanë se ata nuk e dinin sepse ai ishte liruar me urdhër të gjykatës. Pastaj unë thashë se nëse ai ishte liruar nga gjykata atëherë dhe una mund ta bëj këtë. Kjo ishte pra; Kelly dhe Hazbi më thanë se ai ishte liruar nga prokuroria dhe gjykata. Atëherë unë thashë se meqënëse ata e kishin liruar ai duhet të ishte i pafajshëm; por më duhet të theksoj faktin se unë nuk e njihja atë atëherë si fytyrë.

Prokurori Publik: Por ju tani po merreni me 2 Gjeloosh Krasniqi? Ju thatë se ju njihnit vetëm si emër atë që kishte ardhur në shtëpinë tuaj dhe se njihnit një Gjeloosh Krasniqin që ishte paraburgosur nga policia. Pse donit të tërhiqnit padinë kundër dikujt që ju mendint se i kishte bërë diçka babait tuaj?

Gjergj Luli: Unë nuk e njihja atë por prokuroria vendosi ta lironte atë pa marrë parasysh faktin nëse ai ishte i njëjti që kishte ardhur atë natë. Meqënëse ai ishte liruar nga prokuroria dhe gjykata dhe unë tërhoqa padinë pa marrë parasysh nëse ai ishte i njëjti person apo dikush tjetër.

Prokurori Publik: Për çfarë arsye tërhoqët padinë?

Haxhi Millaku: Ai u përgjigj njëherë.

Prokurori Publik: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Është e vërtetë që ai u përgjigj. Nëse ka ndonjë nmospërputhje ju mund ta ballafaqoni.

⁵ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 11.03.2009, faqe 27 – 28

Prokurori Publik: Në vazhdim, rreshti 3, ku thotë pse, dhe përgjigja ishte se pasi u konsultova me anëtarët e familjes time vendosa të tërheq padinë sepse babai im kishte veshur uniformën e gabuar të policisë serbe. Kjo nuk është e njëjta arsye që ju dhatë më parë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ka ndryshim.

Gjergj Luli: Është e vërtetë. Unë bisedova me familjen time kur ai u lirua nga burgu.

Kryetari i Trupit Gjykses: Cila ishte arsyeja e vërtetë; sepse babai juaj kishte veshur uniformën e gabuar apo se ai ishte liruar me urdhër gjykata?

Gjergj Luli: Unë dëgjova se personi i cili u prezantua si Gjeloš Krasniqi ishte larguar nga burgu. Unë bisedova për këtë me familjen time dhe pasi fola me Kelly dhe Hazbi dhe pasi ata më thanë se ai ishte liruar nga gjykata dhe prokuroria dhe pasi bisedova me familjen familja ime tha se ai është i pafajshëm sepse ai është liruar nga gjykata dhe prokuroria për ne ai është i pafajshëm.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo është arsyeja që ju dhatë në fillim të deklaratës tuaj, por Prokurori Publik u kujtoi se në policisë ju nuk keni dhënë këtë arsye, por ju keni thënë vetëm se ju bëtë këtë sepse babai juaj kishte veshur uniformën e gabuar të policisë serbe.

Gjergj Luli: Arsyeja e vërtetë ishte sepse ai ishte liruar nga prokuroria dhe gjykata dhe gjithashtu sepse ai kishte veshur uniformën e gabuar. E para është më e rëndësishmja.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse nuk i thatë policisë arsyen më të rëndësishme? Përkundrazi, ju dhatë arsyen më pak të rëndësishme; kjo është sjellje e çuditshme, apo jo?

Gjergj Luli: Unë e kam deklaruar arsyen time se ai ishte liruar nga gjykata dhe prokuroria por përmenda gjithashtu edhe uniformën.⁶

Ballafaqimi lidhur me Mercedesin 320 që pretendohet të jetë vozitur nga i pandehuri:

Prokurori Publik: Dua të vazhdoj me të njëjtën deklaratë. Më poshtë, fjalia e cila fillon me 'pastaj ai erdhi', është paragrafi i gjatë, aty thuhet: 'Pastaj ai erdhi (ai është Gjeloš Krasniqi) në Kosovë dhe voziste një a Mercedes 320, me targa të Neë York-ut, pastaj ai vajti në Kroaci, dhe në informacionit që kemi, ai shkoi në Kroaci që të ndryshonte identitetin (emrin dhe mbiemrin) por nuk pati sukses për këtë. Pasi u kthye nga Kroacia, ai ndenji disa javë në Kosovë dhe pastaj shkoi në Shqipëri dhe u kthye me një BMË me targa shqiptare.'

Gjergj Luli: Mua më kanë thënë se ai shkoi në Shqipëri por unë nuk e kam parë kurrë.

Prokurori Publik: Si ka mundësi që dikush u tha se ai është kthyer me Mercedes me targa të Neë York-ut?

Gjergj Luli: Sepse ata e kishin parë atë.

⁶ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 11.03.2009, faqe 32 – 33

Prokurori Publik: Kush janë ata?

Gjergj Luli: Disa njerëz dhe ndoshta ata e kishin njohur.

Prokurori Publik: Kush janë 'ata'? 'Emrat?'

Gjergj Luli: Disa nga njerëzit e mi.

Prokurori Publik: Emrat?

Gjergj Luli: Unë duhet të di në fillim nëse informacioni i tyre ishte korrekt, pastaj do të them emrat.

Prokurori Publik: Emrat.

Kryetari i Trupit Gjykses: Përgjigjuni pyetjeve të Prokurorit Publik.

Gjergj Luli: Nuk mund t'u jap këtë informacion.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju nuk mundeni apo nuk doni?

Gjergj Luli: Nuk mundem.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse?

Gjergj Luli: Sepse më thanë që të mos u jepja emrat.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ky personi që voziste BMW?

Gjergj Luli: Cili?

Kryetari i Trupit Gjykses: BMW me targa shqiptare.

Gjergj Luli: Unë nuk e njoh atë. Nuk e kam parë atë kurrë.⁷

Ballafaqimi lidhur me takimin me të pandehurin në Gjakovë pas luftës:

Ferdinando Buatier: Le të kthehemi tani tek i dyshuari në këtë gjykim. Ju thatë se atë e patë për herë të parë në seancën e konfirmimit?

Gjergj Luli: Po.

Ferdinando Buatier: Në deklaratën tuaj, në policinë ndërkombëtare të UNMIK-ut në tetor 2008, faqja 135, ju i keni thënë hetuesit se ju e akuzuat atë pasi e patë në Gjakovë. Kjo është deklarata

⁷ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 11.03.2009, faqe 29 – 30

juaj e 7 tetorit. Kujt personi i referoheni; këtij të dyshuari apo atij që morri babain tuaj apo të dyve?

Gjergj Luli: Personin të cilin e pashë atë natë kur ata erdhën në shtëpi. Më vonë, pas luftës unë e takova në fshat.

Ferdinando Buatier: Pse thoni se më datë 7 tetor 2008 se ju e keni akuzuar sepse e keni parë në Gjakovë. Ju e keni thënë këtë. E pashë në Gjakovë dhe e akuzova.

Gjergj Luli: Unë nuk kam thënë se e kam parë. Unë thashë vetëm se ai ishte atje.

Ferdinando Buatier: Është deklarata juaj dhe e keni firmosur.

Gjergj Luli: Nuk e kam parë pasi kam qenë duke punuar gjithë ditën.⁸

1. b) Zoje Luli, në dëshminë e saj dhënë para Trupit gjykues, ka deklaruar se ka qenë e martuar me Pashk Lulin dhe ata kishin shtatë fëmijë. Bashkëshorti i saj ka punuar si polic vendor për Policinë e Serbisë për një periudhë prej 6 apo 7 muajsh. Ajo nuk e ka ditur nëse bashkëshorti i saj i ka pasur armët që i janë dhënë atij nga serbët pasi gratë nuk përzihen në këto çështje.

Në mbrëmjen kur është zhdukur bashkëshorti i saj, ajo kishte qenë në shtëpinë e kumatit të saj, Mark Lulit, ulur me Terezën, nusen e djalit të saj, tre djemtë dhe vajzën e saj të vogël, kur djali i Mark Lulit erdhi dhe tha se ata e kishin marrë Pashk Lulin.

Ajo nuk kishte ndërmarrë asgjë në mënyrë që të zbulojë vendndodhjen e bashkëshortit të saj, ajo as nuk ka biseduar kurrë me djalin e saj lidhur me atë çfarë ka ndodhur atë natë. Ajo ka deklaruar se asgjë nuk mund të bëhej në mënyrë që të zbulohet se kush ishte fajtori.

Më poshtë është një ekstrakt nga proceverbali i datës 12.03.2009:

Zoje Luli: Nuk mund ta gjejmë atë që e ka bërë. Unë nuk mund të bëj asgjë.

Kryetari i Trupit Gjykues: A doni drejtësi apo nuk është e rëndësishme?

Zoje Luli: Po, ai shkoi. Nuk kam çfarë të bëj tash. Nuk mund t'i humbas bijt. Nuk mund të bëj asgjë tash. Kisha kaq shumë telashe për të rritur të bijt. Mezi që ia kam dalë çdo muaj.

Kryetari i Trupit Gjykues: I kuptoj telashtet që kishit. Por ju pyes a jeni ende të interesuar për të pasur drejtësi lidhur me rrëmbimin e burrit dhe lidhur me faktin që burri nuk është kthyer më. Apo e keni mendjen tash te gjëra të tjera, te fëmijët e juaj? Dua ta di, se a është e zgjidhur kjo çështje për ju.

Zoje Luli: Vetëm fëmijët e mi. Nuk më intereson asgjë tjetër. Vetëm fëmijët me interesojnë.

Ferdinando Buatier: Ju thatë që ju interesojnë vetëm fëmijët?

⁸ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 11.03.2009, faqe 39 – 40

Zoje Luli: Po, sepse mezi që i rrita. Ua kushtova gjithë jetën atyre dhe burri im nuk është më.

Ferdinando Buatier: A po e thoni këtë sepse nuk dëshironi të i humbni fëmijët tuaj?

Zoje Luli: Asgjë nuk mund të ndodhë. Jeta ime është për fëmijët e mi.

Ferdinando Buatier: Ju thatë që nuk mund të i humbni bijt e juaj. Pse e thoni këtë?

Zoje Luli: Nuk dua të shkoj më tutje. Jeta ime është për fëmijët e mi. I kam rritur me lëmoshe, me bukë bajate.

Ferdinando Buatier: Pse frikësoheni se mund t'i humbni ata?

Zoje Luli: Nuk frikësohem, por jeta ime është për fëmijët e mi.

Ferdinando Buatier: Puna është se se ju thate që nuk doni të i humbni ata.

Zoje Luli: Nuk dua të largohem nga fëmijët e mi. Me shumë telashe i rrita.⁹

1. c) Bekim Luli, një kushëri i largët i viktimës, në dëshminë e tij para Trupit gjykues, ka deklaruar se, natën që është zhdukur Pashk Luli, ai ishte në shtëpinë e vëllait të Pashkut, Kolës, duke shikuar TV, kur pesë persona me uniforma të UÇK-së dhe armë të gjata kanë hyrë në oborr të shtëpisë. Ata kërkuan Pashk Lulin meqë ata e dinin se ai ishte polic vendor. Njëri nga ushtarët u prezantua si Gjeloshi dhe kërkoi Pashk Lulin. Si pasojë, Pashku u lajmërua dhe tha se ai ishte Pashk Luli. Pak kohë më vonë, ushtarët kërkuan armët e tij dhe ai dorëzoi një armë të gjatë. Pastaj, ata i thanë të shkojë me ta te disa shtëpi të tjera për të marrë armë dhe kur ata shkuan, lanë një person prapa, por ai nuk e di arsyen pse, meqë ai shkoi në shtëpinë e tij dhe nuk e ka ditur çfarë ka ndodhur më vonë.

Të nesërmen ai ka kuptuar nga djali i Pashkut, Gjergji, dhe nga njerëzit e tjerë, se e kishin marrë Pashkun.

Në deklaratën e mëparshme dhënë Policisë së UNMIK-ut më 16.03.2008, Bekim Luli ka deklaruar se:

më 24 mars 1999, rreth orës 20:00/20:30, Bekimi dhe disa të afërm të tij ishin në shtëpinë e axhës së tij Nikol Lulit duke shikuar lajmet në TV. Kur Bekimi doli nga shtëpia, ai takoi axhën Prenk i cili i tha të mos ketë frikë, sepse kanë ardhur disa ushtarë të UÇK-së. Kur ai përshëndeti ushtarët, ata pyetën, kush është Pashk Luli, dhe pastaj axha i tij Pashku u lajmërua dhe u prezantua. Në oborr ishin shtatë ushtarë, në mes tyre ishte Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole, Komuna e Pejës, ai nuk i kishte njohur të tjerët.

Gjeloshi kërkoi nga axha i tij Pashku armët, një Kalashnikov dhe një pistoletë, dhe pastaj i tha që të shkojë me ta në fshat për të marrë edhe armë të tjera. Kur dolën, ata lanë një ushtar prapa dhe thanë se do të kthehen me Pashkun.

⁹ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 12.03.2009, faqe 7.

Rreth orës 23:00, kur Bekimi deshi të shkojë në shtëpinë e tij, u pengua nga ushtari i UÇK-së i cili ishte lënë prapa, por kur Gjelooshi dhe axha i tij u kthyen, Bekimi nuk ishte më aty. Ai ka shtuar se, sipas mendimit të tij, vetëm Gjeloosh Krasniqi mund të dijë se ku gjenden të mbeturat e axhës së tij Pashk Lulit.

Në fund, ai theksoi se, derisa vëllai i tij Engjell Luli ishte duke punuar si rojë në një pompë benzine, ishte kërcënuar nga ana e Gjeloosh Krasniqit.

Duke marrë parasysh mospërputhjet në mes të deklaratës së mëhershme dhe dëshmisë së dhënë para Trupit gjykues, dëshmitari Bekim Luli ishte ballafaquar si në vijim:

Prokurori Publik: Tani po i referohem deklaratës së dhënë në polici, nënparagrafi 21, faqe 110. A ju kujtohet që keni biseduar me hetues të UNMIK-ut?

Bekim Luli: Kur e kam dhënë deklaratën?

Prokurori Publik: Po, paragrafi i parë, pothuajse në fund, fjalia fillon “në oborr”. A e keni thënë ju këtë?

Bekim Luli: Nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik vazhdon të lexojë deklaratën.

Prokurori Publik: Sipas kësaj, ju keni identifikuar Gjeloosh Krasniqin si drejtues të grupit.

Bekim Luli: Nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik: Madje, ju thoni që ky është nga fshati Napol, vend i cili është vendbanimi dhe vendlindja e Gjeloosh Krasniqit. Si është e mundur që nuk është e vërtetë, kur ju e keni nënshkruar?

Bekim Luli: Nuk është e vërtetë.

Prokurori Publik: Pra, si e keni ditur që ky vjen nga fshati Napol?

Bekim Luli: Unë kurrë nuk kam thënë që është nga fshati Napol.

Prokurori Publik: Kjo është deklarata juaj dhe ju e keni nënshkruar. Thuhet qartë: Gjeloosh Krasniqi, Napol, Pejë dhe ju e keni nënshkruar.

Bekim Luli: Nuk është e vërtetë.

Kryetari i Trupit Gjykues: Por, ju e keni nënshkruar. Si mund të thoni që nuk e keni thënë këtë?

Bekim Luli: Jam i bindur që nuk e kam thënë, këto janë manipulime që ka mund t'i ketë futur gazetari.

Kryetari i Trupit Gjykues: Nuk e kemi fjalën për gazetar. Prandaj, keni kujdes kur thoni manipulime. Tani pasi që Prokurori Publik ju ka përkujtuar dhe ju ka ballafaquar, si ju kujtohet tani?

Bekim Luli: *Më kujtohet që deklarata ime nuk ishte kaq e gjatë.*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Nuk është e vërtetë sepse filluat në 14:13 dhe mbaruat në 14:47.*

Haxhi Millaku: *Më duket që e fjalën për vendin në fshat, po thuhet gjëra të ndryshme, prandaj gjithë ky konfuzion.*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Sa për qartësim të mëtutjeshëm, sa gjatë keni qëndruar në oborrin e axhës suaj?*

Bekim Luli: *Para se të vijmë këta 5 njerëz, isha aty një orë, ata vetëm erdhën, morën axhën dhe unë shkova ishte shumë shkurt.*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Pasi që erdhën 5 persona, sa gjatë keni qëndruar aty?*

Bekim Luli: *Ata erdhën dhe thanë që do ta marrin. Pra, jo gjatë. Mbase 15 minuta, jo më shumë.*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Pastaj keni shkuar?*

Bekim Luli: *U largova nga shtëpia e axhës sim.*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Tani është e qartë. Por, si ju kujtohet pasi që u ballafaquat nga Prokurori Publik dhe ju përkujtoj që deklaratën nuk e keni dhënë para 5 viteve, por në mars 2008.*

Bekim Luli: *Deklarata*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Mos më flisni për deklaratën. Por, si ju kujtohet?*

Bekim Luli: *Deklarata ishte e shkurtër. Nuk i njoha 5 njerëzit që erdhën. Nuk mund të fajësoj*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Nuk i përgjigjeni pyetjes sime. Pasi që Prokurori Publik ju ballafaqoi me deklaratën tuaj, si ju kujtohet?*

Bekim Luli: *Incidenti*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Vetëm fakte specifike.*

Bekim Luli: *Isha aty shumë shkurt, por e di çfarë thashë në deklaratë, e cila është marë në shtëpinë e axhës Pashk Lulit. Kur fillova, më pyetën gjëra të tilla si, a e njoh GjeloSh Krasniqin.*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Më duhet t'ju ndërpres. Nuk më intereson deklarata. Si ju kujtohet tani? Ju thatë një gjë, Prokurori Publik ju përkujtoi tjetër gjë dhe tani thoni diçka tjetër.*

Bekim Luli: *Nuk di si t'ju sqaroj. Unë fola për incidentin.*

Kryetari i Trupit Gjykses: *Po, por ka mospërputhje dhe jeni të obliguar të jepni qartësim, prandaj, ju lutim që të përgjigjeni. Jo në deklaratë, por këtu për Trupin Gjykses, ju keni thënë që ndër pesë personat që u futën në oborr, njëri u prezantua si GjeloShi, këtë e keni thënë këtu. Prokurori Publik u ngrit dhe tha që janë pësuar ndryshime ngase në deklaratën e dhënë më 16*

mars 2008, ju keni thënë diçka tjetër, keni thënë që kanë qenë 7 ushtarë të UÇK-së, në mesin e tyre ishte edhe Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepol. Pastaj shtoi, unë nuk i kam njohur ushtarët e tjerë. Kjo fjali do të thotë që ju e keni njohur Gjelosh Krasniqi dhe që e keni ditur që ai ishte nga fshati Nepol. Nëse unë nuk e njoh një person, atëherë nuk mund të them se nga cili fshat është. A e kuptoni tani ndryshimin në mes të dy deklaratave?

Bekim Luli: *Unë kam dhënë vetëm një deklaratë.*

Kryetari i Trupit Gjykses: Po, një këtu dhe një në polici. Pasi që këtu ekziston një ndryshim, Trupi Gjykses dëshiron ta kuptojë se si ju kujtohet tani dhe ju jeni të obliguar të na thoni të vërtetën.

Bekim Luli: *Unë po ju them të vërtetën. Unë kurrë nuk kam thënë që ky është Gjelosh Krasniqi.*

Kryetari i Trupit Gjykses: Si ju kujtohet tani? Mos na përsëritni deklaratën tuaj të mëparshme. Si ju kujtohet tani, ju lutemi të përgjigjeni.

Bekim Luli: *Isha aty shumë shkurt dhe nuk kisha mundësi ta njoh ndonjërin prej tyre.*

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra, kjo është përgjigja e juaj.

Prokurori Publik: Në pyetjen se sa apo çfarë armësh, ju thatë armë me tyta të gjata, por nuk ia dolët që t'i shihni.

Bekim Luli: *Jo, se nuk isha aty.*

Prokurori Publik: Fillimisht, ju i keni thënë policisë që Gjelosh Krasniqi i mori këto dy armë dhe i tha Pashk Lulit që të vie me ta në fshat për të marrë akoma më shumë armë. Si është e mundur që para një vitit, ju keni thënë që ishte një Kalashnikov dhe një pistoletë?

Bekim Luli: *Isha aty kur iu është marrë arma e gjatë. Kur shkova të nesërmen, më thanë që iu është marrë edhe pistoletë.*

Prokurori Publik: Sipas deklaratës, ju keni qenë aty kur iu janë marrë armët.

Bekim Luli: *Nuk është e vërtetë. Deklaratën e kam dhënë më vonë.*

Prokurori Publik: Pse e keni nënshkruar deklaratën?

Bekim Luli: *E nënshkrova sepse i afërmi më tha që i kishin marrë pistoletën.*

Prokurori Publik: Pse e keni nënshkruar deklaratën?

Bekim Luli: *Të nesërmen më treguan për pistoletë.*

Prokurori Publik: Po, por nuk i përgjigjeni pyetjejs sime.

Bekim Luli: *Po, ishte e shkruar në deklaratë, siç më është thënë, pistoletë është marrë.*

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa për qartësim, pasi që keni qenë në oborr kur erdhën për ta marrë Pashk Lulin, si nuk e keni parë kur ka dorëzuar armën dhe pistoletën?

Bekim Luli: Kur erdhën njerëzit, unë nuk isha në oborr, isha në shtëpi duke shikuar televizion. Dola jashtë dhe Prenku më tha që kanë ardhur 5 ushtarë. I dëgjova kur kërkuan armët.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kënd e dëgjuat?

Bekim Luli: Njëri ndër të pestit që e quajti veten Gjelosh.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e keni parë Pashk Lulin duke dorëzuar armët?

Bekim Luli: Po, armën.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e keni parë me dy armët, apo vetëm me një?

Bekim Luli: Isha brenda, prandaj nuk ishte e mundur që të shihja.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju thatë që e keni parë viktimën duke dorëzuar armët?

Bekim Luli: Armën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pistoletën apo armën e gjatë?

Bekim Luli: Armën e gjatë.....¹⁰

1. d) Engjell Luli, në dëshminë e tij para Trupit gjykses, ka deklaruar se i kujtohet që i ka dhënë deklaratë një polici dhe fillimisht ka konfirmuar se, në atë deklaratë, ai është pajtuar me atë çfarë ka thënë vëllai i tij Bekimi. Megjithatë, në pjesën tjetër të dëshmisë së tij, ai ka mohuar që ka njohur Gjelosh Krashniqin dhe ka thënë se një person, të cilin nuk e ka njohur, natën e 24 marsit 2009, ka hyrë në oborrin e axhës së tij Nikoll Luli dhe vetëm është prezantuar si Gjelosh Krashniqi.

Ai ka shtuar se hera e fundit që ka parë axhën e tij Pashk Lulin ishte nata që ishte marrë nga këta persona: ai ishte në shtëpinë e axhës së tij Nikoll Lulit kur erdhën pesë persona, rrethuan njerëzit që ishin në oborr dhe kërkuan Pashk Lulin. Këta njerëz ishin ushtarë të UÇK-së në uniforma ushtarake, gjë që dëshmitari e kishte kuptuar pastaj. Personi që i udhëheqte ishte pak i shkurtër dhe i plotë/shëndoshë. Pashk Luli u lajmërua dhe pastaj ata e morën dhe shkuan në fshat, ai nuk e ka ditur në cilin drejtim.

Në deklaratën e tij të mëhershme dhënë Policisë së UNMIK-ut më 16.03.2008, Engjell Luli ka deklaruar:

ai ka qëndruar pranë deklaratës së vëllait të tij Bekim Luli i cili kishte shpjeguar se, më 24 mars 1999, Pashk Luli ishte marrë nga Gjelosh Krasniqi, nga fshati Nepole dhe se Gjeloshi ishte së bashku me ushtarë të tjerë të UÇK-së.

¹⁰ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 12.03.2009, faqe 14 – 17.

Për më shumë, ai ka deklaruar se, pas luftës, derisa ishte duke punuar në pompë benzine, në fshatin Doblibare, Gjelosh Krasniqi kishte vozitur aty pari dhe kishte ndaluar veturën dhe e kishte pyetur se ku ishte Lusi (pronari i pompës së benzinës). Ai ishte përgjigjur se Lusi nuk ishte aty dhe Gjeloshi kishte thënë se nëse ai do të dilte nga vetura do ta shkatërronte pompën e benzinës dhe do ta digjte.

Duke marrë parasysh mospërputhjet në mes të deklaratës së mëparshme dhe dëshmisë së dhënë përpara Trupit gjykues, dëshmitari Engjell Luli ishte ballafaquar si në vijim:

Prokurori Publik: Kisha dëshiruar që ju të kujtoni 16 Marsin e vitit të kaluar, a ju kujtohet se keni dhënë një deklaratë një polici së bashku me vëllauin e juaj Bekimin?

Engjell Luli: Po, ne dhamë daklarata.

Prokurori Publik: A ju kujtohet çfarë keni thënë lidhur me deklaratën e vëllaut dhënë policisë? A ka mundësi i Nderuari Kryetar ti bëjë disa pyetje lidhur me deklaratën? Në këtë mënyrë unë do ta ballafaqojë atë me fjalët e tija. Po i referohem deklaratës që gjindet në faqet 102 deri 105 dhe është në dosjen e lëndës. A ju kujtohet ti keni thënë policisë se ju tërësisht pajtoheni me deklaratën e dhënë nga vëllau i juaj Bekimi?

Engjell Luli: Mund të përgjigjem vetëm për deklaratën time por nuk mundem të jap përgjigje për deklaratën e vëllaut tim.

Prokurori Publik: A ju kujtohet të keni thënë në polici me sa vijon: “Unë plotësisht pajtohem me deklaratën e vëllaut tim Bekimit i cili ka deklaruar lidhur me humbjen e axhës tonë Pashk Lulin i cili u morr nga Gjelosh Krasniqi së bashku me ushtarët tjerë të UÇK-së”?

Engjell Luli: Unë nuk isha me Bekimin. Isha vetëm. Mund të betohem për këtë.

Prokurori Publik: A ju kujtohet ti keni thënë këtë policit?

Engjell Luli: Deklaratën time, po.

Prokurori Publik: A ju kujtohet kjo që unë sapo ju citova nga deklarata e juaj?

Kryetari i Trupit Gjykues: A po e kuptoni pyetjen? A ju kujtohen këto fjalë të sakta se ju qëndronit mbrapa deklaratës së dhënë nga ana e vëllaut të juaj Bekimit? E kuptuat pyetjen e Prokurorit Publik?

Engjell Luli: Po. Siç edhe thashë, ne ishim katër vëllëzër dhe kur ata pyetën për Pashk Lulin, axha im u ngrit....

Kryetari i Trupit Gjykues: Më duhet të ndërhyjë. Kjo nuk është pyetja. Prokurori Publik ju ballafaqojë juve me deklaratën e mëparshme në të cilën ju keni thënë, dhe ai ju citoi fjalët e juaja: “Unë plotësisht pajtohem me deklaratën e vëllaut tim Bekimit i cili ka deklaruar lidhur me humbjen e axhës tonë Pashk Lulin i cili u morr nga Gjelosh Krasniqi së bashku me ushtarët tjerë të UÇK-së.” Kjo është ajo përfarë keni thënë me 16 Mars 2008. A qëndroni pranë asaj çfarë keni thënë me 16 Mars?

Engjell Luli: Po, kjo është çfarë kam thënë.

Prokurori Publik: Ju jeni në dijeni për deklaratën që vëllau i juaj i dha policisë sepse ju i thatë policisë se ju pajtoheni me atë çfarë tha Bekimi.

Engjell Luli: Po, ne ishim bashkë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju ishit bashkë kur ju u intervistuat nga policia?

Engjell Luli: Së pari vëllau im, e pastaj unë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Së pari vëllau i juaj u intervistua e pastaj u intervistuat ju, por a ishit gjatë gjithë kohës bashkë?

Engjell Luli: Jo.

Ferdinando Buatier: Derisa Bekimi u intervistua, a ishit ju në dhomë?

Kryetari i Trupit Gjykses e informon Gjergj Lulin, i cili si duket nuk ndihet mirë, se ai mund ta lëshon sallën e gjykimit kur të dëshiron.

Engjell Luli: Jo. E kuptova të tërën. Së pari, ishte Bekimi i cili u intervistua.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si e keni ditur përmbajtjen e daklaratës së vëllaut tuaj?

Haxhi Millaku: Në përgjegjjen e dhënë në pyetjen e parë të Prokurorit Publik dhe e cila u shënuar në procesverbal, dëshmitari tha: "Unë jam intervistuar në fshatin Doblibare". Nuk mund ti referohemi një zyre.

Kryetari i Trupit Gjykses: Unë mendova për dhomë dhe përkthyesi pordori fjalën "zyre". Meqë ju keni thënë me 16 Mars se ju qëndroni pranë deklaratës së vëllaut të juaj Bekimit, si ka mundësi që ju të dinit për këtë deklaratë? A e keni dëgjuar çfarë ai i ka thënë policit apo ju është lexuar deklarata e vëllaut tuaj?

Engjell Luli: Nuk dijë të lexojë.

Prokurori Publik: Ju është lexuar?

Engjell Luli: Njeri nga ata që ishte aty e lexoi.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte ai polic?

Engjell Luli: Ai nuk kishte të veshur uniformë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte ai Amerikan apo Shqiptarë?

Engjell Luli: Një nga secili.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ai që e lexoi ishte Shqiptar?

Engjell Luli: Po.¹¹

Prokurori Publik: Do ta përsëris deklarimin në vijim nga deklarata e vëllaut tuaj. Kjo ju është lexuar juve: “Në oborrin e shtëpisë së Axhës tim Nikollës ishin shtatë ushtarë të UÇK-së. Ndër ta ishte Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole, komuna e Pejës dhe se ushtarët tjerë nuk i kam njohur.” Ju u pajtuat me atë deklaratë në Mars të 2008. A do të pajtoheni tash me atë deklaratë?

Engjell Luli: Po, por kurrë nuk kam thënë Gjelosh Krasniqi. Ai është prezentuar si Gjelosh Krasniqi. Tani, nuk e njoh atë dhe as që e kam njohur.

Prokurori Publik: Vëllau i juaj tha se e kishte njohur atë dhe ju u pajtuat me vëllaun e juaj.

Engjell Luli: Nuk është e vërtetë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju nuk mund të thoni ashtu sepse ju e keni nënshkruar deklaratën. Ju mund të thoni se tani memoria ime ka ndryshuar. Cila është memoria juaj tani?

Engjell Luli: Nuk po di çfarë të them. Cila është memoria ime? Dhjetë vite kanë kaluar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju jeni këtu për të na shpjeguar se cila është memoria juaj. Me 16 Mars, ju qëndruat pranë deklaratës së vëllaut tuaj i cili tha se e njohu Gjelosh Krasniqin duke shtuar gjithashtu se ai është nga fshati Nepole. Vëllau i juaj nuk tha thjesht : “Kam pa dikë” ai tha: “Unë kam pa Gjelosh Krasniqin” i cili është nga fshati i caktuar. Konkluzioni logjik është se ai e ka njohur Gjelosh Krasniqin, dhe në të njëjtë ditë ju keni thënë se ju pajtoheni plotësisht me atë deklaratë, që do të thotë se atë natë edhe ju e keni pa Gjelosh Krasniqin dhe se edhe ju keni patur njohuri se ai është nga fshati Nepole. Kjo është çfarë keni thënë me 16 Mars. Ju nuk mund ta mohoni meqë e keni nënshkruar. Kjo është në dosjen e lëndës dhe është histori dhese do të vlerësohet nga gjykata. Ju jeni këtu për të na shpjeguar memorien e juaj të tanishme. Ne e dimë se cila ishte memoria e juaj me 16 Mars. Nuk është e dobishme të thuhet unë nuk e kam thënë këtë, sepse ju e keni nënshkruar. Ju jeni këtu në këtë moment natyrisht të na informoni për memorien e tanishme për fakte e vitit 1999. Cila është memoria e juaj tani?

Engjell Luli: Ai e ka prezentuar veten e tijë. Unë nuk e njoha. Nëse e kisha njohur kisha për ta thënë e njoha. Nuk po e mohoj deklaratën të cilën e kam dhënë. Përveq kësaj unë i kam humbur dy ditë të punës. Ai ka menduar se unë kam ikur dikund. Policia erdhi në shtëpinë time dhe

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju mund ta ngritni këtë çështje kur të përfundojë dëshmia e juaj, jo tani. Meqë memoria e juaj tani është kjo që ju nuk e keni njohur Gjelosh Krasniqin, pse keni thënë me 16 Mars se Gjelosh Krasniqi ishte nga fshati Nepole? Është njëjtë....

Haxhi Millaku ndërhyrë: Kryetari i Trupit Gjykses ka vendosur tanimë për këtë kundërshtim dhe është në procesverbal.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si është e mundur që të jetë ky mospajtim?

¹¹ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 17.03.2009, faqe 5 – 7.

Engjell Luli: Çfarë kam thënë atë ditë, ju e keni para vetes. Nuk e dijë se çfarë kam thënë para 10 viteve.

Kryetari i Trupit Gjykses: E keni thënë këtë një vit më parë e jo 10.

Engjell Luli: Po, 2008.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse keni thënë diçka tjetër një vit më parë?

Engjell Luli: Nuk e kam njohur atë, por unë i kam dhënë ato deklaratatave.

Kryetari i Trupit Gjykses: Memoria e juaj e tanishme është se ju nuk e keni njohur atë por të gjithë ne dojmë të dimë pse është ky ndryshim në mes të dy deklaratave. Prokurori Publik, Avokati Mbrojtës dhe Trupi Gjykses dëshirojnë ta dinë. Është ndryshim i rëndësishëm në mes dy deklaratave.

Engjell Luli: Nuk ka dallime. Nuk e dijë çfarë tha ai apo si e tha ai.

Kryetari i Trupit Gjykses: "Ai". Kush?

Engjell Luli: Ju thoni se unë e kam ndëruar mendjen.

Kryetari i Trupit Gjykses: Nuk është puna se ju e keni ndëruar mendjen, por është mospërputhja në mes të dy deklaratave dhe dua ta dijë pse?

Engjell Luli: Cilave deklaratatave?

Ferdinando Buattier: Në 2008, ju thatë, duke ju kujtuar deklaratatave të vëllaut tuaj Bekimit, se ju e keni njohur Gjeshosh Krasniqin dhe që ai ishte nga fshati Nepole. Sot, ju thatë se nuk e njihni Gjeshosh Krasniqin dhe personin të cilin ju nuk e njihni e ka prezentuar veten si Gjeshosh Krasniqi. Pse po i thoni dy gjëra të ndryshme?

Engjell Luli: Ai e prezentoi veten si Gjeshosh Krasniqi por unë nuk e njoha atë.

Ferdinando Buattier: Ju e keni parasysh se ka dallim në mes të asj se çfarë thoni sot dhe çfarë keni thënë një vit më parë. Këto janë dy gjëra të ndryshme.

Engjell Luli: Më vjen keq por nuk po kuptojë.

Ferdinando Buattier: Sot ju thatë se nuk e njihni Gjeshosh Krasniqin por një vit më parë, ju keni thënë se e njihni.

Engjell Luli: Nuk e kam thënë atë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju nuk mund ta mohoni se e keni thënë një gjë të tillë. Ju mund të thoni se ju kujtohet ndryshe. Ashtu siç edhe e thatë se e kujtoni ndryshe dhe ne jemi këtu për të ju pyetur pse. Nëse na thoni pse, ne do ta marrim në parasysh përgjegjen. A mund të na shpjegoni pse është ky dallim? Nëse nuk mund ta shpjegoni, kjo është në rregull. Cila është përgjegjja juaj?

Engjell Luli: Nuk e di.

Prokurori Publik: Unë do të ju lexojë një pjesë të deklaratës me të cilën ju jeni pajtuar, dhe kjo është deklarata që vëllau i juaj Bekimi i ka dhënë policisë me 16 Mars 2008 dhe e cila ju është lexuar juve dhe ju jeni pajtuar me të: "Së pari, Gjelosh Krasniqi kërkoi nga Axha im Pashk Luli të ia jep armët..."

Kryetari i Trupit Gjykses: Ai nuk e ka mohuar se axha i tijë i dorëzoi disa armë. Është më mirë ta pyesni se a i dorëzoi axha i tijë armët apo jo dhe nëse ka mospërputhje atëherë ju mund ta ballafaqoni.

Prokurori Publik: A i është kërkuar axhës suaj ti dorëzoi armët Gjelosh Krasniqit dhe ushtarëve të tjerë?

Engjell Luli: Po, axha i im ju dha atyre armët.

Prokurori Publik: A u bë kjo me urdhërin e Gjelosh Krasniqit?

Engjell Luli: Po.¹²

Prokurori Publik: Dëshiroj të ju pyes për kohën pas mbarrimit të luftës dhe sa kuptojë ju ishit duke punuar në pompë të benzinës të quajtur Alfa dhe se e njehta gjindet në fshatin Doblbare.

Engjell Luli: Po.

Prokurori Publik: A ju kujtohet se në një kohë Gjelosh Krasniqi të ketë ardhë në atë pompë të benzinës?

Engjell Luli: Ai kaloi pranë asaj rruge.

Public Prosecutor: A keni folur me te?

Engjell Luli: Nga distanca prej 5 metrave.

Prokurori Publik: Sa kohë pas përfundimit të luftës?

Engjell Luli: Ishte errët. Ishte natë.

Prokurori Publik: Sa javë pas luftës?

Engjell Luli: Nuk mund të ju gënjej por ishte menjëherë pas luftës. Shumë shpejtë pas luftës.

Prokurori Publik: Na tregoni për takimin e juaj me Gjelosh Krasniqin në pompën e benzinës menjëherë apo shpejtë pas luftës.

Engjell Luli: Unë nuk kam patur takim me te.

Prokurori Publik: Bisedën ose fjalët që u folën?

¹² Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 17.03.2009, faqe 8 – 10.

Engjell Luli: Ai më foli prej rrugës.

Prokurori Publik: Çfarë thatë ju?

Engjell Luli: Ai më tha: "Nëse do të afrohem te ti, do ta hedhi në erë pompën e benzinës." Përgjigjja ime në këtë ishte, se i forti mund të bëjë gjithçka.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush e tha këtë, ju apo Gjeshosh Krasniqi?

Engjell Luli: Unë e thashë.

Prokurori Publik: A e keni parë Gjeshosh Krasniqin që nga ajo kohë në pompën e benzinës?

Engjell Luli: Jo.

Prokurori Publik: Në këtë sallë gjykimi e shihni Gjeshosh Krasniqin? Kthehuni dhe i shikoni të gjithë.

Dëshmitari kthehet mbropa për të shikuar rreth sallës së gjykimit.

Engjell Luli: Nuk më kujtohet. Ai ishte më i shkurtër dhe më i shëndosh.

Prokurori Publik: Cili Gjeshosh Krasniqi? Ai i cili e morri axhën e juaj apo ai në pompën e benzinës?

Engjell Luli: Ai ishte në makinë dhe nuk doli jashtë. Nuk munda ta shoh.

Prokurori Publik: Gjeshosh Krasniqi i cili e morri axhën e juaj dhe ai në pompën e benzinës a janë personi i njejtë, apo nuk janë?

Engjell Luli: Ishte errët dhe një distancë prej 5 metrave.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në oborrin e axhës tuaj apo në pompën e benzinës?

Engjell Luli: Pasi që ata e morrën axhën tim.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ishte errët në oborrin e axhës tuaj?

Engjell Luli: Ishte errët.

Kryetari i Trupit Gjykses: Takimi në pompën e benzinës, a ishte ditën apo natën?

Engjell Luli: Ishte natë. Isha duke punuar si rroje.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte errët apo jo? Zakonisht pompat e benzinës janë mirë të ndriçuara.

Engjell Luli: Ishte errët.

Kryetari i Trupit Gjykses: Edhe në pompën e benzinës?

Engjell Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ai Gjelos Krasniqi i cili e morri axhën e juaj dhe ai të cilin e takuat në pompën e benzinës a ishin person i njejtë apo jo? Po ose jo?

Engjell Luli: Po më hutoni.

Kryetari i Trupit Gjykses: Unë nuk po ju hutojë. Personi i cili e prezntoi veten e tij si Gjelos Krasniqi e morri axhën e juaj dhe këtë na e thatë gjatë dëgjimit. Për pyetjen e Prokurorit Publik, ju thatë se, pas luftës ju e keni parë Gjelos Krasniqin në pompën e benzinës. Unë po ju pyes nëse Gjelos Krasniqin që e patë duke e marrë axhën e juaj dhe Gjelos Krasniqin që ju e patë në pompën e benzinës, a është person i njejtë apo jo? Është pyetje shumë e thjeshtë.

Engjell Luli: Unë nuk pata bisedë të gjatë me të....

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishin ata person i njejtë apo jo?

Engjell Luli: Jo, ata ishin të ndryshëm.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra, kjo është përgjegjja juaj. Meqë këta dy persona janë dy persona të ndryshëm, pse nuk e përmendët këtë në deklaratën e juaj të dhënë para një viti? Së pari, ju thatë, unë pajtohem në tërësi me deklaratën e vëllaut tim dhe në atë deklaratë është thënë tregimi për rrëmbimin e axhës tuaj nga ana e një grupi njerëzish në mesin e të cilëve ishte Gjelos Krasniqi dhe pastaj në deklaratën e dhënë nga ju me 16 Mars, ju thoni që, pas luftës, unë e kam parë Gjelos Krasniqin. Rjedhim logjik, i cili nxirret nga kjo deklaratë, është që dy Gjelos Krasniqat, njëri që e morri axhën e juaj dhe tjetri në pompën e benzinës, janë person i njejtë. Tani ju po thoni se janë dy persona të ndryshëm. Pse nuk e keni thënë këtë me 16 Mars? Edhe pse ju jeni i pashkollë, ju e kuptoni se kjo është e rëndësishme.

Engjell Luli: Ishte përkthyesi që e bënte përkthimin. Ju mund ti thoni çfarë të doni Gjykatësit dhe ndoshta ju mund të përdorni fjalë sharje dhe unë nuk do ta kuptojë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo deklaratë është në gjuhën Shqipe. Nuk ka asgjë të bëjë me përkthimin.

Engjell Luli: Unë tashmë ju thashë dhe ju skjarova. Nuk kam për të shtuar asgjë këtu apo në deklaratë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dua ta dijë pse ju nuk e keni theksuar këtë që këta dy persona që mbajnë emrin Gjelos Krasniqi ishin dy persona të ndryshëm.

Engjell Luli: Ndoshta dikush e merr emrin e një personi që nuk është ai person dhe mund që të dëmtojë dikend tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse ju nuk e keni përmendur këtë dallim?

Engjell Luli: Nuk dijë ta shpjegojë këtë. Ju po më shkatroni.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë po mendoni me këtë? A po frigohehi nga ndonjë gjë?

Engjell Luli: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pse?

Engjell Luli: Nuk dua që të ia shkatërojë dikujt fatin.

Kryetari i Trupit Gjykses: A keni marrë ndonjë kërcnim lidhur me dëshminë e juaj që do ta jipni para kësaj gjykate?

Engjell Luli: Kurrë nuk kam marrë.¹³

Kryetari i Trupit Gjykses: Kam një apo dy sqarime për ju. Këta ushtarë ishin me uniforma, a i keni njohur këto uniforma? Apo a e keni njohur disi ushtrinë?

Engjell Luli: Uniforma ishte e njejtë si e çdo ushtrie tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqë në deklaratën e 16 Marsit 2008 ju thoni se “axha im Pashk Luli u morr nga Gjelosh Krasniqi së bashku me ushtarët e tjerë të UÇK-së.” Këtë e keni thënë me 16 Mars 2008. Tani, cila është memoria e juaj?

Engjell Luli: Ai ka thënë se ishte Gjeloshi. Ai e kishte të veshur uniformën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra personi që e prezantoi veten si Gjelosh Krasniqi kishte të veshur uniformën?

Engjell Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Të tjerët poashtu?

Engjell Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si mund ta njihni uniformën e UÇK-së, meqë siç thatë ju ishte errët?

Engjell Luli: Ishte errët.

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqë ishte errët, dhe për këtë arsye ju nuk keni mundur ta njihni fytyrën e personit i cili e prezantoi veten is Gjelosh Krasniqi, si i keni njohur këto uniforma?

Engjell Luli: E kuptuam këtë pastaj.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si e kuptuat këtë pastaj?

Engjell Luli: E kupova se ishte ushtria e jonë. Pra e Shqiptarëve.

¹³ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 17.03.2009, faqe 12 – 15.

Ferdinando Buatier: A ta ka thënë këtë dikush?

Engjell Luli: Askush nuk ma tha. Sepse kjo ishte kur filloi lufta. Ne e dinim se cilat plë janë të përfshira.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju thoni se ishte përfundim i juaji se ata ishin ushtarë të UÇK-së, jo diçka se juve ju është treguar drejtpërdrejtë?

Engjell Luli: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo përgjegje nuk është në përputhje me atë çka ju na thatë para pak kohe.

Engjell Luli: Ishte errët, ai kishte të veshur uniformë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju nuk e njohët ndonjë simbol në uniformë?

Engjell Luli: Nuk e di. Unë doja të kthehesha te familja ime.¹⁴

1. e) Pren Kashnjeti, në dëshminë e tij përpara Trupit gjykses, ka deklaruar se ai kishte njohur Pashk Lulin që nga fëmijëria, sepse të dy ishin nga fshati i njëjtë, Doblibare, dhe se Pashku kishte punuar si polic lokal/vendor për dy apo tre muaj.

Natën e 24 marsit 1999 ai kishte parë Pashk Lulin me tre apo katër ushtarë të UÇK-së, duart i kishte të lidhura prapa shpine. Më specifikisht, kur ata arritën në shtëpinë e Prenit, Pashku thërriti “Kumbarë Tune” dhe Preni ka dalë. Kur ai pa Pashkun dhe ushtarët, ai pyeti Pashkun: “Çfarë po ndodh”. Pashku u përgjigj se ai nuk e dinte. Pastaj ushtarët kërkuan armët e axhës së tij Tune Kashnjetit dhe Tuna dorëzoi pushkën e tij.

Pasi i ishte lexuar një pjesë e deklaratës së tij të mëhershme, ai konfirmoi se axha i tij Tuna, dy javë përpara natës së 24 marsit 1999, tashmë ishte marrë nga pjesëtarët e UÇK-së, se ishte mbajtur dy netë dhe se një pistoletë ishte marrë nga ai.

Ai nuk kishte njohur asnjëri, por kishte dëgjuar se Gjelosh Krasniqi, natën që ishte marrë Pashku, kishte qenë në mes të ushtarëve të cilët kishin ardhur në oborrin e tij duke kërkuar Tunën.

Gjatë dëgjimit të tij tetë fotografi (fotot e njëjta i ishin treguar tashmë gjatë fazës së hetimeve) i ishin paraqitur atij duke e pyetur nëse mund të njohte Gjelosh Krasniqin. Përpara Trupit gjykses ai veçoi dy foto: njëra nga fotot që ai veçoi (fotoja në faqen 126, këndi i djathtë poshtë) ishte fotoja e Gjelosh Krasniqit (edhe pse emri nuk është shkruar nën këtë foto, lehtë mund të konkludohet se kjo foto përfaqëson të pandehurin, duke e krahasuar me fotot e të pandehurit në faqet dy dhe tre të dosjes së shënjuar Materialet faqet 0-179).

Në deklaratën e mëparshme të dhënë Policisë së UNMIK-ut më 16.03.2008, Pren Kashnjeti ka deklaruar se:

¹⁴ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 17.03.2009, faqe 21 – 22.

më 24 mars 1999, rreth orës 22:00, Pashk Luli ka thirrur në oborrin e Prenit: “Kumbarë Tunë”: Preni ka dalë dhe ka parë Pashk Lulin me gjashtë apo shtatë persona në uniforma të UÇK-së, por ai nuk kishte njohur asnjërin nga ushtarët. Pashk Luli kishte duart e lidhura prapa. Ai ka pyetur: “Çfarë po ndodh, Pashk”, dhe përgjigjja e tij ishte: “Nuk e di”.

Pastaj, njëri nga ushtarët pyeti për axhën e tij Tune Kashnjetin dhe, kur Tuna doli, ata kërkuan armën që e kishte Tuna; kur ai ua dha armën ata thanë se do ta kthejnë, por kurrë nuk e bënë këtë.

Preni ka deklaruar se ka dëgjuar se personi që e ka marrë Pashk Lulin atë natë ishte Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole, Komuna e Pejës dhe, sipas dëshmitarit; ata kishin marrë Pashk Lulin sepse ai ishte polic vendor që punonte për qeverinë jugosllave. Sa dinte ai, Pashku nuk kishte pasur probleme me asnjëri; ai ishte bërë polic vendor vetëm sa për të ushqyer familjen e tij.

Preni ka shtuar se, dy javë përpara kësaj nate, disa ushtarë të UÇK-së (ai kishte dëgjuar se Gjeloshi ishte njëri nga ata) kishin marrë axhën e tij Tunën dhe e kishin mbajtur dy ditë dhe kishin konfiskuar pistoletën e tij.

Gjatë intervistës dëshmitarit i janë treguar tetë fotografi të personave të ndryshëm dhe në mes tyre Preni kishte njohur vetëm Gjelosh Krasniqin.

Duke pasur parasysh mospërputhjet në mes të deklaratës së mëparshme dhe dëshmisë së dhënë përpara trupit gjykues, dëshmitari Pren Kashnjeti ishte ballafaquar si në vijim:

Kryetari i Trupit Gjykues: Pyetja e Prokurorit ishte se ai donte të dinte se si emri i Gjelosh Krasniqit hyri në deklaratën e juaj.

Pren Kashnjeti: Siç thashë edhe më parë unë isha duke ecur rrugës, dikush tha “tung.” Unë nuk e pashë kush ishte. Ata thanë “tung Gjelosh” dhe kjo ishte e tëra.

Prokurori Publik: Cila rrugë dhe kur?

Pren Kashnjeti: Në Gjakovë, pas çlirimit.

Prokurori Publik: Ju e patë Gjeloshin në rrugë?

Pren Kashnjeti: Unë isha duke ecur rrugës.

Prokurori Publik: A i thatë atijë tung?

Pren Kashnjeti: Unë nuk i thashë asgjë atijë. Ne nuk e njihnim njëri tjetrin.

Kryetari i Trupit Gjykues: Mendojë se ai e keqkuptoi. Mendojë se dikush tjetër e përshëndeti Gjeloshin, dhe nga kjo ai e kuptoi se personi ishte Gjeloshi.

Pren Kashnjeti: Ishte diskush tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykues: Dikush tjetër që e përshëndeti Gjeloshin?

Pren Kashnjeti: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Para këtij takimi të rastësishëm, ju nuk e keni njohur këtë person?

Pren Kashnjeti: Jo.

Prokurori Publik: Tani do ju pyes për ta qartësuar këtë deklaratë që ja keni dhënë policisë. Kjo është fjalia që është pas përshkrimit tuaj kur është marrë Tuna, dy javë para Pashkut. "Pas luftës unë kam dëgjuar që ishte Gjelosh Krasniqi nga fshati Nepole, komuna e Pejës " Çfarë keni dëgjuar? Se ishte Gjelosh Krasniqi? A mund ta shpjegoni?

Pren Kashnjeti: Po. E gjitha që kam dëgjuar ishte "Gjelosh Krasniqi" dhe se i takon UÇK-së dhe kjo është e tëra.

Prokurori Publik: A ishte në kohën kur patë se disa persona të tjerë e përshëndetën Gjeloshin në rrugë?

Pren Kashnjeti: Jo, unë nuk kam dëgjuar asgjë atëherë.

Prokurori Publik: Pra ju keni dëgjuar prej dikujt se dikush i quajtur Gjelosh Krasniqi ishte në UÇK?

Pren Kashnjeti: Po, ai ishte.

Prokurori Publik: Dhe ju e keni ndërlidhë atë informatë me natën kur Pashk Luli ishte parë në oborrin tuaj me ushtarët e UÇK-së ?

Pren Kashnjeti: Unë nuk kam lidhë asgjë.

Prokurori Publik: Të shoh se a mund ta sqarojmë pak më shumë. Në fund të deklaratës tuaj dhënë policisë vitin e kaluar, dhe tani unë po e citoj deklaratën e juaj, "natën që u muarr Pashk Luli nga ushtarët e UÇK-së e që ishin në oborrin tim unë kam dëgjuar se aty ishte edhe Gjelosh Krasniqi."

Pren Kashnjeti: Kjo nuk është e vërtetë. E di që se çka kam thënë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Këtu është deklarata e nënshkruar nga ju. Është në Shqip. Ju nuk mund ta mohoni se e keni thënë një gjë të tillë. Cila është memoria e juaj tani?

Pren Kashnjeti: Siç thashë, unë nuk e kam njohur Gjelosh Krasniqin atë natë. Me të 16-tin, ju keni thënë e kam njohur Gjelosh Krasniqin.

Kryetari i Trupit Gjykses: Prokurori, i cili e citoi deklaratën e juaj, tha se ju keni dëgjuar atë natë se aty kishte qenë gjithashtu Gjelosh Krasniqi, në oborrin e axhës tuaj. Në oborrin ku Pashk Luli u morr.

Haxhi Millaku: Fjalë të gabuara janë duke u përdorur këtu, ato janë "Kam dëgjuar se."

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne nuk po themi se ju keni parë. Në deklaratën e juaj është e shkruar se ju keni dëgjuar se edhe Gjelosh Gjelosh Krasniqi ishte i pranishëm atë natë.

Pren Kashnjeti: Kjo nuk më kujtohet.

Kryetari i Trupit Gjykses: Është e mundur që memoria e juaj të ishte më e mirë para një viti, kur ja dhatë këtë deklaratë policisë?

Pren Kashnjeti: Është e freskët tani siç ishte atëherë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Por ju nuk po i thonitë njejtat gjëra. Ky është problemi.

Pren Kashnjeti: Po e them të vërtetën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Tani po e thoni të vërtetën?

Pren Kashnjeti: E di që kam thënë. Çka është shkruar në letër, nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: E dini, sepse e keni nënshkruar. Nuk mund të thoni se nuk e dini.¹⁵

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra gjatë intervistës disa nga fotografitë ju janë treguar, a është e vërtetë?

Pren Kashnjeti: Po, ata mi treguan disa fotografi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pyetja tjetër është se këto fotografi, ato të cilat ju treguan nga ana e Prokurorit Publik, a janë të njejtat fotografi me ato të cilat ju janë treguar?

Pren Kashnjeti: Mendoj se jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra sipas jush ato nuk janë fotografi të njejtat. A jeni i sigurtë se këto nuk janë të njejtat fotografi?

Pren Kashnjeti: Nga ajo që po shoh mendoj se nuk janë të njejtat.

Prokurori Publik: Prej fotografive të cilat ju janë treguar vitin e kaluar a ju kujtohet që e keni zgjedhur njërin të cilin e keni njohur?

Pren Kashnjeti: Ndoshta këto dy (i tregon).

Prokurori Publik: Ju jeni duke parë faqen 126 dhe ju thoni ndoshta “këto dy.” Cilat dy ju jeni duke i theksuar? Një në këndin e epërm të majtë?

Pren Kashnjeti: Po.

Public Prosecutor: Dhe tjetren?

Pren Kashnjeti: Ky ose ky (i tregon).

¹⁵ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 17.03.2009, faqe 30 – 31.

Prokurori Publik: Ju lutem veni gishtin në të dytën. Ju po e theksoni fotograafinë në fund në të djathtë (tregon). Ju e theksuat këtë (e tregon) dhe këtë (e tregon) fotografi?

Pren Kashnjeti: Po.

Prokurori Publik: Si i njihni këta dy njerëz?

Pren Kashnjeti: Mendojë për këtë.

Prokurori Publik: Shpjegojeni ju lutem.

Prokurori Publik: Ju i njihni këto dy fotografi (i tregon) si dy fotografi që policia ju tregoi?

Public Prosecutor: Ashtu mendojë.

Prokurori Publik: Ti lëmë anash këto për një moment. Prej fotografive që policia ju tregoi vitin e kaluar, a keni njohur ndonjërin prej tyre?

Pren Kashnjeti: I kam njohur dy të cilat i tregova.

Prokurori Publik: A ju kujtohet që në deklaratën e juaj keni thënë si në vijim. Po citojë "Nga këto fotografi që mi treguat unë e njoh vetëm Gjelosh Krasniqin." A ju kujtohet të keni thënë këtë policisë në deklaratën e juaj?

Pren Kashnjeti: Nuk më kujtohet kjo. Nuk e dija se do të vija këtu.

Prokurori Publik: Ju duhet të flisni të vërtetën këtu. A i keni thënë të vërtetën policisë kur keni thënë se e njohët vetëm Gjelosh Krasniqin nga fotografitë?

Pren Kashnjeti: Ajo nuk mund të jetë e vërtetë.

...

Ferdinando Buatier: Ta përmbledhim, sepse ne duhet të kuptojmë. Ju na thatë se policia ju ka intervistuar dhe gjatë intervistës ata ju treguan disa fotografi duke kërkuar nga ju që tu thoni nëse e njihnit, në mesin e këtyre fotografive, ndonjë person që ka marrë pjesë në veprimet e 1999. Kjo është ajo që kuptova. A është e saktë?

Pren Kashnjeti: Po, e saktë, por unë nuk e njoha asnjërin.

Ferdinando Buatier: Ju i patë disa fotografi dhe asnjëri nga personat në to nuk u njohën nga ju si njëri nga ushtarët e Marsit 1999?

Pren Kashnjeti: E tregova njërin nga fotografitë.

Ferdinando Buatier: Pra ju e njohët atë person si personin që e takuat pas luftës?

Pren Kashnjeti: Po, tre muaj mbas.

Prokurori Publik: Tani ju po na thoni se nuk e keni njohur dikë në fotografi. Dhe a ishte fotografia e Gjelosh Krasniqit?

Kryetari i Trupit Gjykses: A është e mundur se ju treguat, kur ju treguan fotografitë, në atë të Gjeshosh Krasniqit? Që do të thotë në personin i cili u përshëndet nga dikush, dikur pas luftës? A është kjo e saktë apo jo?

Pren Kashnjeti: Derisa kaloja aty pari.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ky person i cili u përshëndet është i njeiti person të cilin e njohët në fotografi?

Pren Kashnjeti: Mund të jetë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo është kur ju u intervistuat bga policia?

Pren Kashnjeti: Ndoshta e kam shënuar se ky ka qenë personi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Personi i cili u përshëndet?

Pren Kashnjeti: Me kend po mendoni?

Kryetari i Trupit Gjykses: Të fillomë përsëri. Ju thatë se dikur mbas luftës, derisa po ecnit në Gjakovë, dikush e përshëndeti një person duke e emruar me "Gjeshosh Krasniqi." A është e saktë?

Pren Kashnjeti: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Tani po ju pyes, a është e mundur që në mesin e fotografive të cilat ju janë treguar nga policia ishte fotografia e këtijë personi i cili u përshëndet?

Pren Kashnjeti: Si thatë ju.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra përgjegjja është po?

Pren Kashnjeti: Është e mundur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Mendova, a ishte ky person në mesin e atyre fotografive të cilat ju u treguan juve? Personi i cili u përshëndet?

Pren Kashnjeti: Afërsisht unë e tregova atë fotografi, por nuk jam i sigurtë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju treguat në dy fotografi. Por kur u intervistuat nga policia, a treguat vetëm në një apo më shumë fotografi? Sepse këtu po shkruan se ju treguat vetëm në një fotografi.

Pren Kashnjeti: Nëse ju thoni ashtu, le të jetë ashtu.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po them kështu sepse ju keni thënë kështu. A po mendoni që po qëndroni mbrapa deklaratës së mëparshme në këtë pikë?

Pren Kashnjeti: Siç thash sot, unë tregova në dy fotografi, pra mund të jetë njëra apo tjetra.

Kryetari i Trupit Gjykses: Por kur ju u intervistuat nga policia ju treguat në njëren. Tani ju rifreskova memorien, a qëndroni mbrapa kësaj?

Pren Kashnjeti: Nëse e kam thënë kështu nuk do të mohoja çfarë kam thënë. Por sa mund që personi të shkojë nuk mendojë se ka të vërtetë në këtë.

...

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju mund të thoni që nuk ju kujtohet kjo, por jo se nuk e keni thënë këtë. Ju pyes edhe një pyetje. Kërkojë nga ju që të ktheheni mbrapa tani dhe të shikoni në publik dhe gjithashtu të pandehurin.

Dëshmitari kthehet ta shiqojë publikun dhe të pandehurin, dhe kthehet në vend.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në mesin e këtyre njerëzve, a është personi i cili u përshëndet në Gjakovë dikur mbas luftës?

Pren Kashnjeti: Në mesin e personave që sapo i pashë mendoj se nuk është personi për të cilën kemi folur më parë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Tani kërkojë nga ju ta shikoni të pandehurin emri i të cilit është Gjelosh Krasniqi.

Dëshmitari kthehet që ta shikon të pandehurin.

Kryetari i Trupit Gjykses: A është ky personi i njejtë me atë i cili u përshëndet në Gjakovë?

Pren Kashnjeti: Nuk jam i sigurtë 100 përqind.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ka mundësi që ky të jetë personi i njejtë apo jo?

Pren Kashnjeti: Nuk mund të them.

Kryetari i Trupit Gjykses: Cilat janë dallimet në mes të këtijë Gjelosh Krasniqit që është para nesh dhe personit i cili u përshëndet në Gjakovë? A ka edhe ndonjë dallim?

Pren Kashnjeti: Fytyra e tijë ishte më ndryshe. Fytyra e tijë ishte më e gjatë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ka ndonjë dallim tjetër apo jo?

Pren Kashnjeti: Ai ishte më i bardhë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po mendoni në ngjyrën e lëkurës?

Pren Kashnjeti: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Meqë fotografitë e Prokurorit janë pak më të mira se të miat...(tregon nga Prokurori)

Prokurori Publik i jep kopjet e tija të fotografive trupit gjykses.

Kryetari i Trupit Gjykses: A mendoni që ky person, po e tregoi fotografinë në faqen 126 në fund të faqes në të djathtë, kush është ky person sipas jush? Kend e paraqet ky person? A e shihni ndokend në këtë sallë gjykimi që i përngjanë pak kësaj fotografie?

Pren Kashnjeti: Jo, mendoj se jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: A nuk mendoni se kjo fotografi mund ta paraqes Gjelosh Krasniqin. Me ballafaqimin e kësaj fotografie dhe personit të pranishëm këtu, ju pyes se a mund të jetë i njejt person.

Pren Kashnjeti: Ndoshta në fotografi personi përngjanë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po ju pyes për këtë fotografi dhe atë person (tregon të Pandehurin)

Haxhi Millaku: Merre fotografinë, shikoje....

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju lutem merreni fotografinë.

Dëshmitari e merr fotografinë nga Kryetari i Trupit Gjykses.

Kryetari i Trupit Gjykses: Shikojeni të Pandehurin. Mos u frikësoni.

Pren Kashnjeti: Nuk kam frikë. Ka dallime të mëdha.

Kryetari i Trupit Gjykses: Cilat janë këto dallime të mëdha?

Pren Kashnjeti: Së pari modeli i flokëve është tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Por modeli i flokëve mund të ndërrohet gjatë viteve.

Pren Kashnjeti: Unë e ndërrojë timen gjithashtu.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dallimet tjera?

Pren Kashnjeti: Personi në fotografi, fytyra e tij është ma e rrumbullakët kurse personi që është i ulur mbrapa meje e ka fytyrën më të gjatë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Vetëm të ju informojë që kjo fotografi është fotografia e Gjelosh Krasniqit. Vetëm të ju bëjë me dije.

Dëshmitari i kthen fotografinë Kryetarit të Trupit Gjykses.

Kryetari i Trupit Gjykses: Tani, që jeni në dijeni që kjo fotografi është e Gjelosh Krasniqit. A mendoni se fotografia dhe i pandehuri janë të njejt apo jo?

Pren Kashnjeti: Mendoj që jo.¹⁶

1. f) Prenk Luli, në dëshminë e dhënë përpara trupit gjykses, ka deklaruar se, në natën e 24 marsit 1999, ai ishte në shtëpi duke shikuar TV me babain e tij Mark Lulin dhe

¹⁶ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 17.03.2009, faqe 34 – 40.)

të afërmit e tjerë, kur disa fëmijë që ishin jashtë erdhën dhe thanë se e kishin marrë axhën e tyre, duke menduar në Pashk Lulin. Pastaj ai doli në oborr ku takoi kushërinjtë e tij (djemtë e axhës), të cilët i thanë se e kishin marrë Pashk Luli. Ai nuk kishte parë asnjëri, ai hyri në shtëpi menjëherë, meqë ishte më i interesuar të shikojë TV-në lidhur me bombardimin.

Pastaj, Pashk Lulin e kishin kthyer në oborr, Prenku doli prapë dhe ai kishte parë Pashkun me tre apo katër ushtarë të UÇK-së, por ai nuk kishte njohur asnjëri, e as nuk kishte biseduar me asnjëri.

Në deklaratën e mëparshme dhënë Policisë së UNMIK-ut më 16.01.2008, Prenk Luli kishte deklaruar se:

më 24 mars 1999, rreth orës 20:00, gruaja e Pashk Lulit, Zoja, së bashku me gruan e Gjergjit, Terezën, erdhën te shtëpia e tij për t'u strehuar nga bombardimet. Prenku, së bashku me babain a tij, kishin shkuar te shtëpia e Nikolle Lulit. Rreth orës 20:30, djali i Nikollës, Prenku, erdhi në shtëpi dhe tregoi se Pashkun e kishin marrë. Atëherë, ai doli dhe pa një person të armatosur me uniformë të UÇK-së, por nuk e kishte njohur. Ai e kishte pyetur se kush ishte, por përgjigjja ishte se ai ishte nga Kosova dhe nuk ishte me rëndësi për të të dinte se kush ishte ky.

Rreth orës 23:30, ai kishte dëgjuar një anëtar të familjes duke thënë "Axha ynë është kthyer", prandaj ai doli jashtë dhe këtë herë ai kishte parë Gjelosh Krasniqin së bashku me tre partnerët e tij në oborr. Ai nuk kishte mundur të dëgjojë të gjitha, por kishte dëgjuar shumë mirë kur Gjelosh ka thënë: "Çohu dhe eja me ne". Pra, Pashku dorëzoi municionin të cilin ia kishte kërkuar Gjeloshi dhe ata shkuan në drejtim të vreshtës së Erenikut, por, para se të largohen nga oborri, ushtarët u thanë njerëzve që ishin aty të mos lëvizin para një ore.

Duke marrë parasysh mospërputhjet në mes të deklaratës së mëparshme dhe dëshmisë së dhënë përpara Trupit gjykues, dëshmitari Prenk Luli ishte balafaquar si në vijim:

Prokurori Publik: Ju pyes nëse ju kujtohet që keni dhënë deklaratë më 16 janar 2008? Ju kujtohet që keni dhënë deklaratë atë mbrëmje?

Prenk Luli: Po.

Prokurori Publik: Më lejoni t'ju pyes. Ajo deklaratë u është dhënë policëve, e saktë?

Prenk Luli: Po.

Prokurori Publik: Ju kujtohet që keni dhënë këtë pjesë të deklaratës?

Prenk Luli: Nuk kam thënë asgjë fare. As nuk kam parë.

Prokurori Publik: Parë çka?

Prenk Luli: Askënd të armatosur.

Prokurori Publik: Dëgjojeni pyetjen time. Ju kujtohet që në deklaratën tuaj policisë keni thënë, më 16 janar 2008, se pasi keni dëgjuar nga fëmijët se axha juaj është marrë nga dikush, keni thënë si në vijim: “Në të njëjtën kohë, kam dalur në oborrin e Nikollës dhe kam parë një person të armatosur që kishte të veshur uniformën e UÇK-së. Ai po ashtu kishte simbolet e UÇK-së por unë nuk e kam njohur.” Ju kujtohet se keni deklaruar kështu?

Prenk Luli: Nuk e kam thënë këtë dhe nuk më kujtohet që e kam thënë sepse nuk e kam parë asnjëri në oborr.

Prokurori Publik: Ju mohoni që keni thënë kështu?

Prenk Luli: Nuk e kam thënë këtë.

Prokurori Publik: Më tutje në deklaratën tuaj: “E kam pyetur: ‘kush je ti’ dhe ai më ka thënë: ‘unë jam nga Kosova, dhe nuk është e rëndësishme për ju të dini kush jam’” dhe pastaj ju keni thënë: “Pas bisedës që kam pasur me një person në uniformë, kam hyrë në shtëpi por ai ka vazhduar të qëndrojë jashtë në oborr duke bërë roje.” Mund t’i tregoni Trupit gjykues si u bë që ky informacion gjendet në deklaratën tuaj që ju e keni nënshkruar?

Prenk Luli: Nuk e di kush e ka shkruar këtë. Kam parë që kanë qenë tre apo katër persona kur e kanë kthyer axhën tim por ishte errësirë dhe nuk kam mundur të shoh asgjë tjetër.

Prokurori Publik: Nuk mund të shpjegoni si u bë që kjo gjendet në deklaratën tuaj.

Prenk Luli: Nuk e di.

Prokurori Publik: Edhe pse e keni nënshkruar?

Prenk Luli: E kam nënshkruar por nuk e di se çfarë ka pasur të shkruar. Si kam mundur ta dijë?

Prokurori Publik: Ky ishte një hetim i rëndësishëm, nuk jeni brengosur çfarë po nënshkruani?

Prenk Luli: Babai im ishte shumë i sëmurë. Kam pasur punë të tjera. Nuk kam parë së çfarë ka shkruar ky njeriu. Më është dashur të dërgoj babain te mjeku dhe nuk kam ditur së çfarë është shkruar.

Prokurori Publik: Ishte në shqip. Ju e keni nënshkruar.

Prenk Luli: Po, e kam nënshkruar.¹⁷

Prokurori Publik: Më lejoni t’ju pyes lidhur me deklaratën në vijim të dhënë në janar 2008, citoj: “Rreth orës 23.00 Gjelosh Krasniqi, së bashku me tre partnerë të tij, erdhi në oborr. Dëgjova nga një anëtar i familjes se axha ynë ishte kthyer. Kjo është arsyeja pse kam dalur jashtë prapë.” Ju kujtohet se keni deklaruar kështu në janar 2008?

Prenk Luli: Po.

¹⁷ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 17.03.2009, faqe 48 – 49.

Prokurori Publik: Keni dëgjuar të është thënë ndonjë fjalë?

Prenk Luli: Jo.

Prokurori publik: Diçka tjetër që keni thënë në deklaratë është: “Nuk kam mundur t’i dëgjoj të gjitha por i kam dëgjuar shumë mirë fjalët që Gjelosh Krasniqi po thoshte ‘ngrihu dhe eja me ne’.

Haxhi Millaku: Është krejt ndryshe në versionin në gjuhën shqipe. Në atë version thuhet: “Nuk kam dëgjuar mirë.”

Prokurori publik: “Nuk kam mundur t’i dëgjoj mirë të gjitha që po i thoshte Gjelosh Krasniqi.”

Haxhi Millaku: “Nuk kam mundur të dëgjojë mirë” në versionin në gjuhën shqipe. Fjalët “ngrihu dhe eja me ne që i ka thënë Gjelosh Krasniqi nuk i kam dëgjuar shumë mirë.”

Kryetari i trupit gjykues: Është e njëjtë. Mund t’ju përgjigjeni pyetjes tani.

Prokurori publik: E dëgjuat deklaratën; a pajtoheni e ju e keni dhënë këtë deklaratë?

Prenk Luli: Pajtohem por jo në mënyrën se si është thënë. Ai është prezantuar si Gjelosh Krasniqi por nuk e kam njohur. Nuk është e vërtetë se kam thënë se e njoh atë njëri.

Kryetari i trupit gjykues: Prokurori publik nuk e ka thënë këtë. Vetëm të jemi të qartë, si ka ndodhur? Para se t’i thoni fjalët, çfarë ka thënë ai? Pasi që po thoni se është prezantuar si Gjelosh Krasniqi, kur është prezantuar?

Prenk Luli: Pasi që e kanë kthyer atë.

Kryetari i trupit gjykues: Çfarë ka thënë?

Prenk Luli: Vetëm ka thënë: “Ejani me ne” dhe kjo është e tëra.

Kryetari i trupit gjykues: Si mund ta dini se ai është prezantuar si Gjelosh Krasniqi?

Prenk Luli: Si kam mundur ta di nëse ishte ai apo jo?

Kryetari i trupit gjykues: Në cilin moment gjatë asaj nate është prezantuar ai si Gjelosh Krasniqi? Si ka ndodhur?

Prenk Luli: Ai nuk ka thënë se ishte Gjelosh Krasniqi. Nuk e kam dëgjuar të ketë thënë këtë dhe nuk e ka thënë këtë.

Kryetari i trupit gjykues: Si keni mundur ta dini se ishte Gjelosh Krasniqi sepse në deklaratë keni thënë se Gjelosh Krasniqi së bashku me tre parterë të tij kanë ardhur në oborr?

Prenk Luli: I dëgjova fjalët: “Gjelosh Krasniqi e ka marrë atë.” Në atë moment, nuk e kam dëgjuar të ketë thënë këtë apo të prezantohet.

Kryetari i trupit gjykues: A i ka thënë dikush tjetër këto fjalë: “Gjelosh Krasniqi e ka marrë atë.” A ju kujtohet kush i ka thënë këto fjalë?

Prenk Luli: Jo.

Kryetari i trupit gjykues: A e keni dëgjuar dikë të thotë këtë apo a e keni parë dikë të thoshte këtë?

Prenk Luli: Dikush ka thënë por nuk e kam parë.

Kryetari i trupit gjykues: Pra vetëm e keni dëgjuar.

Prenk Luli: Vetëm e kam dëgjuar.¹⁸

1. g) Mihill Pergega, në dëshminë e tij dhënë përpara trupit gjykues, ka deklaruar se, natën e 24 marsit 1999, në shtëpinë e tij, ishin 13 – 14 anëtarë të familjes së tij. Rreth orës 11 apo 12, ai dëgjoi të lehurat e qenve dhe poashtu disa zëra dhe ai doli jashtë. Ai pa disa njerëz në uniforma dhe të armatosur, por nuk kishte mundur t'i njohë meqë ishte shumë errësirë. Njëri nga ata, pak i shkurtë dhe që dukej i trashë, u prezantua por nuk tregoi emrin e tij dhe kërkoi armët e Mihillit. Ai i tregoi një foto dhe e pyeti nëse e njohte dhe ai e njohu të ishte fotoja e Pashk Lulit. Pastaj, ai dorëzoi armët dhe personat e armatosur i thanë mos të mbyllë derën para se ata të largoheshin. Pastaj, ai kurrë më nuk i ka parë këta njerëz.

Në deklaratën e mëparshme dhënë Policisë së UNMIK-ut më 11.04.2008, Mihill Pergega ka deklaruar se:

më 24 mars 1999, Gjelosh Krasniqi së bashku me tre persona të tjerë që kishin të veshura uniforma të UÇK-së, kishin shkuar te shtëpia e tij, i kishin treguar letërnjoftimin e Policisë së Pashk Lulit dhe e kishin pyetur nëse e njohte personin në foto, të cilin ai e kishte identifikuar si Pashk Lulin, meqë Pashku ishte kumbara i tij. Mihilli e njohte Gjelosh Krasniqin, sepse ishin shokë dhe ai i tha t'ia doreë atij armën. Ai i tha se do të jepte armët vetëm që kjo të mos bëhet punë e madhe dhe i dorëzoi atij dy armë. Ai poashtu i tha Gjeloshit se ai kishte frikë se, një ditë, ata mund të ktheheshin për të dhe per djemtë e tij. Por, Gjeloshi u përgjigj se ata nuk do të bënin këtë, meqë ky ishte sjellur mirë. Ai poashtu i tha që të mos largohet nga fshati meqë ata nuk mund të garantonin për sigurinë e tij. Pas kësaj, derisa ishin duke u larguar, Gjeloshi i tha të presë 5 – 10 minuta dhe pastaj të mbyllë portën. Ai nuk i kishte parë më.

Duke pasur parasysh mospërputhjet në mes të deklaratës së mëparshme dhe dëshmisë së dhënë përpara Trupit gjykues, dëshmitari Mihill Pergega ishte ballafaquar si në vijim:

Prokurori publik: A ju kujtohet në intervistë të keni thënë se “Gjelosh Krasniqi së bashku me 3 persona tjerë kanë ardhur në shtëpinë time”.

¹⁸ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 17.03.2009, faqe 49 – 51.

Mihill Pergega: Nuk kam thënë 3 ose 4 ose 10, vetëm kam thënë disa nga ta e kanë përmendur këtë emër dhe unë nuk e di nëse ka qenë ai person ose jo. Nuk e di nëse qëllimi i tyre ishte që t'i ngatërrojnë gjërat.

Prokurori publik: Pyetja ime ishte, a i keni dhënë ose nuk i keni dhënë deklaratë policisë?

Mihill Pergega: Kam thënë se disa nga ta kanë përmendur këtë emër Gjelosh Krasniqi dhe unë se kam njohur dhe se kam parë atë. Ndoshta ka qenë qëllimi i tyre që të me implikojnë mua sepse disa njerëz i ndryshojnë emrat e tyre gjatë luftës.

Kryetari i trupit gjykues: Ju po flisni për ushtarët.

Mihill Pergega: Po njëri nga ushtarët e ka përmendur emrin, por gjatë luftës ata kanë ndryshuar emrat e tyre, nuk e di arsyen.

Prokurori publik: Ju lutem kthehuni dhe shikojeni të pandehurin.

Dëshmitari kthehet

Prokurori publik: A është ky Gjelosh Krasniqi që ju e njihni, ky para jush?

Mihill Pergega: Ju po me thoni se ky person është Gjelosh Krasniqi, kurrë se kam parë apo njohur atë.

Kryetari i trupit gjykues: Ai kurrë s'ka thënë se e ka njohur Gjelosh Krasniqin, prandaj pyetja duhet të riformulohet.

Prokurori publik: A e njihni personi të cilin sapo e shikuat në sallën e gjykatës?

Mihill Pergega: Vetëm tani që e pashë, tani që po me tregoni ju.

Prokurori publik: Unë vetëm ju pyeta se a e njihni?

Mihill Pergega: Jo.

Prokurori publik: Në deklaratën e dhënë në prill, a ju kujtohet të keni thënë si në vijim: "E kam njohur Gjelosh Krasniqin sepse ne ishim shokë, Gjelosh Krasniqi me ka thënë t'ia jepja armët" a ju kujtohet t'ia keni thënë këtë policisë në prill të vitit të kaluar?

Mihill Pergega: Jo, nuk e di se çfarë kanë shkruar ata në atë kohë.

Prokurori publik: Pra kjo kurrë nuk është thënë nga ju?

Mihill Pergega: Nuk e di se çfarë shoku mund të jem me dikën që kurrë se kam parë apo që kurrë s'kemi qëndruar bashkë, edhe nëse do të dëshiroja t'i njihja personat që kanë ardhur.

Prokurori publik: Në bazë të kërkesë që keni marrë ju ua keni dhënë armët.

Mihill Pergega: Kjo është ajo që thashë.

Prokurori publik: Pra kjo deklaratë është e saktë kur ceket se ushtarët kanë ardhur në shtëpinë tuaj me 24 mars 1999.

Mihill Pergega: Nuk e di datën, vetë e di se kanë ardhur.

Prokurori publik: Ju ua keni dhënë armët?

Mihill Pergega: Po sapo e thashë këtë.

Prokurori publik: Deklarata është e saktë kur thoni se ju e keni parë Pashk Lulin në fotografi?

Mihill Pergega: Po.

Prokurori publik: Por duket të jetë gabim emri i Gjelosh Krasniqit dhe që ai ua ka treguar juve fotografinë?

Mihill Pergega: Kur se kam njohur Gjelosh Krasniqin, nëse ky është personi që po thoni ju atëherë tani po e njoh, por nuk e kam njohur me herët dhe ky nuk është personi nga ajo natë.

Prokurori publik: Në deklaratën tuaj a keni thënë si në vijim "I thashë Gjelosh Krasniqit se po ua jap armët por kam frikë se mund të vini të me merrni mua dhe djemtë e mi një ditë" a e keni thënë këtë në atë deklaratë?

Mihill Pergega: Ajo që i kam thënë këtij personi që ka kërkuar armët është "sonte po i kërkonti armët ndoshta me vonë do të vini për mua", këtë ia kam thënë këtij personi që kurrë se kam njohur si Gjelosh Krasniqi.

Prokurori publik: Para se ta thoshit këtë ju e keni dëgjuar emrin e Gjelosh Krasniqit.

Mihill Pergega: Në bazë të këtij emri që kam dëgjuar kam menduar se ky person është Gjeloshi. Nuk e di se çfarë qëllimesh kishin, ndoshta për t'i ngatërruar gjërat.

Prokurori publik: Ajo që po përpiqem të kuptoj është sqarimi juaj në lidhje me dëgjimin e emrit të Gjelosh Krasniqit dhe ju e pranoni se keni dëgjuar këtë emër atë natë?

Mihill Pergega: Po, njëri nga ushtarët e ka përmendur këtë emër. Gjatë luftës ata kanë ndryshuar emrat e tyre.

Prokurori publik: Përgjigjuni qartë, a ia keni dhënë policisë emrin e Gjelosh Krasniqit si personi me të cilin keni folur dhe ia keni dhënë armët atë natë?

Mihill Pergega: Ju po e ngatërroni, çfarë kam thënë është çfarë ka ndodhur. E kam dëgjuar emrin e Gjeloshit dhe mendoj se qëllimi i tyre ishte që ta përmendin atë emër për t'ia vënë fajin dikujt tjetër.

Prokurori publik: Çfarë faji?

Mihill Pergega: Fajin që i kanë kërkuar armët, pse do t'i ndryshonin emrat?

Prokurori publik: A ju kujtohet të keni thënë këtë: "Nuk e kam parë Pashk Lulin por vetëm e kam parë letrën me fotografinë e tij dhe Gjelosh Krasniqi po e mbante atë"

Mihill Pergega: Nuk e di se çfarë kanë shkruara ata për Gjeloshin, unë thashë se vetëm e kam dëgjuar emrin e Gjeloshit, nuk mund të qëndrojë me gjatë në këmbë, jam i sëmurë.

Dëshmitarit i është ofruar një karrige që të ulet

Prokurori publik: A ju është dhënë mundësia që ta nënshkruani deklaratën tuaj apo jo?

Mihill Pergega: Askush s'ma ka lexuar, nuk e di se çfarë ka ndodhur.

Prokurori publik: Por ju është kërkuar që ta nënshkruani deklaratën tuaj, apo jo?

Mihill Pergega: Jo, vetëm kanë kërkuar nga unë që ta nënshkruaj dhe unë i kam pyetur nëse me duhet të shkoj diku për këtë, ata me kanë thënë se jo, nuk do ta nënshkruaja po të me kishin treguar se duhet të vija në gjykatë.

Prokurori publik: Pse mos ta nënshkruanit nëse do të vinit në gjykatë?

Mihill Pergega: Pse t'i shkaktojë telashe vetës pas 11 vjetëve, jam 74 vjeçar dhe i sëmurë.

Riza Berisha: A është e vërtetë deklarata që ia keni dhënë policisë apo deklarata që e keni dhënë sot?

Mihill Pergega: Çfarë kam thënë sot është e vërtetë, nuk e di se çfarë kanë shkruar në atë kohë.

Kryetari i trupit gjykues: Disa sqarime, dua të di se si është e mundur që këtu para gjykatës ju thatë se kurrë nuk e keni njohur Gjelosh Krasniqin. Pse në deklaratën që i keni dhënë policisë keni thënë se "E kam njohur Gjelosh Krasniqin sepse ishim shokë", si mund ta sqaroni këtë kontradiktë?

Mihill Pergega: Nuk është e vërtetë; nuk e di se si ka ndodhur që ata e kanë shkruar këtë.

Kryetari i trupit gjykues: Pra po thoni se dikush e ka ndryshuar plotësisht versionin që ia keni dhënë policisë?

Mihill Pergega: Ajo që thashë sot janë fjalët që ia kam thënë policisë. Nuk e di se çfarë kanë shkruar.

Kryetari i trupit gjykues: A jeni të sigurt që deklarata që keni dhënë në polici nuk ju është lexuar?

Mihill Pergega: Nuk kam dëgjuar që ma kanë lexuar.

Kryetari i trupit gjykues: Pra ju vetëm e keni nënshkruar?

Mihill Pergega: Po e kam nënshkruar, ju kam thënë se nuk mundem, nuk di si dhe vetëm e kam vendosur gishtin tim në të.

Kryetari i trupit gjykues: Pra po thoni se nuk e keni nënshkruar por vetëm keni vënë gisht në të.

Mihill Pergega: Jo, e kam nënshkruar me së miri që kam mundur.

Kryetari i trupit gjykues: A e keni nënshkruar çdo faqe?

Mihill Pergega: Nuk mund t'ju tregoj, ka qenë një kohë e gjatë, qe 10 vite.

Fernando Buatier: Kur e keni parë për herë të parë të pandehurin e tanishëm?

Mihill Pergega: Nëse ky është sot.

Fernando Buatier: Kur filluat me deklaratën tëndë sot ju thatë se Gjeloš Krasniqi është kushëri, cila është shkalla e afërsisë me të pandehurin apo familjen e tij?

Mihill Pergega: Thashë se jemi 18 shtëpi në fqinjësi, njëri nga vëllezërit e Gjeloš Krasniqit është në lidhje miqësie me njërin nga vëllezërit e mi. Nuk e di se me kënd unë jam në miqësi e lëre më vëllezërit e mi, ne jemi martuar me shumë gra dhe motra të tyre po edhe ata me tonat prandaj nuk i njoh kunetërit e mi.

Fernando Buatier: A jetoni në të njëjtin fshat apo në të ndryshëm?

Mihill Pergega: Nuk e di fshatin e tij apo emrin, nuk e di ku ai banon. Kurrë nuk kam qenë në fshatin e tij.

Kryetari i trupit gjykues: A jeni i sigurt që kjo është hera e parë që po shihni të pandehurin?

Mihill Pergega: Jam i sigurt, nëse ky është personi që po thoni, atëherë tani është hera e parë që po e shoh në gjykatë.¹⁹

1. h) Gjergj Quni, në dëshminë e tij dhënë përpara Trupit gjykues, ka deklaruar se, natën e 24 marsit 1999 rreth orës 10:00, ai ishte në shtëpi me vëllain e tij të ndjerë kur disa ushtarë erdhën dhe e thirrën. Kur ai doli, ata i thanë të dorëzojë armët. Ai kishte lejen për armët por ai kishte vendosur t'i dorëzojë për shkak të frikës se nëse nuk do t'i dorëzonte armët ai do të ishte në telashe. Ushtarët që erdhën ishin shqiptarë dhe kishin simbolet me shqiponjë, por ai nuk kishte njohur asnjërin prej tyre.

Në deklaratën e dhënë Policisë së UNMIK-ut më 11.04.2008, Gjergj Quni ka deklaruar se:

më 24.03.1999, rreth orës 21:15, tre persona në uniforma të UÇK-së shkuan në shtëpinë e tij, derisa 14 ose 15 të tjerë ishin duke pritur pak më larg. Ata thirrën emrin e tij: "Hej Gjergj"; ai doli jashtë dhe ata i thanë se ata donin të hyjnë në shtëpinë e tij dhe të marrin armët e tij. Gjergji u përgjigj se ai do të sillte armet vetë dhe se nuk ka nevojë që ata të hyjnë në shtëpinë e tij. Ai i dha një armë një ushtari me uniformë të UÇK-së, me simbol të UÇK-së dhe kapelë të zezë ndërsa arma tjetër, pistoletë, i ishte dhënë Gjeloš Krasniqit. Pas kësaj, ata i thanë të qëndrojnë në shtëpi dhe u larguan dhe ai nuk ka ditur asgjë më shumë lidhur me ta.

¹⁹ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 18.03.2009, faqe 6 – 10.

Duke pasur parasysh mospërputhjet në mes të deklaratës së mëparshme dhe dëshmisë së dhënë përpara Trupit gjykues, dëshmitari Gjergj Quni ishte ballafaquar si në vijim:

Prokurori publik: A ju kanë thirrë me emër?

Gjergj Quni: Nuk e kam dëgjuar emrin tim, vetëm i kam dëgjuar duke thirrur.

Prokurori publik: Në deklaratë thuhet se ata kanë thirrur 'Hej Gjergj.'

Gjergj Quni: Ndoshta kanë pyetur se e kujt është shtëpia.

Prokurori publik: A është e saktë: 'U kam dhënë pushkën M45'.

Gjergj Quni: Kanë thirrur por nuk e kanë përdorur emrin tim.

Prokurori publik: Në rregull, ka mospërputhje.

'M48 ia kam dhënë një ushtari që kishte uniformën e UÇK-së dhe kapele të zezë me shënjen e UÇK-së.' A ju kujtohet të ja keni thënë këtë policisë?

Gjergj Quni: Ishte para një kohe.

Prokurori publik: A është e saktë kjo deklaratë?

Gjergj Quni: Më kujtohen disa nga fjalët dhe disa nga to nuk me kujtohen.

Prokurori publik: Cilat ju kujtohen?

Gjergj Quni: Më kujtohet se me kanë pyetur, por nuk kam njohur diçka tjetër. Ua kam dhënë armët por kurrë nuk me kanë dhënë certifikatë.

Prokurori publik: 'Ia kam dhënë Gjelosh Krasniqit revolen CZ 99, 9mm, me numër 45811' a ju kujtohet të keni thënë këtë?

Gjergj Quni: Me kujtohet të kem thënë se armët ia kam dhënë një personi të panjohur, por nuk me kujtohet te kem thënë nëse ishte ai apo jo.

Prokurori publik: A e njihni personin me emrin Gjelosh Krasniqi?

Gjergj Quni: Nuk e njoh. E kanë përmendur këtu me 19 janar. Nuk e kam njohur atëherë dhe nuk e njoh as tash. Edhe unë i kam pasur 2 djem të vëllezërve në UÇK por nuk i kam parë deri në fillim të korrikut.

Prokurori publik: Ku në deklaratë policia e ka përmendur emrin e Gjelosh Krasniqi?

Gjergj Quni: Nuk e di çfarë ka bërë policia. Ai person është i panjohur për mua. Atë emër e kam dëgjuar me 19 janar. E kam dëgjuar prokurorin publik duke përmendur atë emër dhe kurrë se kam dëgjuar emrin e tij dhe kurrë s'kam folur me të, por është përmendur se ai jetonte në Napolje të Pejës. Kurrë s'kam qenë në Napolje. Është përmendur me 19 janar.

Prokurori publik: Ju e keni dëgjuar emrin e Gjeloš Krasniqit me 19 janar 2009?

Gjergj Quni: Nga kush?

Prokurori publik: Nga dikush në tërë botën.

Gjergj Quni: Nuk e di.

Riza Berisha: A e keni përmendur Gjeloš Krasniqin në deklaratën që ia keni dhënë policisë?

Gjergj Quni: Jo, nuk i kam njohur atëherë dhe nuk i njoh as tash.

Riza Berisha: Pra, policia e ka shkruar emrin e Gjeloš Krasniqit në deklaratë?

Gjergj Quni: Ato nuk ishin fjalët e mija.

Kryetari i trupit gjykues: Pra përgjigja juaj është 'jo nuk e kam përmendur?'

Gjergj Quni: Kur me kanë pyetur: 'kujt ja ke dhënë, kam thënë se di. Kur me kanë pyetur 'nëse e kam njohur Gjeloš Krasniqin', kam thënë jo. 'Kujt ja ke dhënë', nuk e di.'²⁰

1. i) Hazbi Axhami, në dëshminë e tij dhënë përpara Trupit gjykues, ka deklaruar se ai kishte punuar si polic shtatë vjet. Më 25 shtator 2007 ai kishte filluar të punojë në rastin e zhdukjes së Pashk Lulit së bashku me Kelley Reeves, polic amerikan, dhe Zyhra Zeqiri, police kosovare. Hetimet filluan në bazë të kërkesës së ZPZHML e cila kishte pranuar një kërkesë nga anëtarët e familjes për të gërmuar të mbeturat e Pashk Lulit në një vend ku ata dyshonin se ai ishte varrosur. Edhe pse, kur ata mbërrinë aty, Gjergj Luli, djali i Pashk Lulit, tashmë kishte provuar ta zhvarros, por nuk kishte mundur t'i gjejë të mbeturat. Kjo kishte ndodhur para 25 shtatorit 2007.

Pas kësaj here, ata filluan të mbledhin informacione dhe morën disa deklarata nga dëshmitarët, por vetëm si shënime hetuese, jo deklarata të nënshkuara, deri më 16 janar 2008 kur shkuan në shtëpinë e Pashk Lulit dhe morrën dy deklarata nga Gjergj Luli dhe Prenk Luli. Deklaratat ishin marrë në përputhje me udhëzimet dhe procedurat siç është paraparë me rregullat e udhëzimeve të policisë dhe kur ka pasur nevojë për përkthyes ai do të ishte i pranishëm dhe do të nënshkruante deklaratën poashtu.

Nëse dëshmitari nuk ka ditur të shkruajë, atëherë ata kanë prezantuar deklaratën me shkrim, ia kanë lexuar dëshmitarit dhe eventualisht është kërkuar nga dëshmitari të nënshkruajë të gjitha faqet e deklaratës. Pra, kjo procedurë ishte ndërmarrë me të gjithë dëshmitarët kur janë marrë në pyetje dhe nuk ka pasur asnjë dëshmitar që nuk ka ditur shkrim-lexim, të gjithë kanë lexuar deklaratat e tyre vetë dhe i kanë nënshkruar, përpos Zoje Lulit, e cila nuk mundur të lexojë, prandaj, asaj është dashur t'ia lexojnë. Polici ka deklaruar se kishte marrë disa deklarata nga Gjergj Luli gjatë hetimeve dhe, para dhënies së deklaratës së fundit; Gjergj Luli e kishte thirrur në telefon dhe e kishte

²⁰ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 18.03.2009, faqe 15 – 17.

informuar se Gjeloš Krasniqi ishte liruar. Pastaj, më 07.10.2008, Gjergji shkoi në Prishtinë dhe, në deklaratën e fundit dhënë policisë, tërhoqi të gjitha akuzat ndaj Gjeloš Krasniqit.

Gjatë tërë hetimeve, ai pranoi disa telefonata nga Gjergj Luli duke e informuar për vendndodhjet dhe lëvizjet e Gjelošit. Lidhur me këto telefonata, ai ka mbajtur shënime dhe i ka bashkangjitur ato si informacione shtesë në raportet e tij. Më 29 janar 2008 policia ishin në ndjekje të një veture Mercedes ML, e cila dyshohej se ishte pronë e Gjeloš Krasniqit. Ata e kanë përcjellur veturën derisa u ndal në Restorantin Aviano dhe, ditën e njëjtë, Gjergj Luli i informoi ata se vetura e njëjtë ishte parkuar në Restorantin Aviano dhe Gjeloš Krasniqi ishte brenda restorantit. Gjergji poashtu dha regjistrimin e veturës (NEW YORK DXW – 5270) e cila përputhej me regjistrimin e veturës të cilin ata e ndiqnin.

Më 25 mars 2008, në mëngjes, Gjergj Luli kontaktoi dëshmitarin prapë dhe i dha informacionin se Gjeloš Krasniqi tani kishte veturë tjetër, një BMW me regjistrim të Shqipërisë; pasdite Gjergji e thirri prapë dhe e këshilloi se tani të dy veturat (Mercedesi dhe BMW) ishin parkuar te restoranti Metropol.

Më 27 maj 2008 Gjeloši ishte arrestuar në Pejë në një kafiteri, afër veturës së tij Mercedes ML, veturës së njëjtë të cilën ata e ndiqnin.

Lidhur me regjistrimin e Mercedesit ML, është e rëndësishme të paraqitet ekstrakti nga dëshmia e dëshmitarit:

Prokurori Publik: A jeni takuar me të pandehurin Gjeloš Krasniqi në burgun e Dubraves?

Hazbr Axhami: Po.

Prokurori Publik: A ishte me 18 qershor?

Hazbr Axhami: Po.

Prokurori Publik: A ishte e pranishme me juve edhe Kelly Reeves?

Hazbr Axhami: Po.

Prokurori Publik: Gjatë asaj kohe a ishte i pranishëm edhe avokati mbrojtës i Gjeloš Krasniqit?

Hazbr Axhami: Po.

Prokurori Publik: Po e marrë se të gjitha formalitetet lidhur me marrjen e deklaratës nga i akuzuari janë vene re atë ditë?

Hazbr Axhami: Po.

Prokurori Publik: Por ai zgjodhi që të mos deklarohej, e saktë?

Haxhi Millaku: Ju lutem hiresi, ai vetëm shfrytëzoi të drejtën e tij për të heshtur por ai nuk tha se nuk do që të japi deklaratë.

Kryetari i Trupit Gjykoës: Kjo ka të njëjten domethenjë.

Prokurori Publik: Pati diskutime lidhur me veturen e Mercedesit dhe dokumentat e vetures tjeter, kjo ishte, nje diskutim ne mes te gjithe atyre qe ishit te pranishem, avokatit mbrojtes dhe policise?

Hazbr Axhami: Po.

Prokurori Publik: Duhej te diskutohej lidhur me dokumentet e pronesis dhe pronesisn e ketyre vetyrave, a eshte e sakte?

Hazbr Axhami: Po.

Prokurori Publik: Kerkoj gjykaten te mbaj shenim nga dokumenti te dates 18 qershor 2008 i marre ne burgun e Dubraves dhe te bashkangjitur ka nje certifikate te dokumentit te shtetit te New Yorkut. A mund te ja paraqes kete dokument dëshmitarit?

Kryetari i Trupit Gjykues: Po, ju lejohet.

Prokurori publik i tregon dehsmitarit dokumentin dhe e pyet nese e njeh atë.

Hazbr Axhami: Ky eshte autorizimi i dhene nga Gjelosh Krasniqi avokatit te tij mbrojtes ne menyre qe ai te rregulloj dokumentat e vetures.

Kryetari i Trupit Gjykues: Kopja jone nuk permabn nënshkrimin e Gjelosh Krasniqit. Une nuk di per kopjen qe ju po e shiqoni tani. Ky duhet te jete origjinali. A eshte nënshkruar nga i pandehuri?

Hazbr Axhami: Po dhe po ashtu nga avokati mbrojtes.²¹

Lidhur me faktin nëse Gjergj Luli e ka parë të pandehurin drejtpersëdrejti, është e rëndësishme të paraqitet ekstrakti i dëshmisë së dëshmitarit:

Ferdinando Buatier De Mongeot: Qe ta përmbledhim kete. Ju keni pranuar gjithsej tri thirrje apo ishin kater?

Hazbr Axhami: Ishin me shume se tri.

Ferdinando Buatier De Mongeot: A mund te jeni me i sakte ne numer?

Hazbr Axhami: Kater nga to i kam te shënuara.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Ne cilen thirrje nga to Gjergj Luli te tregoj se ai vetë personalisht kishte parë Gjelosh Krasniqin ? Nese mund ti vesh ne pah.

Hazbr Axhami: 25 mars 2008.

²¹ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 19.03.2009, faqe 20-22.

Kryetari i Trupit Gjykses: Çfarë ndodhi atë ditë?

Hazbr Axhami: Ate dite ai me njoftoj se ai kishte parë Gjelosh Krasniqin me nje BMW X5. Mu atë dite ai me njoftoj ne ora 14: 35 min dhe me tha se e kishte parë vetë personalisht.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Ai te thirri dy herë?

Hazbr Axhami: Po.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Ne te dyja rastet ai kishte pare Gjelosh Krasniqin?

Hazbr Axhami: Po.

Ferdinando Buatier De Mongeot: A pate thirje te tjera telefonike kure tha se ai vetë personalisht kishte parë Gjelosh Krasniqin?

Hazbr Axhami: Nuk ka pase thirje te tjera telefonike kure ai te kete thene se e ka pare personalisht dhe herave te tjera ai me ka thene se dikush tjeter e kishte parë atë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju doni te thoni se me 20 shkurt 2008 dhe me 3 mars 2008 kur ju ka thirrur dhe kure ju tregonte dicka mbi lëvizjet e Gjelosh Krasniqit, ai vetë nuk kishte pare drejteperdrejte Gjelosh Krasniqin?

Hazbr Axhami: Une mendoj se keto shenime gjenden ne raportin qe ju kam dhene dhe informatta shtese te përmbledhura ne raport.

Kryetari i Trupit Gjykses: ne neve na interesojne me shume informatat shtese se sa ato te për gjithshmet.

Hazbr Axhami: E kuptoj por te gjitha info0rmatat shtese jane ne raportin permbledhes. Te gjitha jane te bashkangjitura dhe jane ne formen e tyre origjinale. Me 20 shkurt gjate bisedes ai me tha se nje shoku i tij e kishte parë ate dhe jo ai vetë personalisht e cila gje po ashtu eshte e cekur ne raport.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po me 3 marsi?

Hazbr Axhami: Shoku i tij.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ti kthehemi informates shtese te 20 shkurtit 2008, kur more kete thirje telefonike, a mos foli Gjergj Luli per ndonje kercenim?

Hazbr Axhami: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Te lutem na sqaro çfarë kercenimi dhe kush po kercenonte?

Hazbr Axhami: Gjate bisedes Gjergj Luli tha se nje shok i tij po pinte alkool me Gjergj Krasniqin dhe se Gjelosh Krasniqi i kishte thene shokut te tij se femijet e Pashk Lulit po rriteshin, keshtu qe kujdes.

Kryetari i Trupit Gjykses: Keni diçka per te shtuar?

Hazbr Axhami: Sipas këtij shoku, mbase, Gjelosh Krasniqi tha: "Do te ja bëjë te birit te Pashk Lulit me keq seç ja bera te atit te tij". Une kërkova te intervistohej ky person, shokun e Gjergj Lulit por ai nuk pranoi dhe unë nuk di se kush eshte ai.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur shkruani ketu se Gjergj Luli eshte i frikësuar, a ishte ai i frikësuar nga ngo ky kercenim apo nga kercenimet e tjera?

Hazbr Axhami: Sipas tij vetë per shkak te ketyre fjaleve.

Kryetari i Trupit Gjykses: Te cilat ishin degjuar nga shoku i tij?

*Hazbr Axhami: Po.*²²

1. j) Miradije Fejzullahu, në dëshminë e saj dhënë përpara Trupit gjykses, ka deklaruar se ajo ishte duke punuar si police që nga viti 1999. Lidhur me këtë çështje ajo kishte asistuar Hazbi Axhamin në marrjen e deklaratave nga dy persona të moshuar, Gjergj Qunit dhe Mihill Pergegës. Gjergj Quni ishte i pari që është marrë në pyetje, meqë hetuesit ishin në shtëpinë e tij: pastaj Mihill Pergega erdhi dhe e morrën edhe atë në pyetje. Të dy dëshmitarët ishin pyetur nëse dijnë shkrim-lexim, por përgjigjja e tyre ishte se dinin shkrim-lexim, por, për shkak te moshës nuk mund të shkruajnë mirë. Pas përfundimit të intervistave dëshmitarëve u është lexuar deklarata e tyre dhe ata e kanë nënshkruar.

1. k) Ismet Jemini, në dëshminë e tij dhënë përpara Trupit gjykses, ka deklaruar se ai ishte angazhuar në hetime në vitin 2005. Në atë kohë ai ka kontaktuar anëtarët e familjes së të zhdukurit Pashk Luli dhe tre dëshmitarë të tjerë, përkatësisht Gjergj Qunin, Mihill Pergegën dhe Tune Kashnjetin. Gjatë bisedës me këta dëshmitarë, ata kanë përmendur emrin e Gjelosh Krasniqit dhe përshkrimi fizik i tij është dhënë nga ana e Gjergj Lulit, duke e përshkruar si një person zeshkan, i thatë, 1 metër e 75 cm, flokë të zeza. Sipas Ismet Jeminit, Gjergj Luli ka deklaruar se Gjelosh Krasniqi pas luftës jetonte në Amerikë dhe se Gjeloshi vinte nga fshati Nepole, Komuna e Pejës.

Të gjithë dëshmitarët i kanë thënë atij se ata e njihnin Gjelosh Krasniqin, Mihill Pergega madje i kishte thënë se ata ishin kushërinjë të afërt.

Disa pjesë të dëshmisë dhënë nga polici janë të rëndësishme dhe ato janë paraqitur më poshtë:

Prokurori Publik: Ju pyeta nese Gjergj Luli ishte ne gjendje te bente përshkrimin fizike te Gjelosh Krasniqit. Ju mund t'i përgjigjeni kësaj pyetje.

Ismet Jemini: Ai e pershkruajti si person te zeshket thatanik, ai eshte i dobet, 1 meter dhe 75 cm, flokë te zeza, floke te ngjyrosura ngjyre kafe, pas lufte po jetonte ne Amerike.

²² Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 19.03.2009, faqe 27- 28.

Prokurori Publik: Edhe nje pyetje lidhur me informaten qe te dha Gjergj Luli. A mundi te përshkruaj fshatin apo se nga vinte Gjelosh Krasniqi?

Ismet Jemini: Po

Prokurori Publik: Cili ishte?

*Ismet Jemini: Fshati Nepole, Komuna e Pejes.
Prokurori Publik:*

Ismet Jemini: Po.

Prokurori Publik: Eshte kjo informata qe te siguroj Gjergj Luli dhe e cila gjendet ne raportin tuaj te pergaditur ne vitin 2005.

Ismet Jemini: Po.²³

Kryetari i Trupit Gjykses: A qendroni prapa raportit te përpiluar nga ju dhe i përfunduar me 29 nentor 2005?

Ismet Jemini: Une qendroj prapa raportit te përpiluar ne vitin 2005.

Kryetari i Trupit Gjykses: A keni ketu ndonje sqarim apo permirsime para kësaj gjykate? Ne lidhje me ate qe keni shkruar para me shume se tre vitesh. Pas kësaj hetimet vazhduan. A ka dicka qe ju do donit te ndryshonit?

Ismet Jemini: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju qendroni prapa tij kryekëput?

Ismet Jemini: Po.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Nuk mbaj mend cilet jane dy personat qe ju intervistuat: me kujtohet se ju i thate tre emra.

Ismet Jemini: Gjergj Luli, Tune Kushnjeti, Mihill Pergega dhe Gjergj Quni.

Kryetari i Trupit Gjykses: Atehere kater persona.

Ferdinando Buatier De Mongeot: A te kujtohet nese ata te thane se e njihnin Gjelosh Krasniqin?

Ismet Jemini: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Te gjite apo disa nga ta?

²³ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 19.03.2009, faqe 36.

Ismet Jemini: Qe te gjithë.

Kryetari i Trupit Gjykses: I njihnin si, sipas fytyres, sipas emrit?

Ismet Jemini: Mihill Pergega me tha se kishin miqasi, se familjet tona ose kishin marre nuse nga familjet e tyre apo kishin dhene tek ta.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kete e tha Mihil Pergega?

Ismet Jemini: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po ata tre te tjeret qe ti intervistove?

Ismet Jemini: Te tjeret me thane e kemi pare shume para luftes ne fshatin tone. Sepse fshati, fshati tyre Nepole, ka shume farefisni, ka shume martesat mes tyre.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne mes Doblodares dhe Nepoles.

Ismet Jemini: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po ne naten kritike, a e kane pare qe te gjithë deshmitaret drejteprese drejti naten e 24 marsit 1999 Gjelosht Krasniqin.

Ismet Jemini: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur keta njerëz e pane Gjelosht Krasniqin, ate nate, a ishte ai vetem apo se bashku me njerëz te tjere?

Ismet Jemini: Me kater persona te tjere.

Kryetari i Trupit Gjykses: Keta persona kishin te veshura uniforma apo jo?

Ismet Jemini: Po, kishin te veshura uniforma te UÇK-se.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo u tha nga te gjithë keta informatore?

Ismet Jemini: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: A te kujtohet nese ndonjëri nga keta informator te tha se e kishin takuar ate pas luftes, Gjelosht Krasniqin?

Ismet Jemini: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: A mund te na thuash se cili nga ta?

Ismet Jemini: Gjergj Luli.

Kryetari i Trupit Gjykses: A mund te na thuash se ne qfare rrethane ai e takoj Gjelosht Krasniqin?

Ismet Jemini: Njehere e takoj ne fshatin Doblibare dhe heren e dyte ne Gjakove.

Kryetari i Trupit Gjykses: A te kujtohet se qfare ndodhi ne keto dy raste?

*Ismet Jemini: Jo.*²⁴

1. l) Gegë Lleshi, në dëshminë e tij dhënë përpara Trupit gjykses, ka deklaruar se ai dhe pesë vellezërit e tij, dmth Prendi, Nika, Mema, Tomi and Deda, ishin të përfshirë në luftë, në njësinë e furnizimeve të UÇK-së në Zonën e Dukagjinit dhe ai ishte udhëheqësi i kësaj njësie. Ai ishte plagosur gjatë luftës dhe ishte në rrezik nga paraliza dhe shkoi në Shqipëri për t'u shëruar, pra, udhëheqja e njësisë kishte rënë mbi vellezërit e tij Prendin dhe Memen. Shpejte pas kësaj, në një pritë të trupave serbe, Prendi dhe Mema ishin qëlluar dhe vrarë më 28 janar 1999.

Pastaj ai është kthyer në Kosovë, tre muaj pas përfundimit të luftës dhe ai kishte takuar Gjelosh Krasniqin në Gjakovë të veshur me uniformë të UÇK-së, dhe e pyeti nëse dinte diçka lidhur me të mbeturat e dy vëllezërve të tij, meqë ai ishte në Kosovë kur kishte ndodhur prita.

Ai ka deklaruar se, gjatë kohës sa kishte qenë në Shqipëri, fshati Nepole kishte qenë brenda Zonës së Dukagjinit, por ai nuk e dinte se si ishin formuar brigadat dhe cili kishte qenë zingjiri komandues, sepse ai ishte kthyer në Kosovë vetëm pas përfundimit të luftës. Ai ka deklaruar se ai kurrë nuk kishte dëgjuar se dikush në mars 1999 ishte prezantuar në emër të Gjelosh Krasniqit, por në fakt nuk ishte ai.

1. m) Kolë Krasniqi, në dëshminë e dhënë përpara Trupit gjykses, ka deklaruar se gjatë 1998 – 1999, në fshatin Nepole, ata kishin organizuar mbrojtjen e fshatit, pra më 16 qershor 1998 ai u bë ushtar i UÇK-së dhe ai ishte personi përgjegjës për fshatin. Njerëz të tjerë u bënë pjesëtarë të UÇK-së poashtu; në mes tyre ishte Gjelosh Krasniqi. Në këtë periudhë kur ata iu bashkuan UÇK-së kishte pak persona në uniformë dhe për Gjelosh Krasniqin ata nuk kishin mundur të gjejnë uniformë pasi ai ishte shumë i gjatë. Gjatë kësaj kohe Gjelosh Krasniqi punonte në kuzhinë dhe i furnizonte ushtarët me ushqim, meqë ishte i ri dhe ata zakonisht i futnin pjesëtarët e rinj të punojnë në kuzhinë. Natën e 24 marsit 1999 rreth 6 apo 7 prej tyre u mblodhën të festojnë për shkak të bombardimit dhe ai i tha Gjeloshit të shkojë dhe të marrë viçin dhe ta përgatisë për darkë, dhe ata festuan tërë natën. Në mëngjesin e 25 marsit 1999 ai u zgjua dhe pa se Gjelosh Krasniqi kishte dalë nga shtëpia dhe nuk e kishte parë më: pas kësaj vetëm kishte dëgjuar se Gjeloshi ishte plagosur në betejë.

Gjelosh Krasniqi kishte për detyrë t'i kryente punët e kuzhinës deri në përfundim të luftës, ai kishte të drejtë të mbante armë por jo në kuzhinë.

Gjeloshi ishte i caktuar në fshatin Nepole gjatë tërë luftës; ata kishin një njësi, brigada 32, pra ai nuk e kishte parë më.

Dëshmitarit, të paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit, i ishin shtruar pyetje të tërthorta nga Prokurori dhe pastaj pyetje nga Trupi gjykses në mënyrë që të vërtetohet

²⁴ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 19.03.2009, faqe 40-42.

besueshmëria e verzionit të tij. Më poshtë, janë disa abstrakte nga procesverbali i datës 31.3.2009.

Kryetari i Trupit Gjykses: : Prokurori Publik dëshiron të di se si është e mundur që ju nuk dini asgjë lidhur me çfarë ka bërë Gjelosh Krasniqi pas 25 Marsit 1999, pasi që ju keni qenë përgjegjës për fshatin Nepole. A është larguar Gjelosh Krasniqi nga fshati dhe iu është bashkangjitur brigadës 35?

Kolë Krasniqi: Kur është bërë ofenziva dhe ai është plagosur, ne kemi qenë në male dhe ai është marrë nga njerëzit që e kanë pasur atë detyrë që ta dërgojnë në trajtim.

Kryetari i Trupit Gjykses: Para kësaj ofenzive çfarë ka ndodhur dhe në Prill 1999 dhe pas 25 Marsit, a e di çfarë ka bërë Gjelosh Krasniqi?

Kolë Krasniqi: Ai ka qenë aty me datën 24 sepse është ditë që e mbajnë në mend të gjithë Shqiptarët. Deri në mëngjes të (ndërpritet)

Kryetari i Trupit Gjykses: Deri më 25 Mars?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dëshirojmë të dimë çfarë ka ndodhur me Gjelosh Krasniqin pas 25 Marsit, a është larguar nga fshati? A është larguar nga fshati?

Kolë Krasniqi: Ai është larguar. Nuk di asgjë tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si e di që ai është larguar?

Kolë Krasniqi: Nuk ka qenë aty.

Kryetari i Trupit Gjykses: pra ti nuk e ke parë më pas mëngjesit të datës 25?

Kolë Krasniqi: Jo, ata kanë pasur brigada dhe njësi, unë nuk kam pasur asgjë të bëj me këtë.

Prokurori Publik tregon një certifikatë konfirmuese të TMK-së – dokumenti në nëndosjen 15, lidhësja e shënuar materialet me faqe 1-179 të dosjes së gjykatës.

Prokurori Publik: Do të ju tregoj dokumentin në Shqip, a mund ti lexoni fjalët, faqja 1-2?

Kolë Krasniqi: Nuk shoh mirë.

Prokurori Publik: Dokumenti thotë Seksioni Mjekësor me datë 21 Maj 2008, me protokol nr. 09/08. A ka lindur Gjelosh Prenk Krasniqi me 13 Shtator 1973 në Nepole, Komuna e Pejës, ushtar i UÇK-së – Zona Operative e Dukagjinit në Nepole, nga 16 Qershori 1998, dokumenti vazhdon (ndërpritet)

Haxhi Millaku: Ju lutem vazhdoni të lexoni nga dokumenti.

Prokurori Publik: Ai është plagosur më 5 Prill 1999 përderisa ka qenë në luftime në fshatin Jabllanicë, komuna e Gjakovës, i plagosur në kokë. A duken të sakta këto informata?

Kolë Krasniqi: Nuk e di. Kam dëgjuar që është plagosur; ka pasur kohë kur nuk kemi mundur të takohemi për 5-6 ditë.

Prokurori Publik: A është kthyer ndonjëherë në fshat?

Kolë Krasniqi: Jo, unë kurrë nuk e kam parë.

Prokurori Publik: A e di që ai ka qenë i caktuar në brigadën 32, në Shtator?

Kolë Krasniqi: Ne të gjithë kemi qenë të caktuar derisa brigada 32 u krijua në Maj.²⁵

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ka qenë prezent me ty dhe Gjeloshin natën në mes të 24 Marsit 1999 dhe mëngjesit të 25 Marsit 1999? Na trego emrat dhe mbiemrat.

Kolë Krasniqi: Kemi qenë 6-7 veta. Pashku, Kristi, nuk i di emrat tjerë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Mbiemrat e tyre?

Kolë Krasniqi: Të gjithë janë Krasniqi.

Kryetari i Trupit Gjykses: A janë gjallë këta njerëz?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ku jetojnë tani?

Kolë Krasniqi: Në Nepole.

Prokurori Publik: Deri tani, ke thënë që keni qenë 6-7 njerëz, Gjelosh Krasniqi dhe?

Kolë Krasniqi: Nuk i kam numëruar njerëzit.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ke qëndruar tërë natën me këta njerëz, ka qenë natë shumë e rëndësishme, dhe nuk të kujtohet cilët njerëz tjerë kanë qenë aty me ty?

Kolë Krasniqi: Nuk i di emrat e tyre të saktë. Do ti kisha njohur po ti shihja.

Kryetari i Trupit Gjykses: A kanë qenë nga fshati jot?

Kolë Krasniqi: Po por të gjitha shtëpitë janë djegur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Por por ty duhet të kujtohet kush ka mbetur në fshat.

Kolë Krasniqi: Nuk kam mundur ti numëroj.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa njerëz kanë qenë në fshat në atë kohë?

²⁵ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 31.03.2009, faqe 19 – 20

Kolë Krasniqi: Ata shkonin në kishë dhe u ktheshin në fshat.

Kryetari i Trupit Gjykues: Por para bombardimit, sa njerëz kanë qenë në fshat?

Kolë Krasniqi: Kanë qenë 200-300 njerëz në fshat, duke përfshirë gratë dhe fëmijët.

Kryetari i Trupit Gjykues: Në atë kohë, sa gjatë ke jetuar në atë fshat, deri në 1999?

Kolë Krasniqi: Qëkur kam lindur.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra duhet ta njohësh fshatin.

Kolë Krasniqi: Unë i njoh por ndonjëherë i harroj edhe emrat e djemve të mi. I njoh ata më të vjetrit por më të rinjtë nuk i njoh.

Kryetari i Trupit Gjykues: Këta 4 tjerët, a kanë qenë të ri apo të vjetër?

Kolë Krasniqi: Kanë qenë të ri, 3 prej neve kanë qenë më të vjetër.

Kryetari i Trupit Gjykues: Sa të ri?

Kolë Krasniqi: Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykues: I ri nuk është e saktë, sa të ri?

Kolë Krasniqi: Kanë qenë më të ri, nuk e di. Mund të pyes nëse dëshironi.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra i njeh, na trego emrat.

Kolë Krasniqi: Nuk iu di emrat.

Kryetari i Trupit Gjykues: I njeh si figura?

Kolë Krasniqi: Natyrisht.

Kryetari i Trupit Gjykues: Përafërshisht, sa vjet i kanë pasur?

Kolë Krasniqi: Nuk kuptoj, kjo ka ndodhur para 10 vjetëve.

Kryetari i Trupit Gjykues: A kanë qenë fëmijë, të mitur?

Kolë Krasniqi: Kanë qenë persona të ri.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra mund të thuash vetëm që kanë qenë të ri?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Më të ri apo më të vjetër se 20?

Kolë Krasniqi: Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: Të pyeta a i kanë pasur më shumë se 20 vjet apo jo?

Kolë Krasniqi: Nuk e di a i kanë pasur 17, 19 apo 20 vjet, nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: A i kanë pasur më shumë se 10 vjet?

Kolë Krasniqi: Po, natyrisht.

Kryetari i Trupit Gjykses: Këta 4 njerëz a kanë qenë përafërsisht të moshës në njëjtë?

Kolë Krasniqi: Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: A të kujtohet si ka qenë i veshur Gjelosh Krasniqi atë natë?

Kolë Krasniqi: Po. Ka pasur një përparëse të kuzhinës.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ka qenë kjo uniforma e tij e zakonshme kur ka punuar në kuzhinë?

Kolë Krasniqi: Po, natyrisht. Ndonjëherë nuk e ka veshur as atë, i kemi pasur vetëm rrobat tona.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dy personat tjerë që të kujtohen, si kanë qenë të veshur?

Kolë Krasniqi: Cilët?

Kryetari i Trupit Gjykses: Ti ke përmendur dy tjerë, Prenk Krasniqi.

Kolë Krasniqi: Po por ata nuk kanë qenë të veshur me uniformë.

Kryetari i Trupit Gjykses: : Po por unë dëshiroj të di çfarë kanë pasur të veshur?

Kolë Krasniqi: Nuk më kujtohet as çfarë kam të veshur unë tani.

Kryetari i Trupit Gjykses: Duhet të përgjigjesh e jo të komentosh. A të kujtohet çfarë kanë pasur të veshur?

Kolë Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si të kujtohet që Gjelosh Krasniqi e ka pasur të veshur atë përparëse, a nga memorja apo nga deduksioni?

Kolë Krasniqi: Më kujtohet sepse ai na ka shërbyer ushqimin me një person tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ty të kujtohet vetëm si ka qenë i veshur Gjelosh Krasniqi e të tjerët jo, a është kjo përgjigjja jote?

Kolë Krasniqi: Po. Nuk ia kam vënë mendjen si kanë ata të veshur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ti ia ke vënë mendjen vetëm si ka qenë i veshur Gjelosh Krasniqi?

Kolë Krasniqi: Po, ai na ka shërbyer.

Kryetari i Trupit Gjykues: Për këtë arsye ia ke vu mendjen si ka qenë i veshur?

Kolë Krasniqi: Po. I kam thënë të shkoj ta merr viçin në shtëpinë time.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ka qenë kjo hera e parë që të ka shërbyer Gjelosh Krasniqi?

Kolë Krasniqi: Jo, ai na ka shërbyer me qindra herë.

Kryetari i Trupit Gjykues: Dhe secilën herë ti ia ke vënë mendjen se si ka qenë ai i veshur?

Kolë Krasniqi: Ndonjëherë kur ka rënë ndonjë bombë ne jemi larguar, kemi shkuar në male dhe nuk e kemi parë njëri tjetrin 10 ditë.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ke qenë duke shërbyer vet apo me dikë tjetër?

Kolë Krasniqi: Ai e ka përgatitur dhe e ka sjellur aty.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra ka shërbyer vet?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Çfarë ka ndodhur pastaj, ai ju ka shërbyer të gjithëve, edhe të rinjve?

Kolë Krasniqi: Ai e ka përgatitur ushqimin, aty ka qenë një furrë e vjetër dhe ne e merrnim ushqimin dhe u shërbenim vet.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ka pasur të mbathura çizme?

Kolë Krasniqi: Nuk e di çfarë ka pasur.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ty të kujtohet që ka pasë të veshur përparëse por jo çizmet, nëse ia vënë mendjen rrobave të tij atëherë duhet të dish edhe këpucët.

Kolë Krasniqi: Pse do të më interesonin mua këpucët e tij?

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra ty nuk të kujtohen këpucët por të kujtohet përparësja.

Kolë Krasniqi: E di atë.

Kryetari i Trupit Gjykues: E din apo e ke parë?

Kolë Krasniqi: E kam parë që e ka pasur të veshur.

Kryetari i Trupit Gjykues: Çfarë ngjyre ka qenë kjo përparëse?

Kolë Krasniqi: Nuk e di ngjyrën sepse mendjen e kemi pasur tjetërkund në atë kohë.

Kryetari i Trupit Gjykues: Në çfarë forme e ka pasur përparësen?

Kolë Krasniqi: Ka qenë më e gjatë përpara dhe mua nuk më ka interesuar.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ka pasur pulla? Ne nuk kemi qenë aty, na trego?

Kolë Krasniqi: Kjo nuk më ka interesuar.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ka pasur xhepa kjo përparëse?

Kolë Krasniqi: Nuk e di, nuk jam marrë me përparëse.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra të kujtohet përparësja por nuk të kujtohet forma ose ngjyra?

Kolë Krasniqi: Ne kemi qenë duke i dëgjuar lajmet; ata kanë qenë duke thënë që aeroplanët e NATO-s do të nisen në ora 08.20. Mua as nuk më ka interesuar që ti shikoj.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ka pasur Gjelosh Krasniqi dorëza në duar?

Kolë Krasniqi: Jo, ku ka mundur të merr dorëza.

Kryetari i Trupit Gjykses: Të lutem përgjigju dhe mos komento. Ky është udhëzimi i fundit. A ka pasur dorëza?

Kolë Krasniqi: Jo.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Në çfarë kohe e ke parë Gjelosh Krasniqin atë natë?

Kolë Krasniqi: Prej rreth orës 2 pasdite deri të nesërmën në mëngjes.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Personat tjerë prezent, kur iu janë bashkangjitur?

Kolë Krasniqi: Ne kemi qenë së bashku tërë kohën.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Pra 6-7 persona kanë qenë së bashku tërë kohën?

Kolë Krasniqi: Po.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Në cilën shtëpi keni qenë atë ditë?

Kolë Krasniqi: Në shtëpinë e Pashk Krasniqit, i cili ka qenë aty. Shtëpia e tij nuk ishte djegur.

Ferdinando Buatier De Mongeot: A keni qenë në shtëpi tërë kohën apo keni lëvizur përreth?

Kolë Krasniqi: Kur kanë shtënë në neve ose kur na kanë granatuar, ne jemi larguar.

Ferdinando Buatier De Mongeot: A është fjala për ditën e njëjtë?

Kolë Krasniqi: Aeroplanët e NATO-s, ne kemi dëgjuar që do të nisen në ora 08.30, dhe ne kemi qenë atje deri në ora 08.00.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Prej kur jeni përqendruar aty?

Kolë Krasniqi: Malet kanë qenë afër shtëpisë dhe ne kemi lëvizuar në atë distancë. Ata na kanë granatuar gjatë ditës, dhe natën ne jemi kthyer në shtëpi.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Atë ditë, a ju kanë granatuar?

Kolë Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Atë natë, me 24 Mars 1999?

Kolë Krasniqi: Po, ata të gjithë së bashku. Pas 3-4 ditëve na kanë granatuar së bashku.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Gjatë asaj kohe, a është larguar ndokush?

Kolë Krasniqi: Ne kemi qenë atje tërë kohën.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Brenda në shtëpi?

Kolë Krasniqi: Po.

Ferdinando Buatier De Mongeot: Ju të gjithë?

Kolë Krasniqi: Po, nuk kemi pasur askund tjetër ku të shkojmë.²⁶

Kryetari i Trupit Gjykses: Atë natë, sa ushtarë të UÇK-së kanë qenë prezent, me 24 Mars?

Kolë Krasniqi: Atë natë kemi qenë 7-8.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa prej këtyre njerëzve kanë qenë prezent kur Gjëlosh Krasniqi e ka shërbyer darkën?

Kolë Krasniqi: 7-8 njerëz.

Kolë Krasniqi: Pra të gjithë njerëzit prezent kanë qenë ushtarë të UÇK-së?

Kolë Krasniqi: Po, 7-8 njerëz.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa vjet i ka pasur ushtari më i ri që e keni rekrutuar në Nepole?

Kolë Krasniqi: Ne i kemi rekrutuar nga mosha 17 vjeçare e më të vjetër. Ne jemi marrë më shumë me situata emergjente.

Kryetari i Trupit Gjykses: Në atë shtëpi, atë natë, a i ka pasur ndokush më pak se 17 vjet?

Kolë Krasniqi: Nuk e di, ndoshta ka pasur, unë kam qenë i përqendruar në atë që ka qenë duke ndodhur.

Tani përkthyesë është Shqipe Cavdarbasha

Kryetari i Trupit Gjykses: Ti ke thënë që ata kanë qenë UÇK?

²⁶ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 31.03.2009, faqe 21 – 27

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ti i njeh.

Kolë Krasniqi: Unë nuk i njoh, i njoh 2-3 prej tyre, dhe ju kam thënë emrat që i di.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ti ke thënë që asnjëri prej këtyre njerëzve, emrat e të cilëve nuk i di, nuk ka qenë më i ri se 17 vjeçar?

Kolë Krasniqi: Nuk e di.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pasi që na ke thënë që nuk keni rekrutuar njerëz më të ri se 17 vjeçar, dhe pasi që na ke thënë që në shtëpi kanë qenë ushtarët e UÇK-së, si është e mundur të ketë pasur njerëz më të ri se 17 vjeçar?

Kolë Krasniqi: Nuk është e çuditshme që unë mos ta di çfarë moshe kanë qenë, çfarë kanë pasur të veshur, çfarë ngjyre ka qenë përparësja.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pasi që kanë qenë ushtarë të UÇK-së ti është dashtë të dish moshën e tyre.

Kolë Krasniqi: Ju thash, unë kam qenë aty për të tentuar ti ndihmoj njerëzve, nuk më ka interesuar mosha e tyre.

Kryetari i Trupit Gjykses: Përgjigjja nuk përputhet me pyetjen time. Pasi që kanë qenë ushtarë të UÇK-së, duhet të dish moshën e tyre.

Kolë Krasniqi: Mund të pyes komandantin.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kjo nuk është mënyra si duhet të përgjigjesh. Dëshiroj të dish që pasi që kanë qenë ushtarë të UÇK-së në fshatin tënd, ti nuk e ke ditur moshën e këtyre njerëzve?

Kolë Krasniqi: Unë nuk i kam pyetur për moshën, dikush tjetër i ka pyetur për moshën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ka rekrutuar njerëz në fshat?

Kolë Krasniqi: Ata kanë ardhur vullnetarisht dhe janë bashkangjitur..²⁷

Kryetari i Trupit Gjykses: Jo, a e ke ditur sa njerëz kanë qenë në ushtri në Nepole?

Kolë Krasniqi: Po, natyrisht.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush të ka informuar për këtë numër?

Kolë Krasniqi: Sepse unë kam qenë bashkë me ta.

²⁷ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 31.03.2009, pages 29 – 30

Kryetari i Trupit Gjykses: Gjatë ditës.

Kolë Krasniqi: Gjatë ditës, gjatë natës. Kur është qetësuar situata, ne kemi vendosur roje.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pasi që ke qenë i informuar për të gjitha lëvizjet, si u bë që Gjesh Krasniqi, në mëngjes të 25-tit thjeshtë u larguar nga fshati dhe ti nuk di se çfarë është bërë me të?

Kolë Krasniqi: Ai nuk ka pasë nevojë të më tregoj.

Kryetari i Trupit Gjykses: A kanë qenë rojet në dijeni, ku kanë qenë ata?

Kolë Krasniqi: Rojet kanë qenë në fshat. Ne kemi menduar që pasi që NATO do të bombardoj ne jemi çliruar dhe nuk kemi menduar dy herë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Për çfarë?

Kolë Krasniqi: Ne kemi menduar që jemi të lirë. NATO do të bombardoj dhe ne nuk duhet të merremi me këtë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po por atë natë, a i ke vendosur rojet?

Kolë Krasniqi: Nuk ka pasur roje; kemi qenë vetëm ne në shtëpi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pasi që ju të gjithë keni qenë në këtë shtëpi, si është e mundur që Gjesh Krasniqi thjeshtë është larguar nga shtëpia, a ka kuptuar dikush që ai është larguar nga shtëpia dhe fshati?

Kolë Krasniqi: Ne nuk kemi parë ku ka shkuar ky person.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pasi që të gjithë keni qenë në shtëpinë e njëjtë.

Kolë Krasniqi: Ne kemi pasur obligim të kujdesemi për njerëzit përderisa ata kanë qenë në fshat, nëse kanë dashtë të largohen ata kanë mundur të largohen.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pasi që ju të gjithë keni qenë në shtëpinë e njëjtë, a ka kuptuar dikush që Gjesh Krasniqi është larguar nga shtëpia?

Kolë Krasniqi: Edhe të tjerët janë larguar.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e ka kuptuar dikush që Gjesh Krasniqi është larguar nga fshati.

Kolë Krasniqi: Unë nuk e kam kuptuar.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e ke parë Gjesh Krasniqin duke u larguar nga shtëpia apo jo?

Kolë Krasniqi: Nuk e kam parë.

Kryetari i Trupit Gjykses: A e ka parë dikush tjetër nga shtëpia duke u larguar?

Kolë Krasniqi: Nuk e di. E di që kemi festuar deri herët në mëngjes.

Kryetari i Trupit Gjykues: Sa dyer i ka ajo shtëpi?

Kolë Krasniqi: Nuk është shtëpia ime, si ta di.

Kryetari i Trupit Gjykues: Po por ti ke qëndruar aty tërë natën, a të kujtohet sa dyer i ka pasur?

Kolë Krasniqi: E di që ka qenë një, mund të kenë qenë dy.

Kryetari i Trupit Gjykues: A keni qëndruar të gjithë në të njëjtën dhomë apo në dhoma ndamas?

Kolë Krasniqi: Në dhomën e njëjtë, deri në orët e mëngjesit.

Kryetari i Trupit Gjykues: Si është e mundur që ju të gjithë keni qëndruar së bashku deri në orët e mëngjesit dhe askush nuk e parë Gjeloš Krasniqin?

Kolë Krasniqi: Ndoshta dikush e ka parë.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pasi që ti ke qenë komandant, mendoj që ti është dashtë të jesh i informuar sepse ke thënë që lëvizjet e ushtarëve tuaj kanë qenë të kontrolluara.

Kolë Krasniqi: Ne nuk kemi qenë ushtri e mirëfilltë. As Wesley Clark nuk ka mundur ti di këto gjëra.

Kryetari i Trupit Gjykues: Fjala është për vetëm 7 njerëz në të njëjtën dhomë.

Kolë Krasniqi: Ne kemi qenë aty deri në mëngjes, nuk më kujtohet a ka qenë i 25-ti apo i 26-ti. Vetëm e di që kemi qenë aty deri në orët e hershme.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra nuk të kujtohet a ka qenë i 25-ti apo i 26-ti?

Kolë Krasniqi: Ka qenë i 25-ti sepse me 24 kemi ndejtë deri në mëngjes.

Kryetari i Trupit Gjykues: Është fjala për natën e datës 24?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pse para pak kohe ke thënë që nuk të kujtohet a ka qenë i 25-ti apo i 26-ti?

Kolë Krasniqi: Ne kemi mbajtur në mend që NATO do të bombardonte, ne kemi pritur për këtë për 50 vjet, dhe nuk na ka interesuar asgjë tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykues: A je i sigurt që kjo ka ndodhur kur ka bombarduar NATO?

Kolë Krasniqi: Po kurrë nuk do ta harroj.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ka qenë hera e parë që ka bombarduar NATO?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dëshiroj të di – pra ju të gjithë keni qëndruar në këtë dhomë deri në mëngjes, a keni qenë të gjithë të zgjuar deri në mëngjes?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra si është e mundur, ju keni qëndruar në një dhomë, ka qenë vetëm një derë në atë shtëpi, si është e mundur që askush nuk e ka parë Gjelos Krasniqin duke u larguar nga shtëpia?

Kolë Krasniqi: Ne jetojmë në një fshat, ne nuk kemi as nevojtoje, dhe neve as nuk na ka interesuar çfarë ishte duke ndodhur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ti je duke thënë që nuk e ke parë Gjelos Krasniqin duke u larguar nga shtëpia?

Kolë Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur pas 2-3 orëve nuk e ke parë në shtëpi, çfarë ke bërë?

*Kolë Krasniqi: Asgjë.*²⁸

Kryetari i Trupit Gjykses: Të vazhdojmë, a je duke thënë që nuk e ke parë Gjelos Krasniqin duke dalë nga shtëpia?

Kolë Krasniqi: Ne kemi ndejtë duke pirë deri në mëngjes duke pirë dhe dikur kemi shkuar për të fjetur dhe nuk më ka interesuar çfarë ka ndodhur ne jemi shpërndarë nëpër shtëpitë tona.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ti ke thënë që ke qenë i zgjuar deri në mëngjes?

Kolë Krasniqi: Ne kemi qëndruar zgjuar tërë kohën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur?

Kolë Krasniqi: Ka qenë rreth 7 ose 8 e mëngjesit.

Kryetari i Trupit Gjykses: E ke fjalën për mëngjesin e 25 Marsit?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ku kanë fjetur këta 7 njerëz?

Kolë Krasniqi: Shtëpitë tona janë afër njëra tjetrës. Dy ose tre kemi fjetur aty, të tjerët janë larguar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ka fjetur aty?

²⁸ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 31.03.2009, faqe 32 – 35

Kolë Krasniqi: Pashku dhe unë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ku kanë shkuar të tjerët?

Kolë Krasniqi: Në shtëpitë e tyre. Ne nuk kemi marrë më me ta.

Kryetari i Trupit Gjykses: A mund të shpjegosh pse keni ndejtë deri në ora 7 në shtëpi? Çfarë ka ndodhur në ora 7 që thatë “në rregull tani mund të shkojmë për të fjetur”?

Kolë Krasniqi: Ne kemi menduar që kur NATO kishte filluar bombardimet, ne kemi besuar që ne ishim çliruar.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur ka filluar bombardimi?

Kolë Krasniqi: Nuk e di a ka qenë ora 9 apo 8.50. Ne e kemi pasur një radio të keqe.

Kryetari i Trupit Gjykses: Si u bë që në ora 7 situata më nuk ishte aq e rrezikshme?

Kolë Krasniqi: Ne kemi mundur të festojmë tërë natën.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra ju keni festuar tërë natën?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Dhe çfarë ka ndodhur në ora 7?

Kolë Krasniqi: Çfarë ka pasur të ndodh? Kemi shkuar për të fjetur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ka vendosur që festa u krye?

Kolë Krasniqi: Ne të gjithë. Ne të gjithë kemi thënë “në rregull, e tërë puna është kryer”. Unë besoj që tërë Kosova ka menduar ashtu.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush ka qenë pronar i shtëpisë?

Kolë Krasniqi: Pashku.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ti ke qëndruar në shtëpi dhe Pashku ka qëndruar në shtëpi?

Kolë Krasniqi: Pashku dhe unë. Pas orës 7 kemi shkuar për të fjetur. Të tjerët kanë shkuar në shtëpitë e tyre.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ka thënë diçka Gjeloš Krasniqi?

Kolë Krasniqi: Ai nuk ka thënë asgjë dhe unë nuk e kam parë.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ai vetëm është larguar pa e thënë asnjë fjalë?

Kolë Krasniqi: Ne kemi shkuar për të fjetur dhe kemi qenë edhe të dehur.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ka thënë ai lamtumirë?

Kolë Krasniqi: Nuk e di a ka thënë lamtumirë.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ka qenë ai i dehur?

Kolë Krasniqi: Ne kemi qenë aq të lumtur që ishim të dehur edhe po të mos kishim pirë asgjë.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ka qenë i dehur apo jo?

Kolë Krasniqi: Nuk e di, nuk e di. Ne të gjithë kemi pirë. Nuk mund të them a ka qenë i dehur apo jo.²⁹

Kryetari i Trupit Gjykues: Kur një ushtar është larguar nga njësia jote, ti nuk e ke lajmëruar askend?

Kolë Krasniqi: Unë atëherë nuk kam pasur asgjë të bëj me ushtarët, ka qenë komandanti tjetër.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ne flasim për një ushtar nga njësia jote. Ti nuk e sheh më dhe nuk e informon askend?

Kolë Krasniqi: Pas të 25-tit ne nuk e kemi informuar askend për asgjë. Nuk e di çfarë kanë bërë të tjerët.

Kryetari i Trupit Gjykues: Kur e ke kuptuar që Gjeloshi më nuk është një fshat? Mëngjesin e njëjtë me datë 25?

Kolë Krasniqi: Në mëngjes me datën 25 ne të gjithë kemi qenë së bashku. Të tjerët kanë shkuar në shtëpitë e tyre dhe mua nuk më ka interesuar kush ka shkuar ku.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pas një kohe je zgjuar?

Kolë Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Dhe nuk të ka interesuar më për njerëzit në fshat?

Kolë Krasniqi: Unë kam shkuar në shtëpinë time, komandanti tjetër ka ardhur dhe unë më nuk jam marrë me këtë.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra me datë 25 ka ardhur komandanti tjetër?

Kolë Krasniqi: Pashku ka qenë komandant..³⁰

²⁹ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 31.03.2009, faqe 36 - 37

³⁰ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 31.03.2009, faqe 39 - 40

1. n) Pal Krasniqi, *(personi i cili sipas deklaratës së Gjergj Lulit kishte kërkuar të ndihmojë Gjelosh Krasniqin)* në deklaratën e tij dhënë përpara Trupit gjykues, ka deklaruar se Gjelosh Krasniqi ka jetuar në fshatin Nepole dhe se shtëpia e tij ishte rreth 200 – 300 metra larg shtëpisë së tij, por ai nuk kishte ditur asgjë lidhur me aktivitetin e ushtarëve të UÇK-së, meqë ai kishte ikur nga Kosova kur filloi lufta.

Ai poashtu ka deklaruar se e kishte njohur Gjergj Lulin, meqë ai ishte i afërm i tij, por pas luftës nuk e kishte takuar më. Pali kishte vizituar njëherë shtëpinë e Gjergjit pesë vite më parë, kur ishte kthyer nga bota e jashtme, ne menyrë që të vizitojë mbesën e tij, nënën e Gjergjit, Zoje Lulin. Por, ata asnjëherë nuk diskutuan lidhur me zhdukjen e bashkëshortit të saj Pashk Lulit, apo lidhur me akuzat kundër Gjelosh Krasniqit.

Në fund, dëshmitari ka deklaruar se në fshatin Nepole ai njihnte dy persona me emrin Gjelosh Krasniqi, njëri ishte i pandehuri ndërsa tjetri ishte shumë më i ri, aktualisht rreth 20 vjeç.

1. o) Pashk Pergega, *(pronari i shtëpisë afër së cilës, sipas deklaratës së Gjergj Lulit të datës 16.1.2008, Gjergji kishte takuar Gjelosh Krasniqin katër ditë pas luftës)* në deklaratën e tij dhënë përpara Trupit gjykues, ka deklaruar se kishte pasur shtëpinë në fshatin Doblbare, por kishte jetuar në Gjermani për një kohë të gjatë qysh para luftës dhe se ishte kthyer në Kosovë shumë kohë pas përfundimit të luftës. Ai ka thënë se djali i tij Roberti ka pasur qasje në shtëpi, por ai nuk e ka ditur se ku ka jetuar ai pak pas luftës. Ai e ka njohur Gjergj Luli meqë ishte kumbarë i tij, por nuk e ka njohur fare Gjelosh Krasniqin.

1. p) Robert Pergega, *(djali i Pashk Pergegës)* në deklaratën dhënë përpara Trupit gjykues, ka deklaruar se e njihnte Gjergj Lulin, por nuk e njihnte Gjelosh Krasniqin. Ai ishte në Kosovë, në qershor të vitit 1999, në shtëpinë e babait të tij dhe ishte vizituar një herë nga Gjergj Luli disa ditë pas luftës: Gjergji e pyeti nëse e njihnte Gjelosh Krasniqin, por përgjigjja e tij ishte se nuk e njihnte dhe pastaj ai u largua dhe nuk e ka vizituar më kurrë. Sipas dëshmitarit, ai nuk ishte i vetmi që Gjergj Luli kishte pyetur nëse e njihnte Gjelosh Krasniqin.

1. q) Ermir Shehu, në deklaratën e tij dhënë përpara Trupit gjykues, ka deklaruar se ai i ishte bashkuar ICTY (Tribunalit të Hagës) në shkurt 2004, si përkthyes duke punuar për hetuesit e ICTY (Tribunalit të Hagës) të cilët hetonin krimet e luftës që kishin ndodhur në Kosovë gjatë konfliktit. Procedura standarde lidhur me procesin e intervistimit ishte se dëshmitarët fillimisht kanë dhënë një verzion të përgjithshëm të tregimit dhe pastaj hetuesi është fokusuar në detajet ose faktet e lidhura me krimet e pretenduara të luftës dhe njerëzit. Deklarata ishte shtypur në gjuhën angleze dhe pastaj i është lexuar dhe përkthyer dëshmitarit në gjuhën shqipe. Nëse nuk ka pasur vërejtje lidhur me faktet, dëshmitari e ka nënshkruar deklaratën. Procedura ka qenë shumë e saktë, në menyrë që të shmanget mundësia e mospërputhjes së fakteve apo detajeve.

Atij i është kujtuar deklarata e Gjergj Lulit e dhënë më 25 shkurt dhe 2 mars 2004, por kjo përfshirje në këto deklarata ka qenë vetëm sa për t'ju lexuar prapa dhe për t'ju përkthyer atë çfarë kolegu i tij kishte përpiluar më herët. Sa i kujtohej atij, nuk ka pasur vërejtje nga ana e dëshmitarit Gjergj Luli i cili është pajtuar me deklaratën dhe e ka nënshkruar.

1. r) Pashk Krasniqi, kushëri i largët i të pandehurit, në dëshminë e tij dhënë para Trupit gjykues, ka deklaruar se i është bashkuar UÇK-së më 16 qershor 1998, pas një takimi që është mbajtur në fshat dhe udhëheqësia kishte vendosur që ata duhej të organizoheshin në mënyrë që të mbrojnë fshatin. Në atë kohë edhe Gjelosh Krasniqi ishte i kyçur në UÇK. Ata kishin organizuar rojet për të përcjellur situatën, sepse në mars 1999, pas vendimit të NATO-s për të bombarduar Serbinë, Šešelji kishte lëshuar një komunikatë duke thënë se shqiptarët do të dëboheshin nga Kosova. Sa i përket orarit të rojeve në fshat, ai kishte mbajtur shënime nga 20 marsi deri më 2 prill 1999 lidhur me aktivitetin e UÇK-së fshatin Nepole.

Dëshmitari ka deklaruar se, kur ushtarët kanë dashur të dalin nga fshati, ata është dashur të kërkojnë lejen e tij. Në atë kohë Gjelosh Krasniqi ka pasur si detyrë punën në kuzhinë dhe ai nuk ka mundur të largohet nga fshati.

Më 24 mars 1999, ai ka organizuar rojet e fshatit, derisa aid he persona të tjerë shkuan në shtëpinë e tij për të festuar fillimin e bombardimit nga NATO. Në këtë natë ishin gjashtë persona në shtëpinë e tij, dhe atë Kole Krasniqi, Gjelosh Krasniqi, vëllai i tij Gjergj i cili është vrarë më vonë, Krist Krasniqi dhe një fqinj, Joze Ademi. Këtë natë ata kanë ndenjur zgjuar deri rreth orës 02:00 dhe në mëngjes, ai ka shkuar të kontrollojë rojet. Gjelosh Krasniqi dhe Kole Krasniqi ishin së bashku me të deri rreth orës 22.00 të datës 25 mars 1999. Para 25 marsit, Kole Krasniqi ishte komandanti lokal i njësisë së tij dhe shtëpia e tij përdorej si shtab. Njësia ishte nën komandën e Lulzim Morinës, komandant i Brigadës 132, Agim Zeneli. Në këtë kohë, Gjelosh Krasniqi ishte përgjegjës për furnizimet me ushqim dhe pajisjet e kuzhinës dhe poashtu ka raportuar për situatën në kuzhinë, por brenda periudhës 20 mars dhe 4 prill 1999 ai nuk ka lëshuar fshatin për t'u furnizuar me ushqim.

Dëshmitari, i paraqitur nga avokati mbrojtës i të pandehurit, ishte marrë në pyetje nga Prokurori dhe pastaj nga Trupi gjykues. Më poshtë, janë disa abstrakte nga procesverbali i datës 24.4.2009.

Prokurori Publik: A mund te me ndihmoni qe te kuptoj nje dokument te pergatitur nga Nenkoloneli Sali Lajqi? Ky dokument i deshmon te dhenat e sherbimit te Gjelosh Krasniqit dhe ai deshmon se ai ka qene i caktuar ne njesitin e fshatit Nepole ne cilesin e ushtarit e jo te kuzhinierit qe nga data 16 qershor 1998 deri ne gusht apo shtator 1998 dhe pastaj ne Brigaden 132 Zeneli nga shtatori 1998 deri me qershor 1999 dhe ky dokument eshte i vulosur ne letren me mbishkrimin e Shtabit Kryesor te TMK-se. A pajtoheni me kete konfirmin te evidentuar nga proqesverbali?

Pashk Krasniqi: Lokali nuk ka pase brigada. Kjo ishte nje luftë e bazuar ne baza vullnetare dhe pas ofenzives me 2 gusht dhe 3 shtator ashtu siq e kam permend, marreveshja ne mes te Millosheviqit dhe Holbrook-ut, brigadat jane themeluar ne shtator.

Kryetari i Trupit Gjykes: Prokurori Publik po thote se Gjelosh Krasniqi ishte duke sherbyer ne cilesine e ushtarit e jo si kuzhinier, kjo ishte poenta e Prokurorit Publik, mirepo sipas jush ai ishte vetem kuzhinier dhe se arma iu ishte dhene te vellaut te tij e jo atij. Kjo eshte pika qe duhet te qartesohet.

Pashk Krasniqi: Ne nuk kemi pase makine shkrimi apo vula. Cdo gje qe kishim ishte shkruar me dore keshtu qe nuk kemi mbajte proqesverbal me shkrim lidhur me cdo ushtar por vetem komandanti dhe zevendesi e bente kete. Ne nuk i kemi specifikuar funksionet e tyre.

Prokurori Publik: Po mundohem te kuptoj e ndoshta ju mund te sqaroni se a ka qendruar Gjelosh Krasniqi pas 24 marsit dhe nen komanden e juaj?

Pashk Krasniqi: Po.

Prokurori Publik: A ishte Kole Krasniqi komandant?

Pashk Krasniqi: Ai ishte komandant i Shtabit Lokal deri kur shkoi ne Bugan rreth 27 ose 28. 26 ose 27 mars.

Prokurori Publik: Nese do te leshonte dikush postin pa lejen e juaj a do ta raportoni kete fakt?

Pashk Krasniqi: Po te ndodhte nje gje e tille, por une nuk kam pase raste te tilla.

Prokurori Publik: Kemi ndegjuar se Gjelosh Krasniqi eshte zhdukur nga fshati Nepole pas 24 marsit dhe nuk eshte pare me.

Pashk Krasniqi: Nuk eshte e vertete; Gjelosh Krasniqi ishte ne Nepole deri ne fund te luftes. Si ka mund te zhduket Gjelosh Krasniqi kur ia varrosem vellaun me 24 prill dhe ai ka qene aty?

Prokurori Publik: A pajtoheni me pohimin se pas bombardimit me 24 mars kishte rene disciplina ne mesin e ushtareve ne Nepole?

Pashk Krasniqi: Nuk eshte e vertete.

Prokurori Publik: Do te doje t'ju pyesja lidhur me plagosjen e Gjelosh Krasniqit; sipas te te dhenave lidhur me sherbimin e tij qe ua tregova aty thuhet se ai ishte plagosur me 5 prill 1999 gjate luftimeve ne Jabllanice nga nje predhe te granates se hedhur. A ishi prezent ju gjate ketij luftimi?

Pashk Krasniqi: Jo.

Prokurori Publik: Kush e dergoi kete kuzhinier te parmatosur dhe pa uniform ne beteje?

Pashk Krasniqi: Ofenziva e 3 dhe 4 prillit qe zhvillua ne hyrje te Nepoles, aty isha prezent por pas nja 10 oreve u largova nga fushe beteja dhe policia dhe forcat ushtarake hyne ne fushe dhe pjesa tjeter e popullates shkoi ne kishë kurse une e kam kaluar pjesen tjeter te dites me vellaun e tij Gjergjin dhe Gjelosh Krasniqi shkoi ne Jabllanice dhe te nesermen ndegjova se Gjelosh Krasniqi ishte plagosur. Ne te njejten dite eshte vra Brahimi dhe ushtaret e mi e kane varrosur.³¹

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne deshirojme t'i kthehemi nates se 24shit. A ju kujtohet se cfare kishte zier Gjelosh Krasniqi per darke?

Pashk Krasniqi: Mish vici.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ju that se ishin gjashte (6) apo shtate (7) njerez.

Pashk Krasniqi: Gjashte (6).

Kryetari i Trupit Gjykses: Cfare ishte mosha e te tjereve? A ishin te rinj, te vjeter?

Pashk Krasniqi: Kola ishte me i vjetri. Joza ishte pak me i ri se Gjeloshi. Kristi ishte i lindur rreth 1965. Gjergji ishte i lindur ne 1965. Une i kam shemuar vet te dhenat e tyre personale atehere kur ishin ushtare.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pak a shume keto ishin moshat e njerezve. Pastaj si shkoi me tutje? Deri ne oren sa ishte darka?

Pashk Krasniqi: Kur kemi nje feste te ketille ose nje rast gazmor, darka ose ushqimi mundet me zgjate bukur gjate meqe ne vazhdonim te pinim alkohol dhe hanim me ngadal keshtu qe darka ka zgjate nja kater (4) ore.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kur kishte filluar?

Pashk Krasniqi: Rreth ores 20.00 dhe ka zgjate deri ne mesnate.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ne ora sa jeni tubuar ne shtepi?

Pashk Krasniqi: Para ores 20.00.

Kryetari i Trupit Gjykses: A keni shkuar te gjithë se bashku ne shtepi?

³¹ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 24.4.2009, faqe 18 – 19.

Pashk Krasniqi: Po, te gjithë se bashku ne shtepine time.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ishte Gjeloshi me ju?

Pashk Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ne ora sa keni filluar te ngreni?

Pashk Krasniqi: Pak para ores 20.00. Nuk mund te jem me i sakte.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ju keni hyre rreth ores 20.00 dhe keni filluar te ngreni pothuaj ne te njejten kohe, ne oren 20.00.

Pashk Krasniqi: Kemi arrite ne shtepine time rreth ores 19.00. Nuk kemi filluar me darke menjehere, por kemi filluar me raki e kafe.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pse that para nje minuti se kishi arritur pak para ores 20.00 e kurse tash po thoni 19.00?

Pashk Krasniqi: 19.00, 20.00. Une kam thene para ores 20.00.

Kryetari i Trupit Gjykues: Kur jeni tubuar ne shtepine e juaj?

Pashk Krasniqi: Rreth ores 19.00.

Kryetari i Trupit Gjykues: Kur ka filluar darka?

Pashk Krasniqi: Kemi filluar te pime rreth ores 20.00 kurse darka ka filluar me vone meqe mishi nuk mund te pergatitet brenda dy minutave.

Kryetari i Trupit Gjykues: Sa kohe me vone?

Pashk Krasniqi: Rreth 22.00.

Kryetari i Trupit Gjykues: Vetem para nje minuti that se keni filluar te ngreni pak para ores 20.00 kurse tash po thoni se darka ka filluar ne oren 22.00. Si eshte e mundur qe ekziston nje mosperputhje kaq e madhe?

Pashk Krasniqi: Ne jemi ule dhe kemi filluar te pime raki dhe kafe dhe te hame meze dhe ne kete e konsiderojme darke prej atij momenti.³²

³² Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 24.4.2009, faqe 20 – 22.

Kryetari i Trupit Gjykses: Tash jemi rreth mesnates dhe darka ka perfunduar. Cfare ndodhi?

Pashk Krasniqi: Shqiptaret shpetoheshin. Ishim me disponim te mire dhe ngelim edhe dy ore deri ne oren 02.00 dhe pastaj shkuam qe te clodhemi pak dhe te flejme ne shtepi deri ne mengjes.

Kryetari i Trupit Gjykses: Ku e bete kete pushim?

Pashk Krasniqi: Ne te tre pushuam ne kuzhine kurse ata tre te tjeret shkuan ne nje dhome tjeter, te cilen e quaj dhome te mysafireve.

Kryetari i Trupit Gjykses: Kush shkoi ne ate dhome tjeter?

Pashk Krasniqi: Gjergji, Kola dhe Kristi.

Kryetari i Trupit Gjykses: Derisa ju, Gjeloshi dhe nje person tjeter ishi duke pushuar ne kuzhine?

Pashk Krasniqi: Po.

Presiding Judge: Cfare po mendoni me fjalen pushim, a e keni fjalen per fjetje?

Pashk Krasniqi: Po, ishim duke fjetur.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa kohe keni fjetur?

Pashk Krasniqi: Deri rreth ores 06.00 ne mengjes.

Kryetari i Trupit Gjykses: Jo dy (2) ore por kater (4) ore.

Pashk Krasniqi: Perafersisht kater (4) ore, prej ores dy (2) deri ne oren gjashte (06.00).

Kryetari i Trupit Gjykses: A keni fjetur?

Pashk Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Pra nuk mund te tregoni se cfare ishte Gjeloshi duke bere ne ate kohe?

Pashk Krasniqi: Gjeloshi ka rene ne gjume apo pushonte ne te njejten kohe si une.

Kryetari i Trupit Gjykses: Nese ishi duke fjetur, ju nuk mund te tregoni se cfare ishte ai duke bere. Ndoshta ishte zgjuar por nese e dini kete na tregoni.

Pashk Krasniqi: Ai ne asnje menyre nuk ka mund te ket qene i zgjuar. Nuk kishim gjume te rende gjate luftes.

Kryetari i Trupit Gjykues: Si mund te thoni se ka mundur te zgjohet kur po thoni se keni fjetur kater (4) ore te tera?

Pashk Krasniqi: Une do ta ndegjoja hapjen e deres dhe une i kisha dy qen ne kopshtin tim keshtu qe nuk do te mund te dilte nga shtepia.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ky eshte vetem nje supozim i juaji dhe si deshmitar ju nuk mund te supozoni. Ju mund t'i referoheni vetem asaj qe keni pare dhe ndegjuar. Nuk jeni ketu per te bere supozime. Ju keni fjetur kater (4) ore te tera.

Pashk Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra, tash jemi ne oren 06.00 ne daten 25.

Pashk Krasniqi: Po.

Presiding Judge: Cfare ndodhi?

Pashk Krasniqi: Kur u zgjuam ne mengjes, i kemi lare duart dhe fytyrat tona. Shkuam ne fshat per t'i veshtruar rojet. Ne i filluam aktivitetet e perditeshme.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ju te gjithë apo vetem disa prej juve?

Pashk Krasniqi: Ne te gjithë.

Kryetari i Trupit Gjykues: A ishte Kole Krasniqi i pranishem gjate ketyre aktiviteteteve te kryera nga ky grup i njerezve?

Pashk Krasniqi: Po.

Presiding Judge: Dhe pastaj? Te gjithë shkuat per te pare se cfare benin rojet, poashtu edhe Gjeloshi ishte i pranishem.

Pashk Krasniqi: Ai erdhi me ne ne fshat. Une shkova bashke me Kristin per t'i veshtruar rojet dhe u ktheva pas 20 minutave dhe iu bashkangjita perseri.

Kryetari i Trupit Gjykues: Cfare ndodhi me ata tre tjere, Kolen dhe ata dy tjere?

Pashk Krasniqi: Kola dhe ata dy tjere qendruan ne fshat.

Kryetari i Trupit Gjykues: Sa per te qene te qarte. Pas ores gjashte (06.00) u pastruat dhe pastaj ju te gjithë te gjashtit shkuat per te pare se cfare benin rojet. Pastaj grupi ndahet ne dysh ne mes te fshatit.

*Pashk Krasniqi: Nja 20 minuta.*³³

Kryetari i Trupit Gjykues: Te flasim pra lidhur me Gjeloshin. Te gjithë se bashku jeni në fshat, ky grupi i perbere prej gjashtë (6) personave. Pastaj Kola e merr urdherin për të shkuar në Buqan dhe ai shkon në shtëpinë e tij. Si qendron puna me ata pesë (5) të tjerë?

Pashk Krasniqi: Në kishim detyrat tona për t'i kryer. Ishim të informuar se 2000 njerëz kishin ardhë në Kralan nga Drenica dhe në duhej të shkonim atje për t'i vendosur neper shtëpi.

Kryetari i Trupit Gjykues: Shkuat të gjithë atje apo jo?

Pashk Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Poashtu edhe Gjelosh Krasniqi?

Pashk Krasniqi: Po, ai e voziste traktorin.

Kryetari i Trupit Gjykues: Dhe pastaj?

Pashk Krasniqi: Pastaj, i sollem ata në fshat në Gllogjan dhe në Llugaxhi ku disa nga familjet kishin nga 90 anetare në mesin e tyre edhe Gjeloshi me të vëllaun e tij. Vlen të përmendet se në ato ditë një grua e vjetër... (deshmitari nderpritet))

Kryetari i Trupit Gjykues: Nuk jemi duke u marrë me luftën por me një krim të luftës që është dëbja e vjetër. Si ishte Kole Krasniqi si komandant? A kërkonte që të informohej lidhur me levizjet e ushtareve të tij? Për shembull, nëse një ushtar do të largohej nga fshati pa të informuar atë, a ishte kjo sjellje e pranueshme apo jo?

Pashk Krasniqi: Si komandant ishte i mirë, mirepo nuk ishte detyrë e komandantit që të mirrej me të gjithë ushtaret dhe për këtë arsye, unë isha aty meqë ai kishte detyrë për t'iu përcjellë, detyrat e dhëna nga ana e Komandantit të Zonës dhe Komandantit të Brigadës.

Kryetari i Trupit Gjykues: A donte të informohej apo jo?

Pashk Krasniqi: Unë e informoja lidhur me çdo rast.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra, donte që të informohej?

Pashk Krasniqi: Natyrisht.

³³ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 24.4.2009, faqe 25 – 26.

Kryetari i Trupit Gjykues: Nese nuk do ta informonit lidhur me nje fakt te tille a do te hidherohej apo jo?

Pashk Krasniqi: Natyrisht, po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Nese kjo do te kishte ndodhe ne mengjesin e e 25shit, a do ishte hidheruar apo jo?

Pashk Krasniqi: Cfare te kishte ndodhe?

Kryetari i Trupit Gjykues: Nese ndonje ushtar i tij te kishte braktise fshatin pa ju informuar?

Pashk Krasniqi: Ai do te me kishte denuar mua se pari e pastaj natyrisht edhe ushtarin.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ai ishte nje komandant shume i ashper?

Pashk Krasniqi: Ne njeri shume i singert.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ishte i ashper apo jo?

Pashk Krasniqi: Ishte i ashper.

Kryetari i Trupit Gjykues: Lidhur me kete ceshtjen e largimit nga fshati pa leje, a ishte i ashper apo jo?

Pashk Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Pra, ai kurr nuk do te kishte lejuar nje gje te tille.

Pashk Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykues: Edhe pse kjo ishte ne mengjesin e 25shit pas bombardimit te NATO-s?

Pashk Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ai ishte i ashper edhe pse ishte ky mengjesi i 25shit?

Pashk Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ju that se Kole Krasniqi ishte nje person shume i singert.

Pashk Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Per t'ua bere kete me dije, ketu para gjyqit, Prokurorit Publik, Mbrojtjes dhe te pandehurit, ai ka thene se nuk e kishte me gajle dhe se Gjelosha Krasniqin nuk e kishte pare qe nga data 25 dhe se nuk ishte informuar fare lidhur me largimin e tij nga fshati. Vetem me ua be kete me dije. Keto ishin oret e hershme te mengjesit te dates 25.

Pashk Krasniqi: Une nuk di se cka ka deklaruar Kole Krasniqi.³⁴

Kryetari i Trupit Gjykses: Me 24 mars, si ishte veshur?

Pashk Krasniqi: A ishte veshur me rroba civile me 24 mars meqe nuk kishim uniforma te mjaftueshme. Gjithesejt i kemi pase 17 uniforma.

Kryetari i Trupit Gjykses: Gjate darkes, cfare rrobash kishte veshur?

Pashk Krasniqi: Ai e kishte veshur perparesen e kuzhinierit.

Kryetari i Trupit Gjykses: Sa ishte e gjate kjo perparesje?

Pashk Krasniqi: Deri ne gjunje.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ju kujtohet ngjyra?

Pashk Krasniqi: E bardhe.

Kryetari i Trupit Gjykses: A kishte xhepa kjo perparesje?

Pashk Krasniqi: Dy xhepa ne pjesen e perparme.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ju kujtohet se cfare kepucesh kishte mbathur?

Pashk Krasniqi: Kepuce te ngjyres zeze e te mbyllte.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishin ato çizme apo kepuce?

Pashk Krasniqi: Kepuce.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ju kujtohet ngjyra e pantalloneve te tija?

Pashk Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Po ju kujtohet ne menyre te persosur se kishte kepuce te zeza te erreta para 10 vjeteve. Komplimentet e mia, ju jeni nje njeri brilant.

³⁴ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 24.4.2009, faqe 27, 28, 29.

Pashk Krasniqi: Memorien e kam bukur te forte pasi qe une i kam 11 femije dhe nipa.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ndoshta mund te na tregoni ngjyren e kemishes se tij.

Pashk Krasniqi: Ishte pakez ndryshe nga ngjyra e perpareses.

Kryetari i Trupit Gjykues: A kishte njolla ne perparesen apo jo?

*Pashk Krasniqi: Jo.*³⁵

Prokurori Publik: Ca pyetje te bazuara ne dokumentin e perkthyer, te cilin tani e lexova. Jam duke shikuar raportin ditor per daten 23 mars 1999. Ndoshta ai mundet me shikua ne verzionin e tij. Ne perkthim thote se kishte levizje te armikut nga Dollova ku kishte shume bombardime te NATO-se.

Deshmitari shikon ne dokumentin origjinal.

Pashk Krasniqi: Kishte levizja nga Dollova per shkak te frikes nga bombardimet e NATO-se edhe pse bombardimi kishte filluar me heret por ato ishin te pritura.

Prokurori Publik: Besoj se keni deklaruar me heret se Dollova mbahej nga policia dhe paramilitaret serb, a eshte e vertete?

Pashk Krasniqi: Po.

Prokurori Publik: Kjo ishte 4 kilometra nga Napolja.

Pashk Krasniqi: Po.

Prokurori Publik: Duke shikuar ne raportin ditor te dates 24 mars e lexova perkthimin ne vijim: "Roja ishte ne nivel te aksionit dhe ishte shtuar sepse armiku kishte shume levizje nga Dollova. Patem shtua rojet pershkak te aktiviteteve ne Dollove." A eshte e vertete?

Pashk Krasniqi: Po.

Prokurori Publik: Nese e kuptoj situaten ushtarake, ne po presim bombardimin e NATO-se me 24 dhe ne jemi vetem 4 kilometra nga Napolja. E kemi nje rajon te kontrolluar nga serbet dhe plot paramilitare serb.

Pashk Krasniqi: Fshati Nepole e ka lartesine mbi detare me te larte se Dollova. Ne i kemi vendos rojet tona ne hyrje per te veshtruar rajonin.

³⁵ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 24.4.2009, faqe 31, 32.

Prokurori Publik: Eshte e drejte me thene se ishin shtuar masat e sigurise per shkak te situates.

Pashk Krasniqi: Po.

Prokurori Publik: A mund te ket gabuar Kole Krasniqi kur ka thene se ne naten e 24shit nuk ka pase roje fare?

Pashk Krasniqi: Kole Krasniqi nuk eshte marre me roje.

...

Prokurori Publik: Grate dhe femijte ishin vendosur ne kiske ne naten e 24 marsit, a eshte e vertete?

Pashk Krasniqi: Po.

Prokurori publik: Pse?

Pashk Krasniqi: Sepse priteshin bombardimet e NATO-se dhe Serbia hakmirrej duke na sulmuar neve.

Prokurori Publik: Nata ne mes 24 dhe 25shit ishte shume e rrezikshme, posaqerisht ne fshatin Nepole, a eshte e vertete?

Pashk Krasniqi: Po.

Prokurori Publik: Ju keni vendose ate nate qe te festoni dhe te pini raki. Nuk kam pyetje tjera.

Pashk Krasniqi: Ju nuk mund te hapni varrin para se me vdeke.

Kryetari i Trupit Gjykues: Eshte cudi qe njerezit jane tubuar ne kiske nese keni pase frike nga bombardimi kurse ju ishi duke festuar ne shtepi ne te njejtin fshat. A mund te na spjegoni kete?

Pashk Krasniqi: Ne nuk kemi pase feste, ne jemi tubuar qe te ndegjojme lajmet kurse sa i perket njerezve qe ishin ne kiske, prifti dhe murgeshat kujdeseshin per ta e jo per ne.

Haxhi Millaku: Me falni qe po nderhyj, i nderuari gjykates, por do te doja te them nje fakt. Ky deshmitar eshte ketu qe gjashte (6) ore. Ju kurre nuk mundeni me kuptue pervojen e asaj qe ka ndodhe ne ate dite pa qene ne Kosove me 24 mars 1999. Ne ate dite, isha se bashku me familjen time nja 100 metra prej stacionit te policise ne Prishtine dhe pas ramjes se bombave mbi Ministrine, femijte e mi dolen ne ballkon dhe brohoriten.

Kryetari i Trupit Gjykues: Ju that se ishi duke pire raki.

Pashk Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: A ishte ndonjeri prej jush i dehur apo jo?

Pashk Krasniqi: Jo.

Kryetari i Trupit Gjykses: Te gjithë ishi te kthjellet?

Pashk Krasniqi: Po.

Kryetari i Trupit Gjykses: Prap, Kole Krasniqi na ka treguar se te gjithë njerezit ne shtepi ishin te dehur dhe posaqerisht ai tha se ai vet ishte i dehur.

Pashk Krasniqi: Nje person mund te pije nje gote raki dhe te thote se eshte i dehur. Policia do t'ju denonte. Une nuk e di kufirin.

Ferdinando Bautier de Mongeot: Meqenese e keni pare ate ne ate nate, a ishte Kole Krasniqi i dehur apo jo?

Pashk Krasniqi: Nuk kam vu re.

Ferdinando Bautier de Mongeot: Ai fliste dhe levizte normalisht?

Pashk Krasniqi: Ishte normal por Kole Krasniqi gjithmone pin.³⁶

2. Deklaratat, raportet policore dhe dëshmitë e tjera të dokumentuara që janë lexuar gjatë seancave gjyqësore.

2. a) Dëshmitë e dokumentuara dhe raportet

Gjatë shqyrtimit kryesor, dokumentet në vijim janë lexuar si prova:

- Raporti Policor i Njësisë për Krime të Luftës së Policisë së UNMIK-ut, numri i çështjes 2002 – 00047.
- Procesverbali i Komandës së UÇK-së të Zonës Operative të Dukagjinit lidhur me marrjen në pyetje të Pashk Lulit, të datës 25 mars 1999.
- Shënime të Shërbimit të Inteligjencës së UÇK-së.
- *Shënim lidhur me dokumentet e kërkuara për të aplikuar në Skemën e Familjeve Martire, Invalidëve dhe Viktimave Civile.*
- Vërtetimi i datës 21 maj 2008, Nr. i Protokolit 15/06, seria 62, lëshuar nga TMK.
- Vërtetimi i datës 21 maj 2008, Nr. i Protokolit: 09/08, lëshuar nga TMK.
- Dokumentet e konfiskuara nga Gjeloš Krasniqi gjatë arrestimit më 26 maj 2008.

³⁶ Ekstrakt nga procesverbali i shqyrtimit kryesor të datës 24.4.2009, faqe 32-35.

- Formulari *Të Drejtat e Personit të Arrestuar* i plotësuar për Gjelosh Krasniqin më 18 qershor 2008.
- Formulari *Intervista / Marrja në pyetje e të pandehurit* i plotësuar për Gjelosh Krasniqin më 18 qershor 2008.
- Raporti Para Vdekjes /Ante Mortem, INV NRO # 0592/INV/05, i datës 29 nëntor 2005.
- Raporti Para Vdekjes /Ante Mortem, INV NRO # 0031/INV/07, i datës 17 janar 2008.
- Raporti shtesë i policit Hazbi Axhami, SHPK #5529 i datës 3 mars 2008.
- Raporti plotësues i policit Hazbi Axhami, SHPK #5529 i datës 5 mars 2008.
- Raporti shtesë i policit Hazbi Axhami, SHPK #5529 i datës 25 mars 2008.
- Përmbledhj Informacionesh të mbeldhura për hetimet nga polici Hazbi Axhami, SHPK #5529 e datës 29 prill 2008.
- Kopja e printuar e bazës së të dhënave të Qendrës Kombëtare Informativë për Krime.
- Memo nga polici Andrew Thorpe, Zyra Ndërlidhëse UNMIK Interpol, dërguar policit Kelly Reeves, CP # 15905, e datës 17 qershor 2008.
- Letra nga Agjenti Special Cindy Coppola, FBI, dërguar policit Kelly Reeves, CP # 15905, e datës 24 qershor 2008.
- Aktakuza kundër Angelo Nocosia, John Melicharek, Dominick Memoli, Luis Pipolo, Dardian Celajt, Ened Gjelajt dhe Gjelosh Krasniqit në Gjykatën e Qarkut në Shtetet e Bashkuara, Distrikti Jugor i New York-ut, çështja penale numër S1 07 Cr.907 (SAS).
- Fletë-arresti për Gjelosh Krasniqin i lëshuar më 18 dhjetor 2007 nga Gjykatësi Ronald L. Ellis, U.S. Magistrate, Distrikti Jugor i New York-ut, dhe Regjistri nr. S1 07 Cr. 907 (SAS).
- Aktgjykimi kundër Angelo Nicosia, John Melicharek, Dominick Memoli, Luis Pipolo, Dardian Celajt, dhe Ened Gjelajt, ne Gjykatën e Qarkut në SHBA, Distrikti Jugor i New York-ut, çështjea penale numër S1 07 Cr.907 (SAS).
- Fotokopjet e kopertinës dhe të gjitha faqeve nga origjinali i Dokumentit të Udhëtimit për Refugjatë i SHBA-ve së Gjelosh Krasniqit, i lëshuar më 8 Mars 2007, dhe me afat skadence 8 Mars 2008.
- Kopja e printuar e bazës së të dhënave Pisces (“Përmbledhja e udhëtimeve”) për Gjelosh Krasniqin.
- Kopja e printuar e bazës së të dhënave Pisces (“Identiteti” dhe “Dokumentet e udhëtimit”) për Gjelosh Krasniqin.
- Kopja e faqes së I.D.-së nga Dokumenti i Udhëtimit për Refugjatë i SHBA-ve së Gjelosh Krasniqit të lëshuar më 8 mars 2005, me afat skadence 8 mars 2006.
- Kopja e faqes së I.D.-së nga Dokumenti i Udhëtimit për Refugjatë i SHBA-ve së Gjelosh Krasniqit të lëshuar më 1 dhjetor 2003, me afat skadence 1 dhjetor 2004.
- Fotokopjet e dokumenteve të udhëtimit të Gjelosh Krasniqit dhe të dhënat nga Pisces nga Policia kufitare e Kosovës.

2. b) Deklaratat

Deklarata në vijim është lexuar si dëshmi:

- Deklarata e dëshmitares Marta Nrecaj e datës 7 – 9 dhjetor 2005.

Në deklaratën e saj dhënë hetuesve të ICTY (Tribunalit të Hagës), dëshmitarja ka pohuar se kur ajo ka udhëtuar, së bashku me njerëz të tjerë, nga Doblibare në Glllogjan për të vizituar një anëtar të familjes, ata ishin ndaluar nga Anton Prenkaj nga Doblibare dhe Gjelosh Krasniqi nga Nepole. Të dy ishin pjesëtarë të UÇK-së dhe i kanë takuar njësisë speciale “Shqiponjat e Zeza” e cila është udhëhequr nga “Togeri”. Sipas dëshmitarit, në dhjetor 2005, Krasniqi ishte duke jetuar në New York tani dhe ishte i detyruar të largohet nga Kosova, meqë kishte pasur tentim vrasje ndaj tij dhe ai kishte frikë nga hakmarrja për shkak të disa mizorive që kishte kryer gjatë luftës. Dëshmitarja e ka përshkruar Gjelosh Krasniqin si një person shumë të lig, i cili ka qenë i përfshirë në krime dhe vrasje të ndryshme. Ajo nuk e ka njohur atë personalisht, por e ka ditur se ai ka qenë rreth 30 vjeç.

2. c) Deklarata e te akuzuarit

Në shqyrtimin kryesor i pandehuri Gjelosh Krasniqi ka ushtruar të drejtën e tij për të qëndruar i heshtur.

3. Dëshmitë dhe të dhënat shtesë të siguruara gjatë seancave të shqyrtimit kryesor.

Sipas kërkesës së avokatit mbrojtës, në seancën dëgjimore të mbajtur më 24.4.2009, raportet e përpiluara nga Pashk Krasniqi, së pari si zëvendës e pastaj si komandant i ushtrisë së UÇK-së në Nepole, lidhur me situatën ushtarake në Nepole prej 21 marsit 1999 deri më 27 mars 1999, janë siguruar si dëshmi. Përkthimi i këtyre shënimeve gjendet në procesverbalin e datës 24.4.2009.

Gjykata, *ex officio*, ka kërkuar dosjen penale të të pandehurit nga Gjykata e Qarkut në Pejë. Nga shkrimorja e Gjykatës së Qarkut në Pejë, janë pranuar dokumentet në vijim:

- Kopja e aktgjykimit së Gjykatës së Qarkut në Pejë në çështjen penale PM nr.7/90 kundër Gjelosh Krasniqit e datës 25.1.1991.
- Kopja e aktgjykimit të Gjykatës Supreme në çështjen penale PAM. nr.2/91 kundër Gjelosh Krasniqi e datës 29.04.1991.

D. VLERËSIMI I PROVAVE TË PREZANTUARA

1. Gjetjet faktike dhe ekzaminimi i provave

Sipas provave të grumbulluara gjatë hetimeve dhe siç janë prezantuar gjatë seancave të shqyrtimit kryesor, Trupi gjykues konsideron sekuencën në vijim të ngjarjeve si të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

Sa i përket rikonstruimit faktik të asaj çfarë ka ndodhur natën e 24 marsit 1999, gjykata është dashur të bëjë zgjedhjen në mes të dy verzioneve të ndryshme të ngjarjeve.

Njëri verzion shfaqet nga të gjitha deklaratat e dhëna gjatë fazës së hetimeve nga dëshmitarët të cilët kanë asistuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në ngjarjet e asaj nate kritike. Të gjithë ata (*dmth* Gjergj Luli, Gjergj Quni, Mihill Pergega, Engjell Luli, Bekim Luli, Prenk Luli) kanë deklaruar qartë se i pandehuri, Gjelosh Krasniqi, natën e 24 marsit 1999, veshur në uniformë të UÇK-së, apo të paktën uniformë me simbole të UÇK-së, së bashku me ushtarë të tjerë të UÇK-së, kanë hyrë, të armatosur, në oborrin e Nikole Lulit, vëllait të Pashk Lulit, dhe, pasi kanë pyetur se kush ishte Pashk Luli dhe pasi e kanë kuptuar se cili ishte, kanë kontrolluar shtëpinë, kanë vjedhur një pushkë AK 47 dhe një pistoletë 7.65, dhe kanë marrë Pashk Lulin me vete si të burgosur. Sipas këtyre deklaratave, menjëherë pas kësaj dhe duke qenë Pashku i ndaluar, grupi i armatosur shkoi te shtëpia e Pren Kashnjetit dhe detyroi Tune Kashnjetin të dorëzojë pushkën M-48 të cilën ai e kishte në pronësi, pastaj grupi shkoi te shtëpia e Mihill Pergegës dhe detyroi atë të dorëzojë pushkën e tij M-48 dhe pistoletën 7,65 dhe në fund shkuan te shtëpia e Gjergj Qunit dhe e detyruan atë të dorëzojë një pushkë M 48 dhe një pistoletë CZ 99. Është e pamohueshme se të gjithë këta dëshmitarë kanë pohuar, gjatë hetimeve, se ata drejtëpërsëdrejti e kanë parë Gjelosh Krasniqin duke i kryer veprimet që ata i kanë përshkruar në deklaratat e tyre.

Në anën tjetër, një verzion tjetër shfaqet nga dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët e njëjtë okularë gjatë shqyrtimit kryesor. Ky verzion i ngjarjeve kryesisht ndryshon lidhur me një pikë e cila është qenësore: dëshmitarët kanë deklaruar, përpara gjykatës, se, në atë kohë, ata nuk e kanë njohur Gjelosh Krasniqin dhe se një person i panjohur, atë natë, është prezantuar si Gjelosh Krasniqi, por që ky person nuk ishte i pandehuri (sipas dëshmiave personi i panjohur ishte më i shkurtër dhe më i trashë se i pandehuri).

Kjo mospërputhje diametralisht e kundërt detyron Trupin gjykues të vlerësojë se cili nga dy verzionet mund të konsiderohet si i besueshëm. Trupi gjykues është i mendimit se në mes të dy grupeve të deklaratave, ato që janë dhënë gjatë fazës hetimore duhet të konsiderohen si të besueshme për shkak të arsyeve si në vijim.

Në rradhë të parë dhe si primare: është e rëndësishme të vërehet se, gjatë fazës hetimore, asnjëri nga dëshmitarët nuk ka deklaruar se kishin parë një person, të cilin nuk e kishin njohur, i cili vetëm ishte prezantuar si Gjelosh Krasniqi: të gjithë kanë deklaruar qartë se ata kishin parë Gjelosh Krasniqin duke kryer veprimet e përshkruara në aktakuzë. Është shumë e çuditshme dhe përgënjeshtrore dëshmitë e dhëna në shqyrtimin kryesor se të gjithë dëshmitarët kanë qartësuar vetëm gjatë shqyrtimit kryesor, dhe jo gjatë deklaratave të dhëna në fazën hetimore, rrethanën kryesore se personi që kishin parë, vetëm ishte prezantuar si Gjelosh Krasniqi, por në fakt ata nuk mund të deklaroheshin nëse ai ishte me të vërtetë Gjelosh Krasniqi, meqë nuk e kishin njohur.

Prandaj, mund të vihet deri te përfundimi se të gjithë dëshmitarët okularë duhet të kishin njohur si figurë të pandehurin dhe kanë mundur ta shohin natën kritike (njëri nga ata, Mihill Pergega, madje ka deklaruar se ai ishte shok i Gjelosh Krasniqit ndërsa Gjergj Luli, Bekim Luli, Engjell Luli kanë deklaruar se Gjelosh Krasniqi vie nga fshati Nepole, që do të thotë se e kanë njohur personalisht).

Një element tjetër që vërteton se njëri nga dëshmitarët okular, veçanërisht Gjergj Luli, e ka njohur si figurë të pandehurin (pavarësisht mohimit me këmbëngulësi të dëshmitarit) vërtetohet nga dëshmia e policit Hazbi Axhami i cili ka deklaruar se Gjergj Luli e ka thirrur me telefon duke thënë se ai e kishte parë Gjelosh Krasniqin duke vozitur BMW X 5 (shih poashtu raportin e datës 25.3.08, fq. 32 të dosjes së shënjuar *Materialet faqet 1-179*).

Poashtu dëshmia e policit Ismet Jemini vërteton rrethanën kryesore se dëshmitari okular ka njohur të pandehurin si figurë dhe se, rrjedhimisht, atyre nuk mund t'u besohet kur deklarojnë, përpara gjykatës, se në natën kritike një person është prezantuar si Gjelosh Kreshniqi por ky person nuk ishte i pandehuri.

Në fakt, polici Jemini, përpara gjykatës, ka konfirmuar në tërësi raportin e tij (shih raportin në nëndosjen 1 të dosjes së shënjuar *Volumi I, Faza hetimore*) në të cilën thuhet se kur Gjergj Luli ishte intervistuar nga polici ai ka pohuar se, në natën kritike, ai kishte njohur Gjelosh Krahniqin (duke shtuar poashtu se ai ishte nga fshati Nepole), duke mohuar dramatikisht verzionin e dhënë Trupit gjykues nga pala e dëmtuar. Poashtu, tre dëshmitarë të tjerë okularë (Tune Kashnjeti, Mihill Pergega dhe Gjergj Quni) i kanë thënë policisë se, në natën kritike, ata kanë parë drejtëpërdrejtë Gjelosh Krasniqin të cilin tashmë e njihnin.

Në mënyrë që të arsyetohet kjo çudi e qartë, duhet të supozohet se hetuesit disi kanë detyruar me forcë dëshmitarët, gjatë hetimeve, që të mos tregojnë të vërtetën lidhur me ngjarjet në natën e 24 marsit 1999: por ky supozim nuk mbështetet as nga ndonjë provë e vetme e as madje nga ndonjë aluzion eventual i cili mund të shpie te përfundimi se këto deklarata ishin rezultat i ndonjë forme presioni të ushtruar nga hetuesit ndaj dëshmitarëve.

Poashtu mund të supozohet se deklaratat e dhëna në fazën hetimore janë rezultat i keqkuptimit në mes të hetuesve dhe dëshmitarëve, por, kjo mundësi poashtu nuk vlen të marret parasysh, meqë gjasat janë shumë të vogla që e meta e njëjtë lidhur me identifikimin e Gjelosh Krasniqit paraqitet në të gjitha deklaratat e dhëna gjatë hetimeve. Një mundësi tjetër për të arsyetuar ndryshimin dramatik të verzionit është se ka dy persona me emrin Gjelosh Krasniqi që vijnë nga fshati i njëjtë Nepole dhe dëshmitarët okularë, në natën kritike, kanë parë personin tjetër e jo të pandehurin: por, ky shpjegim duhet të hudhet poashtu, meqë dëshmitari Pal Krasniqi ka dëshmuar se në Nepole në fakt ekzistojnë dy persona me emrin Gjelosh Krasniqi: njëri ishte i pandehuri ndërsa tjetri ishte shumë më i ri (aktualisht rreth 20 vjeç) që do të thote se, në mars 1999, ky personi tjetër ka qenë rreth dhjetë vjeç dhe nuk ka mundësi që ai është personi që ka kryer krimin.

E dyta: edhe pse nuk ka prova për kërcënimet e bëra nga i pandehuri drejt dëshmitarëve, është e pamohueshme se qëndrimi i palës së dëmtuar kryesore, Gjergj Luli, djali i Pashk Lulit, ka ndryshuar dramatikisht në vjeshtë të vitit 2008, kur i pandehuri nuk ishte më në paraburgim (ai ishte në paraburgim prej 27 maj 2008 deri më 24 shtator 2008 dhe pastaj prej 7 nëntor 2008 e tutje). Në fakt, deri në atë periudhë, Gjergj Luli kishte qenë shumë

bashkëpunues me policinë, duke dhënë disa deklarata dhe spontanisht kishte thirrë hetuesit në raste të shumta në mënyrë që t'u ofronte informacione të dobishme.

Por, më 7 tetor 2008, pasi kishte akuzuar vazhdimisht të pandehurin, ai shkoi në polici dhe ka thënë se dëshironte të tërhiqte akuzat kundër Gjeloshit: ia vlen të theksohet se, sipas deklaratës së dhënë në atë ditë nga Gjergj Luli, arsyeja për këtë ndryshin ishte se "babai (*i tij-shënim i përkthyesit*) Pashk Luli kishte uniformën e gabuar të policisë së Serbisë", jo sepse ai kishte kuptuar disi se i pandehuri nuk ishte personi i cili kishte marrë babain e tij.

Meqë Gjergj Luli ishte ne dijeni që nga fillimi i hetimeve se babai i tij ka punuar si polic për qeverinë jugosllave, arsyeja e lartcekur nuk shpjegon ndryshimin dramatik: prandaj është e qartë se diçka ka ndodhur në tetor 2007, diçka që ka shtyrë Gjergj Lulin dhe të gjithë dëshmitarët okularë të japin, gjatë shqyrtimit kryesor, një verzion tjetër (dhe të rrejshëm) të ngjarjeve.

Për më tepër, duhet të theksohet se gjatë gjithë hetimeve Gjergj Luli vazhdimisht ka folur lidhur me faktin se ai ka qenë goxha i frikësuar nga Gjelosh Krasniqi dhe se ai nuk ka pasur alternative tjetër, pos të shesë veturën e tij apo pronën tjetër për të blerë një armë dhe të mbrojë vetveten dhe familjen e tij (shih deklaratën e dhënë më 1.3.2008). Është prandaj e qartë se i vetmi shpjegim për ndryshimin e verzionit, ndryshe të pashpjegueshëm, duhet të kërkohet në frikën dhe tmerrin e dukshëm që ka detyruar gati të gjithë dëshmitarët okularë të gënjejnë gjatë shqyrtimit kryesor.

Poashtu, gjendja e një paniku të dukshëm që ka mbërthyer dëshmitarët gjatë tërë shqyrtimit kryesor është bërë i qartë nga fjalët e Zoje Lulit, e veja e Pashkut (shih procesverbalin e datës 12.3.2009) me të cilat ajo bën aludime në faktin se ajo shqetësohej për fëmijët e saj.

E treta: tashmë është theksuar, dëshmitë e dhëna nga dëshmitarët okularë gjatë shqyrtimit kryesor janë kontradiktore, me mospërputhje të dukshme dhe të pashpjegueshme me atë çfarë ata kanë thënë gjatë fazës hetimore. Megjithatë, shpjegimet e vetme që janë dhënë nga dëshmitarët lidhur me këtë kontradiktë qenësore është se ajo çfarë ishte shkruar në deklaratën dhënë policisë thjesht nuk është e vërtetë dhe se ata nuk kanë thënë atë çfarë shkruante në deklaratë. Edhe pse më shumë se një herë dëshmitarët ishin ballafaquar me faktin se deklaratat ishin nënshkruar nga ata vetë, shpjegimi i vetëm që ata kanë dhënë ishte gjithmonë i njëjtë: ajo çfarë shkruante në deklaratë nuk ishte e vërtetë. Prandaj, në mënyrë që t'u besohet dëshmitarëve është e domosdoshme të supozohet se është bërë një fabrikim shumë i madh i provave të rrejshme kundër të pandehurit, por nuk ekziston asnjë element i vetëm që mund të aludojë në një manipulim të tillë. Shumë më shumë ka gjasa se të gjithë dëshmitarët thjesht kanë vendosur të ndryshojnë verzionin e tyre, sepse ishin të frikësuar nga i pandehuri.

E katërta: përpjekja e dështuar e mbrojtjes për të ofruar një alibi. Mbrojtja është munduar të demonstrojë që, natën kritike, i pandehuri ishte diku tjetër. Sa i përket çështjes së dy dëshmitarëve, Kole Krasniqi dhe Pashk Krasniqi, respektivisht, komandanti dhe zëvendësi i UÇK-së në Nepole, ka dëshmuar se Gjeloshi kishte kaluar tërë natën e 24 marsit 1999 në shtëpinë e Pashkut, së bashku me ata dy dhe njerëz të tjerë. Sa i përket këtyre dy dëshmitarëve, ia vlen të theksohet se moskoherencat e brendshme dhe të jashtme

janë aq të shumta dhe aq të dukshme sa që të dy deklaratat duhet të konsiderohen si kryekëput të pasigurta.

Në fakt, Kole Krasniqi ka deklaruar se, në natën kritike, pos atij vetë, Gjeloshit dhe Praskut, në shtëpi ishin edhe tre apo katër persona të tjerë dhe këta persona, të gjithë ushtarë të UÇK-së, ishin rreth 20 vjeç. Për më shumë Kole ka deklaruar se Gjeloshi ka shërbyer në UÇK-së si gjellëbërës, meqë ishte shumë i ri (dhe duhet të vërehet se, çuditërisht, ushtarët e tjerë të UÇK-së të cilët ishin në shtëpinë e Pashkut ishin më të rinj se Gjeloshi, por nuk janë përdorur si gjellëbërës).

Në të kundërtën, lidhur me çështjen e njëjtë, Pashku ka thënë se këta personat e tjerë ishin shumë më të vjetër, rreth 35 vjeç (jo tinxherë siç ishte thënë nga Kola).

Për më tepër, Kola ka pohuar se, pas darkës, të gjithë njerëzit në shtëpi kishin qëndruar zgjuar deri rreth orës shtatë në mëngjes duke festuar tërë natën dhe në fund kanë rënë për të fjetur. Kur është zgjuar, më 25 mars, ai ka kuptuar se Gjeloshi ishte zhdukur dhe ai nuk e kishte parë më. Në të kundërtën, lidhur me çështjen e njëjtë, Pashku ka deklaruar se, në mëngjesin e 25 marsit, të gjithë njerëzit që ishin në shtëpi (përfshirë Gjeloshin dhe Pashkun) kishin rënë për të fjetur rreth orës 2 të mëngjesit dhe të nesërmen kishin qëndruar së bashku deri rreth orës 10 në mëngjes.

Është më se e qartë se kontradiktat e jashtme të dëshmimeve janë tepër të mëdha dhe të pazgjidhshme.

Dhe në fund dhe si vendimtare, raportet e përpiluara nga Pashk Krasniqi, së pari si zëvendës e pastaj si komandant i ushtrisë së UÇK-së në Nepole, lidhur me situatën ushtarake në Nepole prej 21 marsit 1999 deri më 27 mars 1999, qartësojnë çdo dyshim të mundshëm dhe dënojnë të dy dëshmitë si absolutisht të falsifikuara dhe të pabesueshme: nga këto raporte, duket pa asnjë dyshim se situatë në natën e 24 marsit në Nepole ka qenë shumë e tensionuar dhe e rrezikshme dhe se forcat serbe ishin afër fshatit: *“Roja ishte në nivelin e duhur, aksioni ishte shtuar sepse armiku ka pasë shumë levizje nga Dollova”*. (shih përkthimin e raportit të 24 marsit 1999, në procesverbalin e 24.4.2009). Për më tepër, sipas dëshmisë së Pashk Krasniqit, të gjitha gratë dhe fëmijët në fshat ishin mbledhur në kishë, në mënyrë që të strehohen për shkak të frikës nga hakmarja e forcave serbe.

Në natën e 24 marsit situata në Nepole ishte e tensionuar dhe e rrezikshme, është absolutisht e papërfytyrueshme se, në kushte të tilla, komandanti i UÇK-së i fshatit dhe zëvendësi i tij, së bashku me katër ushtarë të tjerë të UÇK-së, përfshirë edhe të pandehurin, kanë festuar, duke pirë dhe dehur. Prapë, falsiteti i dëshmisë së Kole dhe Pashk Krasniqit bëhet e qartë përmes raportit të 24 marsit 1999: *“Rreth orës 20.30 bombardimet e NATO-s filluan dhe ne ishim të zgjuar gjatë tërë natës dhe ishim duke përcjellur situatën”* ndërsa Kola dhe Pashku kanë thënë se ata kishin festuar pak a shumë tërë natën dhe se madje ishin dehur.

E pesta: poashtu duhet të theksohet se, Gegë Lleshi, komandant i shquar i UÇK-së i zonës së Dukagjinit ka dëshmuar se, sa ai ishte në dijeni, askush gjatë luftës nuk e kishte përdorur pavend emrin Gjelosh (dhe duhet të mbahet mend se një sjellje e tillë do të vërehej brenda UÇK-së).

Këto janë arsytet pse Trupi gjykues ka ardhur në përfundim se ishte i pandehuri, Gjeloš Krasniqi, së bashku me bashkëpjesëmarrës të tjerë të panjohur, i cili kishte marrë si peng Pashk Lulin nga oborri i Mark Lulit dhe kishte plaçkitur armët prej tij dhe viktimave të tjera.

Megjithatë, provat e ofruara nga prokurori përkitazi me rekonstruimin faktik të ngjarjeve lidhur me fatin e Pashk Lulit nuk shkojnë përtej kësaj pike. Në fakt, nuk është dhënë asnjë provë e cila mund të demonstrojë se kundër Pashk Lulit janë kryer veprimet në vijim: paraburgimi, privimi i së drejtës për gjykim të drejtë, trajtimi çnjerëzor dhe në fund vrasja. Në të vertetë, nuk është vërtetuar se çfarë i ka ndodhur viktimës pasi është marrë: në fakt, dy provat e vetme që i janë prezantuar gjykatës lidhur me këtë janë të ashtuquajturat *process verbale* dhe deklaratat e dhëna nga Gjergj Luli lidhur me disa fraza që ai ka dëgjuar përkitazi me fatin përfundimtar të Pashk Lulit.

Sa i përket *process verbale*, ky dokument i gjetur nga hetuesit e ICTY, thotë se, pas arrestimit të Pashk Lulit nga ana e Gjeloš Krasniqit, viktimë ishte marrë në pyetje dhe në fund është ekzekutuar nga Brigada 132. Por, çështja është se *process verbale* nuk mban ndonjë nënshkrim dhe prandaj nuk mund të konsiderohet si provë e besueshme. Në fakt, çdokush ka mundur të shtyp *process verbale-in* dhe mungesa e ndonjë nënshkrimi nuk ofron mundësinë e vërtetimit se kush e ka shkruar dokumentin dhe nëse përmbajtja e tij korrespondon me të vërtetën apo jo.

Lidhur me atë se çfarë është raportuar nga Gjergj Luli në deklaratat e tij dhënë policisë, përkitazi me fatin përfundimtar të babait të tij (veçanërisht se motra e tij Marta i kishte thënë atij se Gjeloš Krasniqi i kishte thënë asaj se ai e kishte vranë babain e saj Pashk Lulin), pamundësia për të marrë dëshminë e Marta Ndrecajt përpara gjykatës dhe mungesa pasuese e ndonjë deklarate të dhënë nga dëshmitari direkt mbi çështjen (Gjergji veta raportuar atë çfarë ka dëgjuar nga motra e tij), detyron gjykatën që mos t'i konsiderojë si të vërtetuara rrethanat e deklaruara nga Gjergj Luli gjatë hetimeve lidhur me fatin përfundimtar të babait të tij.

Duhet të theksohet prapë se meqë Gjergj Luli nuk ka asistuar drejtëpersëdrejt në ngjarjet e treguara nga Marta, pa konfirmimin e dëshmitarit direkt, është e pamundur të arrihet niveli i sigurisë që është i domosdoshëm për ta dënua lidhur me një pikë specifike të vrasjes.

Prandaj, pas vlerësimit përfundimtar të provave të prezantuara nga palët, mund të thuhet se, përkitazi me rekonstruimin faktik të ngjarjeve të natës së 24 marsit 1999, vetëm fakti se i pandehuri ka marrë Pashk Lulin si të burgosur nga shtëpia e vëllait të tij dhe se së bashku me ushtarët e tjerë të UÇK-së ka plaçkitur armët nga shtëpitë e tjera në fshatin Dublibare është vërtetuar dhe demonstruar, ndërsa lidhur me fatin përfundimtar të viktimës nuk është ofruar asnjë dëshmi e fortë.

Përkitazi me qëndrimin e dëshmitarëve Gjergj Luli, Gjergj Quni, Mihill Pergega, Engjell Luli, Bekim Luli, Pren Kashnjeti, Prenk Luli, Kole Krasniqi dhe Pashk Krasniqi, procesverbalet e dëshmimeve të tyre do t'i dërgohen zyres së Prokurorit të Qarkut meqë ata kanë kryer veprën penale të Deklarimit të rrejshëm, në kundërshtim me nenin 307 të KPK.

2. Propozimet e palëve

Avokati mbrojtës ka ngritur vërejtjet posaçërisht kundër deklaratave të dhëna nga Gjergj Luli hetuesve të ICTY-së (Tribunalit të Hagës) dhe lidhur me deklaratat e dhëna nga Engjell dhe Bekim Luli.

Sa i përket deklaratave të dhëna ICTY-së në 2003 dhe 2004 nga Gjergj Luli, të cilat janë në gjuhën angleze, avokati mbrojtës ka bërë vërejtje se deklaratat mbanin dy data të ndryshme dhe prandaj deklaratat ishin marrë në mënyrë të kundërligjshme. Çështja ishte qartësuar përmes vendimit të Trupit gjykues i cili ka konsideruar deklaratat si të pranueshme, meqë doli se në ditën e parë dëshmitari kishte dhënë deklaratën në shqip dhe pastaj kjo ishte përkthyer dhe shtypur në anglisht. Mëpastaj, deklarata ishte printuar dhe, në ditën e dytë, i ishte lexuar dëshmitarit. Nëse nuk ka pasur kundërshtime dëshmitari e ka nënshkruar.

Në fakt, dëshmitari Ermir SHEHU ka dëshmuar se kjo ishte procedura e zakonshme për marrjen e deklaratës nga hetuesit e ICTY-së (procedurë e cila është respektuar edhe në këtë rast) dhe, sa i kujtohet atij, Gjergj Luli nuk ka pasur kundërshtime.

Sipas Trupit gjykues, kjo procedurë, edhe pse mund të përmbajë ndonjë parregullsi, nuk shkel ligjin në fuqi në atë kohë, meqë mund të thuhet se deklarata në fakt është dhënë zyrtarisht në ditën e dytë, kur deklarata është nënshkruar dhe prandaj përfundimisht është aprovuar nga dëshmitari.

Sa i përket deklaratave të dhëna nga Engjell dhe Bekim Luli policisë, mbrojtja ka ngritur çështjen se ato nuk ishin marrë në mënyrë ligjore dhe, veçanërisht, jo në pajtim me KPPK, nenin 164, par. 1, i cili thotë se dëshmitari duhet të merret në pyetje ndaras dhe pa praninë e dëshmitarëve të tjerë.

Në fakt, polici Hazbr Axhami ka pranuar se Engjell Luli ishte i pranishëm kur vëllai i tij Bekim Luli ka dhënë deklaratën, por Trupi gjykues konsideron se kjo ishte vetëm një parregullsi dhe jo shkelje substanciale e procedurës e cila do të kërkonte që prova të veçohet.

Në fakt, sipas KPPK, nenit 153, provat e marra me shkelje të dispozitave të procedurës janë të papranueshme vetëm atëherë kur ligji shprehimisht e parasheh një gjë të tillë: dhe është e qartë se në kodin e procedurës nuk mund të gjenden dispozita të cilat kërkojnë perjashtimin e deklaratës së marrë me shkelje të rregullës së paraparë me nenin 164 të KPPK.

Nga palët e dëmtuara nuk është paraqitur asnjë propozim.

E. KUALIFIKIMI LIGJOR

1. Vlerësimi ligjor i fakteve nga Gjykata

Jurisprudenca e vazhdueshme mbi Krimet e Luftës ka vërtetuar, gjatë viteve, cilat janë kriteret që përcaktojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit; posaçërisht, si minimum duhet të vërtetohet:

- ekzistimi i konfliktit të brendshëm të armatosur dhe natyra detyruese e ligjit ndërkombëtar të aplikueshëm mbi palët;
- pjesëmarrja e të akuzuarit në konfliktin e armatosur;
- lidhja në mes të krimit të pretenduar dhe konfliktit të armatosur;
- statusi civil (i mbrojtur) i viktimës;
- se veprimi në fjalë paraqet shkelje të ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e kryerjes së veprës dhe se poashtu bie nën ato vepra penale të identifikuar si krime lufte brenda nenit 142 (i ashtuquajtimi testi i dualitetit);
- pjesëmarrja e të akuzuarit në veprën penale.

Ekzistimi i konfliktit të armatosur dhe natyra detyruese e ligjit ndërkombëtar të aplikueshëm mbi palët;

Konflikti i armatosur ekziston kurdo që përdoret forca e armatosur qoftë në mes të shteteve apo dhuna e armatosur e zgjatur në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara. Ligji Ndërkombëtar Humanitar (IHL) është i aplikueshëm prej fillimit të konflikteve të tilla dhe shkon përtej ndërprerjeve të armiqësive deri sa të arrihet vendosja e përgjithshme e paqes.

Në rast të konfliktit të armatosur ndërkombëtar, civilët, personat e konsideruar hors de combat dhe jo-luftëtarë janë të mbrojtur me parimet bazike të IHL, në veçanti të Konventave të Gjenevës të 1949, dhe Protokoleve Shtesë të tyre të 1977. Në rast të konfliktit të armatosur të brendshëm, personat e njëjtë gëzojnë të drejtën e mbrojtjes sipas Nenit 3 të përbashkët për të katër Konventat e Gjenevës të plotësuar me Protokolën e II-të Shtesë (tash e tutje KN3 dhe PShII).

Për t'u konsideruar konflikt i armatosur nën KN3 kriteriumi thelbësor është që dhuna e armatosur e zgjatur përdoret në mes të autoriteteve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara apo në mes të grupeve të tilla brenda një shteti. PShII plotëson këtë duke kërkuar që këto grupe të jenë nën komandë të përgjegjshme dhe të ushtrjnë kontrollë mbi një territor të shtetit që do t'ju mundësojë të kryejnë operacione ushtarake të qëndrueshme dhe të bashkërenduara dhe që armiqësitë të ndodhin në nivel që shkon më larg se sa nga diçka që mund të karakterizohet thjesht si trazira të brendshme dhe tensionime, siç janë rebelimet, akte të izoluara dhe sporadike të dhunës dhe akte të tjera te natyrës së ngjashme.

Është e pakontestueshme nga palët dhe poashtu mund të konsiderohet si fakt i njohur në përgjithësi se, më 24 mars 1999, ka ekzistuar konflikti i armatosur që ka përfshirë UÇK-në dhe forcat Jugosllave/ Serbe, i cili mund të konsiderohet si konflikt i armatosur i paraparë me KN3 dhe PShII .

Pjesëmarrja e të akuzuarit në konfliktin e armatosur

Pjesëmarrja e të akuzuarit në konfliktin e armatosur është e pamohueshme: në dosjen e lëndës gjendet certifikata zyrtare e lëshuar nga Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe e nënshkruar nga nën-kolonel, Salih Lajci, që vërteton se Gjeloš Krasniqi i është bashkuar UÇK-së prej 16.6.1998 deri më 20.6.1999.

Certifikata e dytë konfirmon se Gjelosh Krasniqi, ushtar i UÇK-së prej 16.06.1998, ishte i plagosur në aksion më 5.4.1999.

Këto rrethana nuk kontestohen nga mbrojtja.

Të dy certifikatat gjenden në dosjen e shënjuar “Materialet faqet 0-179” në faqet 81-84.

Lidhja

Konflikti i armatosur ka luajtur rol fundamental në mundësinë që i pandehuri të kryejë krimet. Vendimi për të marrë Pashk Lulin si peng dhe për të plaçkitur armët ishte qartësisht i lidhur me konfliktin. Në fakt, arsyeja e pretenduar për veprim kundër viktimës Pashk Luli ishte për shkak të bashkëpunimit të tij të supozuar me serbët meqë ai ishte polic vendor duke punuar për qeverinë serbe. Armët ishin vjedhur derisa Pashk Luli ishte marrë si peng dhe qartësisht ishin konfiskuar dhe kërkuar nga ushtarët e UÇK-së si një armatë që kontrollonte territorin në një konflikt të armatosur. Në fakt, njerëzit që ishin detyruar të dorëzojnë armët nuk ishin fajësuar për asgjë specifike, por ishte e qartë se ata duhej të dorëzojnë armët e tyre meqë armata që kontrollonte zonën kërkonte posedimin e tyre.

Statusi i viktimave

Në këtë lëndë duhet të shqyrtohet çështja e statusit të viktimës Pashk Luli, edhe pse nuk është ngritur nga mbrojtja, meqë Pashk Luli ishte polic. Neni 142 i KPJ shprehimisht kërkon që viktima të jetë pjesë e popullatës civile. Në rast të konfliktit të armatosur, IHL përmes dispozitave KN3 dhe PSh11 mbron të gjithë personat që nuk janë luftëtarë dhe që nuk marrin pjesë drejtëpërsëdrejti në armiqësi. Person civil definohet si personi i cili nuk merr pjesë aktivisht në armiqësi me qëllim të shkaktojë dëm fizik personelit apo objekteve të armikut.

Neni 5 i Konventës së IV-të të Gjenevës parasheh që, në mënyrë që personi civil të humb statusin e tij/saj të personit të mbrojtur, ai/ajo duhet të jetë “*me siguri i/e dyshuar për...aktivitete armiqësore kundër sigurisë së shtetit...*” dhe Trupi gjykues gjen se vetë fakti që Pashk Luli ka qenë pjesëtar i policisë lokale nuk e vërteton *me siguri* apo *përligj* dyshimin për aktivitet armiqësor. Për më tepër, është e rëndësishme të theksohet se policia në përgjithësi është organizatë civile, për dallim dhe ndaras nga ushtria.

Në shumicën e shteteve moderne në kohë të luftës, policia mbetet “civile” dhe kanë të drejtë të konsiderohen si të tillë, pos nëse ata marrin pjesë drejtëpërsëdrejti në armiqësi apo janë caktuar specifikisht si pjesë e forcave të armatosura dhe përmbushin kriteret për forca të armatosura (komandë të përgjegjshme, simbole të veçanta, mbatjtje hapur të armëve, dhe respektim i ligjeve të luftës). Prandaj, policët pa detyra luftarake nuk janë shënjestër legjitime ushtarake por janë civil dhe, rrjedhimisht, persona të mbrojtur.

Shkelja e ligjit vendor dhe ndërkombëtar në fuqi në kohën e veprimit – (i ashtuquajtur i testi i dualitetit);

Neni 142 i KPJ parasheh që definicioni primar i sjelljes së ndaluar duhet të gjendet midis veprave themelore tetuara në neni 142. Së dyti, një vepër e tillë duhet të përbëjë shkelje të

traktateve ndërkombëtare. Jugosllavia ka ratifikuar Konventat e Gjenevës dhe të dy Protokolet Shtesë. Sa i përket veprave të kryera gjatë konfliktit të armatosur, vepra duhet të kryhet në shkelje të KN3 dhe/ose PShII.

Duke marrë parasysh faktet dhe rrethanat në këtë çështje, aktakuza pretendon se i akuzuari ka kryer veprat në vijim: veprat e paligjshme, arrestimin, paraburgimin, marrjen peng, privimin e së drejtës për gjykim të drejtë, trajtimin çnjerëzor dhe në fund vrasjen e Pashk Lulit dhe konfiskimin e pronës dhe plaçkitjen e armëve nga Pashk Luli dhe viktimat e tjera. Meqë, për shkak të arsyeve të cekura më lart, nuk është dëshmuar se çfarë i ka ndodhur viktimës pasi e kishin marrë, vetëm veprimet lidhur me arrestimin e paligjshëm, paraburgimit, marrjes peng dhe plaçkitjes së armëve duhet të shqyrtohen.

Sa i përket arrestimit të paligjshëm – që mund të përkufizohet si “*akti i ndalimit të personit për shkak të pretendimit të shkeljes së ligjit apo përmes përdorimit të pushtetit*”³⁷ – veprim që sigurisht është kryer nga i pandehuri, i cili ka vepruar si komandant i një grupi ushtarësh të UÇK-së që e kanë marrë Pashk Lulin, duhet të vërehet se ky veprim nuk e përmbush testin e dualitetit. Në fakt, edhe pse arrestimi i paligjshëm në mënyrë specifike është i ndaluar sipas nenit 142 të KPJ, asnjë ndalesë lidhur me këtë vepër nuk mund të gjendet në Konventat e Gjenevës dhe në PShII.

Prandaj, veprimi i arrestimit të paligjshëm i ndërmarrë nga i pandehuri duhet të riklasifikohet si Privim i kundërligjshëm nga liria, në kundërshtim me nenin 162 të KPK (ligji më i favorshëm sa i përket nenit 63 të Ligjit Penal të Republikës së Serbisë – Paraburgimi i Kundërligjshëm -) dhe rrjedhimisht edhe akuza, në pikën specifike, duhet të refuzohet, sipas nenit 389, paragrafi 1, nënparagrafi 4, meqë afati i parashkrimit ka skaduar.

Sa i përket paraburgimit, që në përgjithësi mund të përkufizohet “*si gjendje e personave të paraburgosur apo të burgosur, që mëturje është përshkruar si gjendje e çdo personi të privuar nga liria personale përpos nëse kjo është rezultat i dënimit për shkak të shkeljes së ligjit*”³⁸, nuk mund të thuhet se në periudhën kohore pas arrestimit dhe marrjes peng të Pashk Lulit, ai e ka paraburgosur, meqë, siç është demonstruar tashmë më lart, nuk ka provë solide lidhur me çfarë i ka ndodhur viktimës pasi ai ishte larguar përfundimisht nga oborri i Nikole Lulit. Prandaj, i pandehuri duhet të lirohet nga akuza e paraburgimit të Pashk Lulit.

Megjithatë, i pandehuri nuk është kufizuar në arrestimin e kundërligjshëm të Pashk Lulit: viktima ishte marrë nga oborri ku ishte duke qëndruar dhe ishte detyruar të shkojë pas ushtarëve, si peng, derisa ata ishin duke vjedhur armët rreth fshatit (dhe sipas deklaratave të dëshmitarëve, plaçkitja ka zgjatur rreth dy-tre orë, prej hyrjes së ushtarëve të UÇK-së në oborrin e Nikole Lulit, derisa Pashk Luli përfundimisht u largua nga oborri në mënyrë që të dërgohet në shtabin e UÇK-së).

Sa i përket marrjes peng duhet të theksohet se kjo sjellje është e ndaluar edhe përmes nenit 3, të përbashkët për të gjitha Konventat e Gjenevës, nenit 4, par. 2 PShII e edhe nenit 142 të KPJ. Prandaj, kriteri i testit të dualitetit është përmbushur.

³⁷ *Simic, Tadic, dhe Zaric*, (ICTY, Dhoma e gjyqimëve), tetor 17, 2003.

³⁸ *Simic, Tadic, dhe Zaric*, (ICTY, Dhoma e gjyqimëve), tetor 17, 2003.

Koncepti i marrjes së një personit si peng saktësisht është qartësuar nga jurisprudenca mbi krimet e luftës, që thotë se *“elementi thelbësor në krimin e marrjes peng është përdorimi i kërcënimit ndaj të paraburgosurve nënyrë që të sigurohet një koncesion apo të fitohet një epërsi”*³⁹

Dhe kjo është saktësisht ajo çfarë ka ndodhur në këtë rast: Pashku së pari është arrestuar dhe pastaj është përdorur si peng në mënyrë që të binden njerëzit e tjerë për të dore armët e tyre gjatë plaçkitjes së kryer në fshatin Doblibare nga ana e ushtarëve të UÇK-së të udhëhequr nga Gjelosh Krasniqi, në natën e 24 marsit 1999.

Duhet të mbahet në mend se Pashku nuk ishte vetëm në paraburgim, por duart e tij ishin të lidhura pas shpinës (shih dëshminë e Pren Kashnjetit), prandaj kërcënimi kundër njerëzve të cilët kishin për të dorëzuar armët, edhe pse nuk ishte thënë me gojë, ishte vetvetiu i qartë. Veç kësaj, është e pamohueshme se ushtarët e UÇK-së mbështeteshin në përshtypjen e fortë që kishte ngjallur në fshatarët fakti që ata kishin në paraburgim, si të burgosur me duar të lidhura, një polic që punonte për qeverinë serbe. Duhet të vërehet se peng u ishte treguar të gjithë viktimave, me qëllim të qartë që të ekspozohet se ushtarët kishin një polic në dispozicion dhe të tregojnë fuqinë dhe kapacitetin e tyre për të përfutur gjithë çfarë dëshironin (Mihill Pergega veçanërisht, në deklaratën e tij dhënë policisë, kishte pohuar se ai kishte frikë që ushtarët mund të ktheheshin dh eta marrin, që do të thotë se ekspozimi i fuqisë i bërë përmes ekspozimit të pengut funksionoi për mrekulli).

Për më shumë, rrethana se ushtarët e UÇK-së mbështeteshin në faktin se kishin si peng Pashk Lulin, në mënyrë që të mos kenë telashe në plaçkitjen e armëve që u duheshin, është qartësuar duke marrë parasysh që së pari ata shkuan për të marrë Pashkun dhe vetëm pastaj, duke e paraqitur si të burgosur, shkuan rreth fshatit, ndërsa është e qartë se për ushtarët e UÇK-së do të kishte qenë shumë më lehtë të vjedhin armët pa një të burgosur që kërkon kujdes dhe pastaj të arrestojnë dhe të marrin me vete Pashkun. Ata vendosën të shkojnë dhe të marrin Pashkun përpara vjedhjes, vetëm për arsye se ata menduan që do t'ishte e dobishme dhe më e efektshme nëse ua tregojnë pengun viktimave të tjera.

Veç kësaj, disa kërcënime me vdekje ishin bërë nga ana e Gjeloshit poashtu drejtëpërsëdrejti kundër Pashkut dhe Gjergj Lulit (shih deklaratën e Gjergj Lulit të datës 26.8.2009), kur ushtarët u larguan nga oborri në mënyrë që të detyrojnë të afërmit e Pashkut të mos largohen nga oborri, kërcënime të cilat kishin si qëllim kryesor që ushtarët të sigurojnë një epërsi dhe të mos percillen nga askush.

Përkritazi me plaçkitjen e armëve, testi i dualitetit është përmbushur në tërësi, meqë sjellja është e ndaluar edhe sipas nenit 142 të KPJ dhe sipas nenit 4, par. 2 të PShII.

Jurisprudenca mbi Krimet e Luftës e ka përkufizuar aktin e plaçkitjes si në vijim: *“përvetësimi i kundërligjshëm i pronës publike ose private gjatë konflikteve të armatosura”*⁴⁰.

Është e pamohueshme se veprimet e ndërmarra ishin për të vjedhur, grabitur dhe për të përvetësuar në mënyrë të kundërligjshme pronën private (veçanërisht armët) gjatë kohës së luftës pa pasur ndonjë të drejtë ligjore për të bërë një gjë të tillë dhe duke përdorur

³⁹ *Blaskic*, (ICTY, Dhoma e ankesave), korrik 29, 2004.

⁴⁰ *Simić, Tadić, dhe Zarić*, (Dhoma e gjykimeve), tetor 17, 2003.

forcën apo duke u kërcënuar. Tashmë është shpjeguar se si fakti që Pashk Luli ka qenë në paraburgim është përdorur nga ushtarët e UÇK-së si kërcënim i nënkuptuar në mënyrë që të detyrohen viktimat të dorëzojnë armët pa kundërshtuar fare.

Pjesëmarrja e të akuzuarit në shklejet e ligjit

Pjesëmarrja e të pandehurit në veprat penale për të cilat është fajësuar është diskutuar më herët në këtë arsyetim. Siç është vërejtur më lart, Gjykata është siguruar përtej dyshimit të arsyeshëm për pjesëmarrjen e të pandehurit në marrjen peng të Pashk Lulit dhe plaçkitjen e armëve.

F. CAKTIMI I DËNIMIT

Kur cakton sanksionin penal gjykata duhet të ketë parasysh të dyja: edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit – dmth të shuajë aktivitetet e rrezikshme për shoqërinë duke i dekurajuar të tjerët nga kryerja e veprave të tilla – edhe qëllimin specifik, të parandalojë shkelësin e ligjit nga përsëritja e shkeljes së ligjit.

Në lëndën aktuale Trupi gjykues ka arritur në përfundimin se, kjo ishte një vepër e rëndë penale e kryer përmes disa veprimeve dhe kundër popullatës civile nga ana e nje grupi njerëzish të armatosur rëndë. Sa i përket rrethanave rënduese, duhet të vërehet se i pandehuri është recidivist, meqë ai ka kryer vrasje kur ka qenë i mitur. Sa i përket rrethanave lehtësuese, duhet të merret parasysh se ai ka qenë relativisht i ri në kohën kur ka kryer krimin.

Edhe pse vepra është kryer përmes disa veprimeve, vepra penale duhet të shqyrtohet si një krim i vetëm dhe dënimi, duke i marrë parasysh edhe rrethanat rënduese edhe ato lehtësuese, do të jetë shtatë vjet burgim.

Koha e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënim.

G. SHPENZIMET

I akuzuari Gjelosh Krasniqi është pallur fajtor; ai duhet të kompenzojë shpenzimet e procedurës penale përpos atyre të përkthimit (KPPK, neni 102, paragrafi 1). Një vendim i veçantë lidhur me shumën e shpenzimeve do të leshohet nga gjykata atëherë kur të merren informacionet e tilla.

H. KËRKESA PËR KOMPENZIM

Në fillim të shqyrtimit kryesor palëve të dëmtuara u është kujtuar mundësia për paraqitjen e propozimit për të realizuar kërkesën pasurore juridike brenda procedurës penale, sipas KPPK, nenit 355, par. 2, por ata kanë deklaruar se ata nuk e kishin ndërmend të paraqesin kërkesë pasurore juridike.

Prandaj, gjykata nuk ka pasur nevojë të sjellë vendim të veçantë mbi këtë çështje.

Keshilla Juridike

Personat e autorizuar mund të parashtrojnë ankesë me shkrim kundër këtij aktgjykimi përmes Gjykatës së Qarkut në Pejë drejtuar Gjykatës Supreme të Kosovës Brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga pranimi i një kopjeje të aktgjykimit.

Procesmbajtëse
Patricia Faltusova

Kryetari i Trupit gjykues
Gianfranco Gallo